

UNITED NATIONS  
United Nations Interim Administra  
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration Intérimaire  
Nations Unies au Kosovo

UNMIK

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**T R A N S K R I P T**

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E  
MBAJTUR MË 28,29 SHTATOR DHE 03, 05 TETOR 2005

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 28, 29.  
SEPTEMBRA I 03, 05. OKTOBRA 2005. GODINE

**TETOR - OKTOBAR**  
**2005**

# T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E  
MBAJTUR MË 28, 29 SHTATOR DHE 03, 05 TETOR 2005

SEANCA U MBAJT NË SALLËN E KUVENDIT TË KOSOVËS DHE FILLOI NË  
ORA 10,00.

SEANCËN PLENARE E KRYESOI AKADEMIK NEXHAT DACI, KRYETAR I  
KUVENDIT TË KOSOVËS. BASHKËKRYESUES NAIM MALOKU, ANËTAR I  
KRYESISË SË KUVENDIT.

## KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Mirëmëngjesi. Mirëseardhje në Seancën e rregullt plenare. Mirëseardhje ministrave të Qeverisë dhe mysafirëve të pranishëm. Së pari – kuptohet - mirëseardhje deputetëve të pranishëm, që janë 80-të. Prandaj, shpresoj se edhe mund të punojmë në mënyrë të plotfuqishme.

Ka vërejtje se teknika nuk po funksionon! Për këtë, lus regjinë të kujdeset, e mos të ketë lëshime teknike.

Të gjitha materialet e nevojshme për këtë Seancë janë shpërndarë me kohë.

Pa humbur kohë, po fillojmë me rendin e ditës:

### **- Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.**

Si praktikë e kemi, që eventualisht nëse ka vërejtje, ato të bëhen me shkrim. Por, megjithëkëtë, nëse ndokush ndien të nevojshme, ato mund t'i paraqesë edhe gojarisht.

Pasi që nuk ka vërejtje në procesverbal, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

### **- Miratimi i Deklaratës së Kryetarit të Kosovës doktor Ibrahim Rugovës lidhur me ekipin për bisedime eventuale për statusin përfundimtar të Kosovës.**

Para se të kalojmë në miratimin e Deklaratës, më lejoni t'i them dy-tri fjalë lidhur me të.

Të nderuar zonja deputete dhe zotërinj deputetë,  
Presidenti i Kosovës, doktor Ibrahim Rugova, në kuadër të detyrave dhe kompetencave të veta kushtetuese, këto ditë i është drejtuar popullit me një Deklaratë rreth përgatitjeve për biseda eventuale për statusin e Kosovës.

Në letërën e Presidentit Rugova, ë cila, konform rregullave dhe procedurave, i është shpërndarë të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ndër të tjera thuhet:

*Kosova u takon të gjithë njerëzve që jetojnë këtu. Edhe procesi që duhet të çojë te statusi ynë politik u takon të gjithëve. Në këtë vijë të ecjes të çështjes së veprimit institucional, Presidenti i Kosovës ka emëruar ekipin, të cilin e përbëjnë:*

- *Presidenti;*
- *Kryeministri; dhe*
- *Kryetari i Kuvendit të Kosovës,*

*si udhëheqës më të lartë nominal të institucioneve kryesore legale e legjitime të Kosovës, si dhe*

- *Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, dhe*
- *Kryetari i subjektit politik ORA,*

*si udhëheqës të dy partive kryesore opozitare.*

*Me këtë - të themi institucion të ri për statusin e Kosovës - përmbushen të gjitha kërkesat edhe të popullit të Kosovës, edhe të bashkësisë ndërkombëtare, sepse arrihet uniteti funksional, sepse respektohen institucionet e dala nga vota e lirë e popullit dhe se bëhet i plotë përfaqësimi dhe prezantimi i gjithë spektrit politik dhe etnik të Kosovës.*

*Të nderuar deputetë – të Kuvendit të Kosovës,*

*Në gjithë procesin, tashmë më të rëndësishëm historik për fatin e Kosovës, ne të gjithë do të jemi bashkë dhe do të kemi një unitet të pathyeshëm për të gjitha çështjet.*

*Në grupet punuese që do të udhëhiqen nga ministrinë përkatëse të Qeverisë së Kosovës, që i japin dinjitet institucional paraqitjes ndërkombëtare të Kosovës, si dhe në grupin e ekspertëve – është qëndrim yni që përfaqësimi do të jetë gjithëpërfshirës e konform votës së popullit, duke mos lënë askënd anash këtij procesi.*

Deputetë të respektuar,

Presidenti i Kosovës, në bazë të funksionit dhe kompetencave që i ka, do t'i prijë këtij procesi. Secili nga ne i ka kompetencat dhe detyrat që dalin nga vota e popullit.

Kuvendi i Kosovës do të miratojë këtë përcaktim dhe do të bëjë ratifikimin në kohë të duhur të të gjitha përcaktimeve strategjike dhe të marrëveshjeve eventuale, apo të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, duke shprehur vullnetin e lirë - dhe vetëm vullnetin e popullit të Kosovës.

Ky është mandat yni, dhe këtë mandat, ne deputetët e Kuvendit të Kosovës – të zgjedhur me votën e lirë e demokratike – do ta mbushim me nderë dhe në plotni.

Deputetë të respektuar,

Më lejoni që nga kjo foltore, t'i shpreh urimet e mia, tuaja dhe të gjithë popullit të Kosovës për shërim sa më të shpejtë Presidentit të Kosovës doktor Ibrahim Rugova me dëshirat më të sinqerta që ai të jetë me ne dhe të na prijë në zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës, të lirisë dhe të pavarësisë sonë.

Ju faleminderit!

Unë tani do t'ju ftoj që, me një deklaram aklamacioni, ta përkrahim këtë dhe të tregojmë unitetin tonë.

Urdhëroni zoti Krasniqi – shef i Grupit Parlamentar të PDK-ës.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Zoti Kryetar, të nderuar deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës, që nga themelimi i saj e në vazhdimësi ka kërkuar që për çështje vitale për qytetarët, për shtetin dhe demokracinë - të kemi mendim dhe veprim të unifikuar. Të njëjtën gjë e kemi kërkuar duke filluar nga seanca e parë e kësaj legjislature kur kemi treguar edhe arsytet pse duhet të kemi dhe ku duhet të kemi unitet mendimi e veprimi. Këtë e kërkojmë edhe sot.

Partia Demokratike e Kosovës, sheh të domosdoshme dhe të pazëvendësueshëm ndërtimin e unitetit dhe konsensusit në mes forcave kryesore politike në pajtim me legjitimitetin e përgjegjësive politike që kanë në Kuvendin e Kosovës për të marrë vendime për qytetarët dhe të ardhmen e vendit.

Partia Demokratike e Kosovës, kërkon nga Kuvendi i Kosovës fillimisht të distancohet nga forma dhe mënyra se si ministrat e caktuar të Qeverisë së Kosovës kanë nisur bisedimet politike me Beogradin për çështje që krykrejt janë sfida të brendshme të institucioneve të Kosovës. Këto bisedime, jo vetëm që janë arbitrare, ato para se gjithash janë zhvlerësuese, inferiore dhe tepër të dëmshme për vetë institucionet dhe të ardhmen e Kosovës. Nga ato bisedime, institucionet e Kosovës, nuk kanë qenë palë, por pjesë e tërësisë së unionit Serbi-Mali i zi. Nga Kuvendi i Kosovës duhet të ndodhë distancimi.

Të nderuar deputetë,

- Duke marrë për bazë deklaratat e shpeshta të partive në koalicionin aktual, fillimisht për njohjen formale të pavarësisë përkatësisht pastaj të shpalljes së pavarësisë në Parlament – ide që është përkrahur edhe nga Partia Demokratike e Kosovës, të përsëritur shpesh në legjislaturën e kaluar e të harruar tani;
- Duke pasur respekt për përcaktimin e vazhdueshëm të popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, luftërat shekullore për çlirim dhe bashkim kombëtar, Rezolutën e Bujanit, Deklaratën e 2 korrikut, Kushtetutën e Kaçanikut dhe Referendumin e saj, Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për shtet të pavarur, sovran dhe demokratik,
- Duke marrë parasysh premtimet elektorale të të gjitha subjekteve të dala nga katër palë zgjedhje,

Partia Demokratike e Kosovës, nga Kuvendi i Kosovës kërkon që:

Faktori i unitetit politik i përfaqësuar në Kuvend të bëjë zyrtarizmin e pavarësisë së shtetit të Kosovës para se të fillojnë bisedimet apo negociatat.

Të formohet formacioni i unitetit kombëtar e qytetar nga Parlamenti i Kosovës për bisedime që Kosova duhet t'i zhvillojë me bashkësinë ndërkombëtare, Bashkimin Evropian dhe vendet fqinjë.

Nëse Parlamenti nuk e ka kurajo të institucionalizojë vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, atëherë le ta shpallë referendumin gjithëpopullor dhe të vendosin qytetarët e Kosovës për vete sepse kjo është demokratike dhe nuk mund të kontestohet me asnjë normë juridike ndërkombëtare.

Partia Demokratike e Kosovës, duke pasur parasysh strukturën shumetnike të Kosovës, që është proklamuar edhe nga komuniteti ndërkombëtar, duke u mbështetur në tërësinë e saj, duke marrë për bazë formësimin e shtetit për të gjithë qytetarët dhe përkatësitë e saj etnike, kulturore, fetare e gjuhësore, duke marrë për bazë realizimin e projektit Standardet për Kosovën, mendojmë se përbërja e grupit të unitetit kombëtar e qytetar duhet të diskutohet dhe pastaj të plotësohet nga bashkësitë tjera etnike dhe të qytetarëve me ndikim në jetën politike, publike dhe shoqërore në Kosovë.

Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës, vlerëson nismën e Presidentit Rugova, se: Deklarata është bërë pa konsensus; është e njëanshme; nuk janë bërë konsultime të domosdoshme paraprake me partitë relevante; është në masë nënçmuese për spektrin e gjerë politik, qytetar dhe minoritar.

Prandaj, Partia Demokratike konsideron se Deklaratës i mungon baza e një platformeje të qartë politike: nuk dihet me kë të bisedohet apo negociohet; nuk dihet për çka duhet biseduar, prandaj iniciativa e tillë duhet të japë kohë dhe hapësirë për konsultim ndërpartiak, e pastaj të silllet për miratim në Kuvend. Dikush mund të thotë që: Mos të humbim kohë! Të veprojmë shpejt! Duhet të përgatitemi si Kosovë!

Partia Demokratike e Kosovës pajtohet plotësisht, por thekson se: Kosova dhe qytetarët e saj janë të përgatitur për shtet të pavarur dhe sovran qysh sot. Madje, kemi qenë të përgatitur në qershor të vitit 1999 kur edhe është marrë vendimi historik për liri dhe pavarësinë e Kosovës. Qytetarët e Kosovës mendojnë se të tjerët duhet të jenë më të përgatitur për ta njohur vullnetin e tyre për pavarësi dhe sovranitet. Për zgjidhje më pak se shtet mos të na ftojë të përgatitemi, sepse nuk mundemi dhe nuk jemi të gatshëm. Të gjitha partitë e kanë obligim të respektojnë vullnetin e qytetarëve të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës angazhohet seriozisht dhe me sinqeritet për krijimin e unitetit kombëtar e qytetar për shtetin e pavarur dhe sovran.

Angazhimi ynë i përhershëm do të jetë për shtetin ligjor ku qytetarët nuk do të majorizohen a diskriminohen pse janë shumicë apo pakicë. Ne do të kërkojmë që në Kuvendin e Kosovës të ratifikohen të gjitha aktet normative ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, mbi komunitetin pakicë si dhe kartat tjera me rëndësi ndërkombëtare. Do të kërkojmë që këto akte normative të sanksionohen edhe në kushtetutën e ardhshme të Kosovës, në kushtetutën e standardeve Euroatlantike.

Ju faleminderit për respektin.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Lus përfaqësuesin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Alush Gashi, ta marrë fjalën. Urdhëroni profesor.

DEPUTETI ALUSH GASHI:

I nderuari zoti Kryetar,

Gjendja e tanishme, është e paqëndrueshme. Pavarësia e plotë tani, dhe pa vonesë, si dhe emancipimi ekonomik - janë të domosdoshme për hapje të perspektivës për paqe të qëndrueshme.

Vonesa e pavarësimit të plotë, me sovranitet bashkëkohor, dhe formulimet e mjegulluara për status të ardhshëm, në vend të statusit përfundimtar, si dhe lojërat pakufi të atyre që bënë gjenocid në Kosovë - i kërcojnë të arriturat e përbashkëta.

Ne, jemi përcaktuar dhe angazhohemi për paqe dhe raporte korrekte me bashkësinë ndërkombëtare dhe të gjithë fqinjët tanë, por jo në dëm të pavarësisë.

Zotëri Kryetar,

Me shumë respekt e kemi shqyrtuar Deklaratën presidenciale të ekselencës së tij Presidentit të Kosovës doktor Ibrahim Rugova, të shpallur më 13 shtator 2005, të evidentuar në regjistër Numër 02-679, të shpërndarë për deputetët më 20 shtator 2005, e që ka të bëjë me vendimin për krijim të ndjenjës së unitetit, me emërim të ekipit që do të punojë - për të ardhmen e vendit tonë - siç thuhet mes tjerash në tekst.

Është për t'u mirëpritur dhe mbështetur angazhimi institucional për krijim të unitetit institucional në kohë të mohimit të plotë që i bëhet Kosovës në përfaqësim ndërkombëtar. Mohimi i së drejtës së Kosovës për përfaqësim ndërkombëtar krijon vështirësi dhe konfuzion në kohë të përpjekjeve për krijim të raporteve të reja paqësore dhe të qëndrueshme të Kosovës me fqinjët dhe bashkësinë ndërkombëtare.

Kërkesa dhe gatishmëria e Kosovës për marrje të përgjegjësive të plota vendore dhe të përfaqësimit ndërkombëtar nuk është kërcënim, por është shprehje e përgjegjësisë së lartë. Është kërkesë për liri, të mbështetur në përgjithësi.

Hyrja në aranzhmane për krijim të raporteve të reja me fqinjët dhe bashkësinë ndërkombëtare (që disa i quajnë bisedime, të tjerët negociata, e ne zotohemi për vetëvendosje) pa transfer të plotë të kompetencave në të gjitha lëmitë, në veçanti politike të jashtme - është shëmtim i procesit dhe vështirësi shtesë për faktorin kosovar.

Zotëri Kryetar,

Me njohje të Deklaratës presidenciale, lidhur me delegacionin e unitetit, LDK-ja kërkon sjellje në kuadër të Deklaratës së pavarësisë së vitit 1990, të Referendumit të vitit 1991 si dhe të obligimeve elektorale të cilat mandatojnë përfaqësuesit e Kosovës të të gjitha niveleve për pavarësi të plotë të Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Me shprehje të respektit dhe konsideratave më të larta për të gjithë ata që ndihmuan Kosovën, e në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës për rolin prijës për çlirimin e Kosovës, edhe me këtë rast e rikonfirmojmë përcaktimin tonë që Kosova e pavarur, me sovranitet bashkëkohor, do të jetë anëtare e denjë e bashkësisë ndërkombëtare me respektim të plotë të të drejtave njerëzore dhe kombëtare për të

gjithë qytetarët e saj dhe me raporte fqinjësore korrekte me të gjithë fqinjët, të bindur se Kosova e pavarur është faktor i stabilitetit.

Ju faleminderit!

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, ju faleminderit. E ka fjalën përfaqësuesja i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Gjylnaze Syla.

#### DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:

Faleminderit. I nderuari zotëri Kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë, mysafirë të nderuar,

Pas më shumë se gjashtë vite të administrimit nën autoritetin e Rezolutës 1244, konsiderojmë se zhvillim jetik për Kosovën është hapja e perspektivës për përcaktimin e statusit të Kosovës. Duke marrë parasysh zhvillimet në Kosovë gjatë kësaj periudhe, besojmë se janë realizuar objektivat e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kosova mund të hyjë në fazën përfundimtare të përcaktuar me vetë Rezolutën - fazën e përcaktimit të statusit politik të saj.

Gjatë këtyre gjashtë viteve, janë arritur rezultate të konsiderueshme në Kosovë, përkundër shkatërrimeve të mëdha materiale nga lufta dhe plagëve shpirtërore të qytetarëve të Kosovës, të shkaktuara nga regjimi serb.

Falë vendosmërisë së qytetarëve të saj, të përkrahur nga institucionet dhe bashkësia ndërkombëtare, Kosova ka arritur që brenda një periudhe të shkurtër të rindërtojë vendin, të ndërtojë institucionet demokratike, të krijojë një ambient relativisht të sigurt dhe të krijojë një atmosferë tolerante për bashkëjetesën me të gjitha kombet e tjera pakicë. Së bashku me kontributin e kombeve tjera pakicë, qytetarët e Kosovës kanë arritur të krijojnë institucionet e para demokratike në Kosovë. Institucionet e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës kanë dëshmuar se identifikohen dhe janë të përkushtuar në realizimin e të gjitha idealeve demokratike të cilat janë arritur në shtetet demokratike.

Tani kur gjendemi para vendosjes së statusit përfundimtar për Kosovën, të gjitha grupet politike dhe shtresat tjera shoqërore edhe ato të bashkësive tjera etnike joshqiptare, përveç dy subjekteve politike serbe, janë unike për formën në të cilën statusi politik i Kosovës duhet të zgjidhet.

Statusi politik i Kosovës, duhet të zgjidhet në pajtueshmëri me vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Se në çfarë Kosove duhet të jetojnë qytetarët e saj, duhet ata vetë të vendosin.

E drejta për vetëvendosje, është një çështje parimore, e pakontestueshme dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare, përkatësisht Konventën mbi të drejtat civile dhe politike të njeriut dhe Konventën mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të miratuara nga Asamblea e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. E drejta për vetëvendosje, i është garantuar popullit kosovar edhe në vetë Marrëveshjen e Rambujesë, të cilës i referohet edhe Rezoluta 1244.

Vullneti i qytetarëve të Kosovës, nuk është i negociueshëm. Ky është qëndrimi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Institucionet e Kosovës janë të obliguara dhe do të obligohen që të garantojnë të drejtat e qytetarëve të saj, e sidomos të qytetarëve që i takojnë etnive tjera kombëtare. Standardi i mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve, do të jetë në nivelin e standardeve të shteteve të tjera evropiane. Se ky standard do të arrihet, dëshmojnë edhe veprimet e Qeverisë së Kosovës për sigurimin e lëvizjes së lirë të të gjitha minoriteteve, posaçërisht minoritetit serb dhe kthimin e tyre në shtëpi. Përpjekjet që janë duke i bërë institucionet e Kosovës në këtë drejtim, mund t'ju shërbejnë shembull qeverive tjera në shtetet fqinje në relacion me pakicat kombëtare. Natyrisht, mbetet ende shumë punë për t'u bërë. Megjithatë, vendosmëria e institucioneve të Kosovës në drejtim të krijimit të kushteve optimale për jetesën dhe lëvizjen e lirë të të gjithë qytetarëve është evidente dhe një proces i cili nuk mund të kthehet prapa. Përparimi në proceset e lartpërmendura, ka qenë edhe parakusht për fillimin e bisedimeve për statusin përfundimtar të Kosovës.

Në këtë kohë historike për Kosovën, institucionet e Kosovës, kanë rënë në dakord për krijimin e ekipit gjithëpërfshirës. Përcaktimi i statusit politik të Kosovës, është moment vendimtar për popullin e Kosovës. Ky moment kërkon përgatitje, punë dhe përkushtim të madh politik. Ideja për krijimin e ekipit të unitetit, i cili do të përgatitë dhe orientojë Kosovën në procesin e përcaktimit të statusit politik, është përshëndetur nga Grupi Parlamentar i Aleancës.

Presidenti i Kosovës doktor Ibrahim Rugova e ka emëruar përbërjen e ekipit të unitetit dhe koordinatorin e tij. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet dhe mirëpret vendimin e Presidentit dhe konsideron se ekipi ka legjitimitetin e plotë të popullit të Kosovës për të përgatitur platformën dhe bisedat për statusin e Kosovës.

Grupi Parlamentar i AAK, uron që ky institucion të fillojë punën sa më shpejt, dhe i ofron këtij institucioni mbështetje të plotë në punën e tij.

Besojmë se Qeveria e Kosovës, në mënyrë të përshpejtuar, do të vendosë për krijimin e një buxheti të veçantë për këtë institucion që është parakusht vendimtar për punën efikase të këtij institucioni.

Grupi parlamentar i AAK fton deputetët e Kuvendit dhe qytetarët e Kosovës të përkrahin vendimin e Presidentit të Kosovës dhe punën e këtij institucioni.

Ju faleminderit!

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Gjylnaze, ju faleminderit. E ka fjalën përfaqësuesi i Grupit Parlamentar ORA dhe në emër të saj Veton Surroi. Urdhëroni zoti Surroi.

#### DEPUTETI VETON SURROI:

Të nderuar zonja dhe zotërinj,  
Negociatat kanë filluar në fakt që prej vitit 1999, që nga përfundimi i bombardimeve. Çdo ditë e kaluar në Kosovën e pasluftës, ka qenë pjesë e procesit negociator, ka qenë vendosja e realitetit të ri në terren. Një pjesë e atij realiteti është pozitive: është fakti që sot kur hyn në kufirin e Kosovës të kontrollon



polici i Shërbimit Policor të Kosovës. Një pjesë e atij realiteti është negative, fakti që: po ai polic i Shërbimit Policor të Kosovës nuk mund të garantojë tërësinë tokësore të Kosovës.

Çdo ditë, në këto gjashtë vitet e kaluara, qoftë nga aspekti ekonomik, kulturor, politik, nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave minoritare - ka qenë në fakt një proces negociator dhe në atë proces negociator kanë marrë pjesë që të gjithë, në radhë të parë, të gjithë ata që kanë marrë pjesë në jetën politike kosovare. Pra, në atë proces negociator janë krijuar rezultate të cilat janë krijuar, por janë krijuar edhe dobësitë të cilat do të ndikojnë seriozisht në fundin e këtij procesi negociator. Po të kishin shkuar gjërat ashtu siç duhej, Kosova do të duhej të ishte e pavarur ka kohë. Për fat të keq, nuk kanë shkuar si duhet, dhe - për fat të keq - duhet të hyjmë jo në njohjen formale të një pavarësie ekzistuese, por në një proces negociator.

Në këtë, natyrisht, çdokush e ka barrën dhe përgjegjësinë e vet. Ne kemi tërheq vërejtjen si për këtë ashtu edhe për atë qeveri që mos t'i hyjë në formë parciale procesit të decentralizimit, sepse procesi i decentralizimit do të jetë pjesë e negociatave të statusit. Dhe, siç shohim, kështu edhe po na rezulton. Ne do të hyjmë në proces negociator për status, edhe decentralizimi do të futet në të, por paraprakisht janë hüdër disa hapa të cilët nuk mund të kthehen më.

Dy çështje janë themelore në procesin e ardhshëm negociator: Niveli i ndërhyrjes së bashkësisë ndërkombëtare pas përcaktimit të statusit. Kjo do të thotë: çfarë do të jetë roli i bashkësisë ndërkombëtare pas përcaktimit të statusit? Dhe, esencialisht, dy: Niveli i vetëadministrimit territorial dhe joterritorial të pakicës serbe në Kosovë? Këto janë realisht dy pikat thelbësore të procesit negociator, ashtu siç janë ravizuar deri më sot.

Në këso shtate, pragmatizmi politik i një subjekti, për shembull - çfarë është ORA, do të duhej të ishte mos të marrim pjesë, të mos marrim pjesë fare në këtë proces, të tërhiqemi, sepse ne nuk kemi qenë pjesëmarrës në këto konsekuenca që janë bërë, nuk kemi qenë pjesë në decentralizim, nuk kemi qenë pjesë në asnjërin prej segmenteve të keqqeverisjes, prandaj s'do të duhej të merrim pjesë as në pasojat negative që do të dalin, sepse disa prej tyre do të jenë negative.

Megjithatë, këtu nuk bëhet fjalë për pragmatizëm politik, bëhet fjalë për parimësi. Në parimësi çështja e statusit të Kosovës, kemi theksuar, është çështje e të gjithëve, është çështje e konsensusit dhe ne kemi ndërmend të marrim pjesë dhe t'i përgjigjemi pozitivisht ftesës së Kryetarit Rugova. Kjo është një ftesë parimore, për të cilën duhet të deklarohemi. Nuk mendoj se do të duhej të bëhet formale në Parlament. Është brenda pozitës kushtetuese të Kryetarit që të bëjë iniciimin e një procedure të këtillë, është pjesë e debatit politik dhe marrëveshjes politike që duhet ta kenë subjektet politike me Kryetarin e Kosovës.

Ne mendojmë se, kështu siç ia ka filluar kjo mbledhje, nuk do të duhej të vazhdonte në këtë kuptim. Unë mendoj se nuk ekziston, dhe n'fund e n'themel nuk mund të ekzistojë një qëndrim i cili do të ishte kundër konsensusit në Kosovë. Çështjet e detajeve se si do të shkojë procesi negociator, si do të formohen grupet punuese, a do të formohen brenda ministrive, apo jo - është çështje të cilën duhet ta përcaktojë grupi themeltar negociator, i propozuar nga Kryetari Rugova.

Ne nuk do të duhej të deklaroheshim këtu për këto hollësi, sepse këto janë hollësi të cilat do të mund të ngatërronin çështjen themeltare, e çështja themeltare është se duhet të themelohet, duhet të vendoset grupi bazik, ashtu siç e ka propozuar Kryetari e pastaj të përpunohen detajet dhe këto detaje të sillen në Parlamentin e Kosovës për miratim, së bashku me platformën.

Si të këtitllë, mendoj - zoti Kryetar, se do të duhej të paralajmëronim një mbledhje të ardhshme, e cila do të binte pas takimit me Kryetarin dhe pas dakordimit të detajeve dhe parimeve themelore të funksionimit me Kryetarin Rugova.

Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit zoti Surroi. Dhe tani e ka fjalën Mahir Jagxhillar, nga Grupi Parlamentar 6+.  
Urdhëroni Mahir.

DEPUTETI MAHIR YAGCILAR:

Faleminderit zoti Kryetar.  
Sayın Başkan, Sayın Milletvekilleri,

6+ Parlamento Gurubu adına sözü alarak, en başta müzakereler ekibinde bizlere de yer verilmesi gereğini vurgulamak istiyorum, çünkü bizler kendimizi Kosovanın ayrılmaz bir parçası olarak görmekteyiz. Geçmişte yapıcı olduğumuz gibi, gelecekte de yapıcı olmak istiyoruz, bundan dolayı bu süreç esnasında da yapıcı olmak istiyoruz ve görüşmeler sürecine ve Kosovanın nihayi statüsüne karşı olduğumuz gibi bir duruma düşmek istemiyoruz.

Herhalde Kosova Başkanı çok yönlü düşünerek, en iyi müzakere ekibini kurmaya gayret etmektedir. Bu sebeplerden dolayı önerilen deklarasyon için onaylama hazırlığımızı olduğunu bildirmek istiyorum. Bu arada da, bu süreçte Kosovanın gelecek statüsü ve azınlık toplumların statüsü için tüm yükü ve sorumluluğu Arnavut temsilcileri taşıyacağını vurgularken saygılarımı sunarım.

Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Dhe, më lejoni, në fund të fjalëve të udhëheqësve të grupeve parlamentare, t'ju them se Parlamenti ka bërë të gjitha konsultimet juridiko-procedurale dhe është i këshilluar që debat për nominimin e Presidentit të Kosovës të mos ketë. Mirëpo, unë kam dashur që shefat e grupeve parlamentare ta servojnë opinionin e tyre, jo vetëm për opinionin vendor por edhe atë ndërkombëtar, dhe të gjitha sugjerimet që janë bërë nga fjalët hyrëse të shefave të grupeve parlamentare do të jenë objekt i punës së ardhshme të grupeve punuese me seriozitetin më të madh.

Tani ju ftoj ta votojmë Deklaratën.

Ju lutem! Kush është për? Shumica absolute është për. Ju faleminderit shumë.  
Kush është kundër?

(Pas ndërhyrjes së deputetit E. Xhemajli)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, zotëri Xhemajli! Nuk ka mundësi për debat asnjë sekondë. Ju lutem, mos ia ulni vlerën seancës.

(Ndërprerje e shkurtër nga regjia)

Ju lutem, secili deputet të ulet në vendin e vet. Mund të flisni, vetëm atëherë kur ua jap fjalën. Për hir të dokumentacionit, lus të gjithë ata që janë në këmbë, të ulen në vendet e veta.

(Ndërprerje e shkurtër nga regjia)

Procedura e votimit, ka përfunduar.  
Asnjë deputet, nuk është kundër.  
Shumica absolute është për.

Tani ju propozoj të bëjmë një pauzë prej njëzet minutash. Ju faleminderit shumë.

(Vijoi pauza)

(Pas pauze Seanca plenare vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Lus deputetët t'i zënë vendet e veta në mënyrë që të vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

(Ndërprerje toni – ndërhyrje e deputetëve pa kyçje të mikrofonit)

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore.**

(Ndërprerje toni – ndërhyrje e deputetëve pa kyçje të mikrofonit)

Unë lus deputetët të ulen në vendet e tyre të punës dhe të vazhdojmë.

Konstatimet hyrëse:

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë me 27 janar 2005.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime me amendamentet vijuese.

(Ndërprerje nga regjia)

Atëherë, punën e Seancës plenare do ta vazhdojmë nesër në orën 10,00. Ju faleminderit.

(Në mungesë të kuorumit, nga ky moment Kryetari ndërprente Seancën)

(Seanca plenare vazhdoi punën me datë 29.09.2005 në orën 10.00.)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjesi. Mirëseardhje në vazhdim të punës së Seancës plenare. Në sallë janë 79 deputetë të pranishëm, prandaj mund të fillojmë me punë.

Kam informacion se për fjalë është paraqitur, si deputet – në emër të Grupit Parlamentar, zoti Hashim Thaçi. Urdhëroni, zoti Thaçi.

DEPUTETI HASHIM THAÇI:

I nderuari zotëri Kryetar,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar të pranishëm – mysafirë të kësaj Seance në Parlamentin e Kosovës,

Dje, derisa tërë opinioni publik i vendit dhe ndërkombëtar, po priste një vendim denjëtoz nga Parlamenti i vendit; që do të përçonte frymën e unitetit dhe konsensusit të gjerë nacional e politik, ndodhi diçka e papëlqyeshme këtu, ndodhi diçka shqetësuese që në fakt nuk dëshmoi shkallën e vërtetë të atij uniteti dhe sinqeriteti që jo rrallë e dëgjojmë si konsum politik, ashtu që, fatkeqësisht, nuk u përçua edhe tek qytetarët mesazhi i besimit, mirëkuptimit dhe transparencës ndaj këtij Parlamenti dhe tërë skenës politike kosovare.

Të nderuar deputetë,  
Stabiliteti politik i vendit dhe siguria, janë parakushte themelore të ndërmarrjes së çfarëdo vendimi politik. Bashkëpunimi dhe uniteti janë garanti e besimit qytetar se do të mbrohen denjësisht interesat e tyre, gjersa transparenca në proces eviton keqkuptimet dhe manipulimet me vullnetin e qytetarëve, që është ndërtimi i shtetit të lirë dhe demokratik.

Dje, në parlament, për fat të keq, nuk ndodhi kjo. Po, si për çudi, në rast të vendimeve të mëdha, jo vetëm këtë herë, por edhe radhëve të tjera, vërehet një dozë shqetësimi dhe nxitimi në trajtimin e propozimeve dhe marrjen e vendimeve politike në këtë Parlament në formë mekanike që të përkujton fanatizmin ekstrem të lojërave partiake në periudhën e ekzekutimeve të vendimeve të komiteteve të partisë në kohën e inkuizicionit komunist.

Të nderuar deputetë, i nderuari zotëri Kryetar, të nderuar mysafirë,  
Kosova u takon të gjithë qytetarëve të saj. Po për fatin e saj, jo gjithmonë, kanë vendosur ata. Prandaj, është koha dhe janë krijuar kushtet që kjo e drejtë demokratike të ndodhë, madje qysh sot.

Nuk kemi kohë për të humbur. Çdo çast i shtyrjes, është një hap më larg nga synimi ynë i përbashkët. Historia e Kosovës dhe e qytetarëve të saj, është e dhembshme, por ne të gjithë kemi bërë punë që kjo histori të jetë krenare, dhe secili nga ne dhe të gjithë qytetarët e Kosovës të ndihen krenarë.

Qytetarët e Kosovës, në një formë a formën tjetër, të gjithë kanë kontribuar për çlirimin dhe lirinë e saj. Uniteti i popullit, qëndresa heroike kanë qenë vlerat më të mëdha që populli ynë ka treguar atë kohë.

Mosdëgjueshmëria qytetare kosovare në vitet 1990 - 1997 kulmoi me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila u finalizua me përkrahjen diplomatike dhe ushtarake nga bashkësia ndërkombëtare, dhe përfundimisht Kosova u bë e lirë.

Të nderuar deputetë,

Kjo ishte koha e vendimeve të mëdha për çlirimin dhe lirinë e Kosovës. Sot, është koha e njohjes dhe e legjitimitetit ndërkombëtar të këtij realiteti. Kohë dhe vendim më historik për popullin e Kosovës sesa largimi i ushtrisë, policisë dhe administratës së Serbisë nga Kosova kurrë më nuk do të mund të arrihet.

Kosova dhe ndërkombëtarët, me rolin e tyre udhëheqës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shënuan suksese të përbashkëta. Do të jemi mirënjohës dhe falënderues për jetë për këtë kontribut.

Çlirimi dhe liria e Kosovës, reflektoi paqe dhe demokratizim në tërë Ballkanin. Dje ishim rajon me konflikt secili me secilin! Sot, i gjithë rajoni është në transformim politik, ushtarak, ekonomik dhe shoqëror. Janë rritur përpjekjet nga të gjithë për integrim në Bashkim Evropian dhe strukturat Euroatlantike. Ky është kontribut edhe i kosovarëve.

Kosova ka realizuar standardet demokratike në nivel të kënaqshëm për t'i hapur vetes perspektivë moderne perëndimore. Mirëpo, për dallim nga të tjerët, e vetmja Kosova ka mbetur me status të padefinuar.

Të nderuar deputetë,

Është koha për qartësim nga të gjithë faktorët relevantë që merren me çështjen e statusit politik të Kosovës. Për fat të mirë, populli i Kosovës është i qartë. Vullnetin e vet e ka shprehur botërisht. Nuk kërkon as më shumë, e as më pak sesa të drejtat që kanë popujt tjerë.

Partitë politike, të përfaqësuara në Parlamentin e Kosovës por edhe ato që nuk janë të përfaqësuara në Parlamentin e Kosovës, votat e tyre i kanë fituar me premtimin për bërjen e pavarësisë së Kosovës – të gjithë ne. Këtë premtim, duhet ta realizojmë me unitet politik, qytetar dhe transparencë. Populli i Kosovës ka nevojë për vendime tona të drejta. Gjithashtu, edhe ne, përfaqësuesit e zgjedhur kemi nevojë për mbështetje në implementim.

Deputetë të nderuar,

Bërja e shtetit të Kosovës është më tepër sesa premtim elektorale, çështje individi apo partie. Është më tepër se meritokraci historike, është jetë për këtë vend dhe popull.

Të nderuar deputetë,

Pavarësia e Kosovës është e drejtë e pakontestueshme, mision dhe vizion qytetar dhe politik i të gjithë kosovarëve. Për ndërtimin e shtetit të Kosovës, kemi sakrifikuar të gjithë, gjenerata të tëra. Askush nuk ka sakrifikuar për gjysmë liri, por për shtet të pavarur dhe sovran të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj për unitet qëllimi dhe jo unitet formal. Jo unitet rreth individëve, por vizioni për veprim pozitiv e jo për fjalë të thata, për angazhime konkrete e jo për zvarritje të procesit për ndërtim të shtetit. Nuk

kemi çka të hezitohet! Të drejtën tonë duhet ta deklarojmë hapur dhe botërisht. Nuk kemi shumë zgjidhje. Ajo është një, dhe e panegociueshme: pavarësia e Kosovës.

Të nderuar kolegë, të respektuar deputetë,

Çështja e statusit politik të Kosovës, nuk duhet të jetë çështje e kalkulimeve politike, por e vendimeve historike që ne si deputetë – të zgjedhur nga populli i Kosovës – duhet t'i nxjerrim këtu.

Prandaj, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës,

- duke u nisur nga gjendja ekzistuese e Kosovës, në kohën e para definimit të statusit final të saj;
- duke u nisur nga vullneti i qartë i qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran;
- duke u nisur nga konfirmimet e disahershme të qytetarëve të Kosovës me akte politike dhe përmes luftës së armatosur kundër pushtimit, dhe
- duke u nisur nga nevoja e fuqizimit të vullnetit të qytetarëve të Kosovës dhe institucionalizimit të tij para faktorëve vendor dhe ndërkombëtar,

i p r o p o z o j m ë Kuvendit të Kosovës ta nxjerrë këtë:

### REZOLUTË:

1. Kuvendi i Kosovës kërkon që të rikonfirmohet vullneti i popullit të Kosovës nga të gjitha partitë politike për shtet të pavarur dhe sovran të Kosovës;
2. Kuvendi i Kosovës të merr qëndrim për mosnegocim për pavarësinë e Kosovës, sepse vullneti i qytetarëve të Kosovës është i panegociueshëm.
3. Kuvendi i Kosovës kërkon që për çdo vendim politik nga bisedimet apo marrëveshjet definitive të kenë ratifikim të Kuvendit të Kosovës, apo përmes referendumit nga qytetarët e Kosovës.

Të nderuar dhe respektuar kuvendarë,

Vendimi dhe e drejta e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran nuk duhet asesi t'u lihen në dorë pesë individëve, qofshin ata liderë politik, e që mund të lakohen në procesin, por duhet të nxirret vendimi i qëndrueshëm i cili do të ketë përkrahje të të gjithë qytetarëve dhe të gjitha forcave politike në Kosovë dhe forcave demokratike në botë. Faleminderit.

Zoti Kryetar,

Propozimi është konkret. Ftoj që këtij propozimi t'i bashkëngjitni me sinqeritetin më të lartë. Nuk dua që kjo çështje të jetë prioritet i kësaj apo asaj partie, por të arrihet me një konsensus nga grupet parlamentare, të zhvillojnë një konsultë shifat e grupeve parlamentare dhe pastaj të ketë mundësi e hapësirë për modifikim të kësaj rezolute për plotësim, e pastaj të rikonfirmojmë vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Të gjithë janë deklaruar për pavarësi! Të gjithë qytetarët, edhe ne si qytetarë, por si deputetë nuk kemi rikonfirmuar vullnetin që është shprehur. Prandaj, i vetmi ky vend për të cilin qytetarët na kanë zgjedhur, ka mbetur pa u deklaruar. Është koha që të deklarohet dhe të mos humbim kohë. Ose, nëse nuk ndodhë, po unë besoj se do të ndodhë, sepse besoj në vullnetin e mirë dhe të sinqertë të shefave të grupeve parlamentare dhe të të gjitha partive që janë këtu, se do të arrihet një

marrëveshje për modifikim të kësaj rezolute. Në të kundërtën, propozoj që rezoluta jonë të vihet në votim në Parlamentin e Kosovës. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Thaçi, ju faleminderit shumë. Më lejoni t'ju drejtohem si kryesues i Seancës dhe si Kryetar. A nuk ishte vendi që pikërisht një diskutim nga Grupi Parlamentar i PDK-ës të nisej me këtë fjalë të sotme dhe t'i jepej një shans tjetër Kuvendit. Unë po ju them për atë që është e mundshme, duke mos e kontestuar një pjesë enorme të madhe të fjalës tuaj, si çështje, duhet të shkojë me procedurë të rregullt në Zyrën për parashtrësia. Unë mendoj se është një dokument për të cilin mund të bisedohet, dhe ka shumë çështje që dje janë thënë nga të gjitha grupet dhe kemi qenë shumë afër për një konsensus.

Mbajeni në mend! Ftesa, që iu është bërë liderëve partiak për një kafe pune, ka pas për qëllim përgatitjen e seancës plenare e jo marrjen e ingerencave dhe të thuhet se nuk ka të drejtë kushtetuese Kryetari i Parlamentit për përgatitje të këtilla të rëndësishme. Edhe kjo verifikon, se është shumë më mirë që çështjet e këtilla, ku në 90% të rasteve kemi qasje identike, të shkojë në një rrugë tjetër, e jo siç u tentua dje.

Prandaj, unë nuk e shoh si çështje të ngutshme dhe këtë ma lejon edhe Kushtetuta edhe Rregullorja, por të shkojë në procedurë të rregullt, me gjasë të përkrahjes, sepse unë nuk pash se ka çështje kontestuese në mes Grupit Parlamentar të LDK dje dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të Grupit 6+ ose të ORA-s me këtë që ju e thatë sot.

Prandaj, ju lutem të vazhdojmë me punën e Kuvendit, sipas rendit të ditës dhe të gjitha çështjet tjera të shtrohen në procedurë të rregullt. Unë derisa kam ardhë në seancë nuk kam pas asnjë kërkesë nga Zyra për parashtrësia. Kjo është shans. Unë besoj se shumë shpejt edhe Presidenti do ta ftojë këtë grup dhe gjatë punës së grupit në seancat tjera të arrijmë konsensusin e plotë.

Debat nuk kam hapur dhe asnjë deputet, ju lutem nuk mund të paraqitet. Këtë ai e shprehu në emër të Grupit Parlamentar kryetar i Partisë....

(Ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit, nuk dëgjohet për transkriptim)

...Zoti Koci, unë po ju lus. Këtë që thoni, shtroni në Zyrën e parashtrësive dhe asnjë person nuk do t'ua cungon të drejtën.

Gani, ne i kryem këto çështje. Tani kemi hy në rend dite, në pikën e tretë. E ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar, për kërkesë, e jo debat. Urdhëroni zotëri Jakup.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Zotëri Kryetar,

Unë propozoj, nëse shëfat e grupeve tjera parlamentare nuk janë të gatshëm të deklarohen, ta bëjmë një pushim, sepse Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka nevojë të konsultohet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë mendoj se ky propozim mund të aprovohet. Tani do të bëjmë një orë pushim, dhe gjatë kësaj kohe, urdhëroni e bisedoni, e pastaj do të vazhdojmë për vendimmarrje.

(Vijoi pauza)

(Pas pauze, Seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mendoj se mund të vazhdojmë punën. Kemi forum të nevojshëm.

Në saje të informacioneve që kam, do të doja të them se për çdo marrëveshje të arritur apo jo, e unë e kam fjalën për të arriturat, duhet t'i nënshtrohet ecurisë së mëtejshme sepse procedura kërkon që teksti duhet të ekzistojë dhe pastaj të futet në procedurë. Urdhëroni zoti Thaçi.

DEPUTETI HASHIM THAÇI:

Faleminderit zotëri Kryetar. Të nderuar deputetë,

Mendoj se propozimin të cilin e kemi prezantuar, do të ishte me rëndësi të ndodhë një qartësim në procedim në mënyrë që ta kemi të qartë secili, edhe ne si propozues, por edhe grupet tjera parlamentare. Propozimi ynë, do të thotë, ishte shumë konkret shpresoj të një arritjeje të një konsensusi të duhur në mes spektrit politik këtu të përfaqësuar në Parlament në mënyrë që të deklarohen grupet parlamentare se a janë të ndodhë ky rikonfirmim sot apo të caktohet një seancë tjetër për arritjen e këtij konsensusi në mes grupeve parlamentare apo të kemi deklarim sot këtu, kështu që kisha pas edhe dëshirë, por në të njëjtën kohë edhe do të ishte shumë korrekte politikisht që t'i dëgjojmë edhe opinionet e të tjerëve për propozimin konkret të cilin e prezantoi Partia Demokratike e Kosovës. Faleminderit për mirëkuptim.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E ka fjalën profesor Alush Gashi, nga Lidhja Demokratike. Urdhëroni Alush.

DEPUTETI ALUSH GASHI:

I nderuari zotëri Kryetar, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ne dje kemi ardhë në seancë plenare me një rend dite dhe ai rend dite është pranuar në tërësi. Ne kemi shterur pikën e parë dhe pikën e dytë të rendit të ditës. Jemi të gatshëm që, sipas atij rendi të ditës, të punojmë.

Në ndërkohë, ne dëgjuam me shumë vëmendje një propozim apo një nismë të Partisë Demokratike. Ne si Lidhje Demokratike i mirëpresim të gjitha iniciativat dhe lusim Kryetarin e Kuvendit - Kryesinë e Kuvendit që t'i respektojë ligjet në fuqi, Rregulloren në fuqi dhe ne si Grup Parlamentar do të japim kontributin tonë pasi që ta marrim atë iniciativë në formë të shkruar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, ju faleminderit. E ka fjalën Naim Maloku, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

DEPUTETI NAIM MALOKU:



I nderuari zoti Kryetar, të nderuar deputetë,

Ne me vëmendje ndoqëm vazhdimin e Seancës së djeshme sot. Ne me vëmendje, si Grup Parlamentar dëgjuam dhe pastaj shqyrtuam fjalën e zotit Thaçi. Unë, në emër të Grupit Parlamentar të AAK them se AAK është për konsensus, për çka është shprehur edhe dje. Kjo mund të shikohet edhe nga transkripti i Seancës së djeshme, pra nga të gjitha grupet parlamentare në lidhje me Grupin e propozuar nga Kryetari Rugova. Unë mund tani të them, në këtë moment në emër të Grupit Parlamentar të AAK se më pëlqeu fjalimi i zotit Thaçi, por asgjë të shkruar nuk kemi, për do të mund të votojmë.

Grupi Parlamentar i AAK, do të marrë pjesë në harmonizimin e rezolutës apo deklaratës – për të cilën do të merremi vesh, në mënyrë aktive.

I nderuari zoti Kryetar, të nderuar deputetë,

Më lejoni që të qartësoj edhe një herë qëndrimin e Grupit Parlamentar të AAK lidhur me grupin e miratuar dje në Parlamentin e Kosovës.

Grupi Parlamentar i AAK ka besim të plotë në grupin e miratuar dje si tërësi nën udhëheqjen e Kryetarit Rugova dhe në secilin anëtar të grupit veç e veç, dhe këtë Grup e konsiderojmë si grup për pavarësinë e Kosovës. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Në emër të ORA-s, a dëshiron ndokush? Urdhëroni zoti Surroi.

#### DEPUTETI VETON SURROI:

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Edhe ne përcollëm me vëmendje iniciativën e Partisë Demokratike të Kosovës. Përmbajtja është e atillë që ne do ta përkrahim. Një përmbajtje të kësaj do të duhej ta inkuadronim në procedurë. Sot nuk do të duhej të deklaroheshim, sepse për kësë dhe iniciativa të tjera duhet unifikuar qëndrimet në mes grupeve parlamentare. Unë besoj se, nga ato që dëgjuam dje, dhe sot – nuk ka kush gjë kundër një kësë përmbajtjeje. Ndërsa, përnga forma, do të sugjeroja që kësë dhe përmbajtje të tjera do të duhej të kyçeshin jo në një rezolutë e as në një deklaratë, po do të duhej të inkuadroheshin në një platformë negociatore të cilën Grupi negociator i emëruar duhej t'ia prezantonte Parlamentit dhe ky Parlament të unifikonte qëndrimet dhe ato të ishin qëndrime politike të Kuvendit të Kosovës, të cilat Grupi negociator do të duhej dhe do të ishte i obliguar t'i mbronte në procesin e ardhshëm negociator. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Mahir?

#### DEPUTETI MAHIR YAGCILAR:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar deputetë,

Ne dje i kemi shpallur qëndrimet. Edhe sot jemi të gatshëm të japim kontributin e duhur. Jemi të interesuar për zgjidhjen e statusit të Kosovës bashkë, sigurisht, edhe me statusin e komuniteteve në kuadër të saj. Ne vetëm presim unifikimin e qëndrimeve të shumicës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë besoj se ishim të qartë. Unë i dija mendimet e të gjithëve, por desha ta ruaj propozuesin dhe respektin që kjo të shkojë në një procedurë që do të vjen në Kuvend dhe ne do ta zgjedhim një rrugë që veç është konceptuar, një rrugë më të thjeshtë dhe tjetër. Prandaj, do të punohet me shumë përkushtim që ky unitet të zmadhohet sepse asnjë dallim nuk është pa dje në qëndrimet e grupeve kryesore, pos asaj që dolëm jashtë rendit të ditës. Prandaj, ju faleminderit.

Tani të vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

(Ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit)

Shef, debat nuk ka, të lutem. Është jashtë kontekstit. Ju lutem, të vazhdojmë me rendin e ditës. Dje ka qenë kjo çka thoni. Është aprovuar rendi i ditës. Faleminderit shumë. Naim, këtë dje e kemi pas për rend dite, dhe ashtu është aprovuar, s'ka pas askush vërejtje dhe tani vazhdojmë punën.

(Ndërhyrje e deputetit – pa kyçje të mikrofonit)

Mirë, mirë. Ai është mendim i juaj. Ne thamë se është kryer.

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore.**

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 27 janar 2005.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte e rekomandime - me amendamente, si vijon.

Para se të kalojë në sqarime, edhe disa çështje.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, si Komision funksional dhe raportues, Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale në vijim ka bërë radhitjen e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për sigurimet shëndetësore.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjisllacion dhe Kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për sigurimet shëndetësore ka bazë juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet ka konstatuar se dispozitat e Projektligjit për sigurimet shëndetësore dhe amendamentet e propozuara përmbajnë implikime buxhetore dhe financiare dhe ka propozuar shtyrjen e leximit të dytë deri në definimin e qartë për sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme për zbatimin e ligjit.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për sigurimet shëndetësore dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Lus Ministrin e shëndetësisë, zotin Sadik Idriz për sqarim. Urdhëroni zoti Ministër.

DEPUTETI SADIK IDRIZI:

Hvala Predsedniçe. Poštovani poslanici,

Prilikom usvajanja ovog Nacrta zakona u načelu, budžetske implikacije su iznosile milion i po eura za tri godine, za ovu godinu 360 hiljada, što je Vlada u ovom trenutku mogla da obezbedi. Medjutim, prilikom procedure kroz Komisiju za zdravstvo i socijalna pitanja u zakon su amandmanima uvrštene kategorije porodijskog i trudničkog bolovanja kao i opšteg bolovanja što je izazvalo nove budžetske implikacije odnosno ono na šta je reagovala Komisija za budžet.

Vlada je razmatrila ovo, i smatra da ovaj zakon treba da ide, ali ne sa ovim budžetskim implikacijama. S toga predlažemo da se odloži za narednu sednicu, da se sastanu Komisija za zdravstvo i Komisija za budžet i da usaglase svoje stavove.

Ovom prilikom, zahvaljujem se Funkcionalnoj komisiji koja je zaista radila na ovom zakonu dosta kvalitetno. Imali smo izuzetnu saradnju i nastavićemo kontakt do najbolje verzije koja bi mogla biti primenljiva. Inače, predvidjeno je ovim zakonom da se formira fond za zdravstveno osiguranje koji bi usaglasio svoja normativna akta u periodu od godinu dana, nakon usvajanja zakona.

Prema tome, ne želimo da zaustavimo proces usvajanja ovog zakona, ali želim da dodje do usaglašavanja između ovih dveju komisija i da za jedno od narednih sednica imamo jasniju situaciju. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, falemnderit. Tani e ka fjalën kryetarja e Komisionit dhe pastaj do të procedojmë. Urdhëroni zonja Kollçaku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU:

Faleminderit. Për fillim kisha me pyetur: A kemi kuorum që ta vazhdojmë punën?

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po, kemi. 61 deputetë janë në sallë.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU:

Faleminderit. Në emër të Komisionit desha të them se Komisioni ka punuar me përkushtim lidhur me këtë Projektligji, ka bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe mendojmë se të gjitha amendamentet shtesë janë të arsyeshme. Prandaj, duke pas parasysh se me kohë kemi kontaktuar, kemi thirrë edhe Ministrin e financave, kemi pritur që bashkëpunimi të jetë në nivel edhe të dy ministrive: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave lidhur me implikimet buxhetore.

Meqenëse implikimet buxhetore fillestare, që i përmendi Ministri, nënkuptohen implikime që janë për përgatitje teknike dhe kadrovike, gjegjësisht për infrastrukturë, e jo për mbushjen e fondit, sepse e dimë që fondi do të ketë mjete themelore financiare për sigurime shëndetësore dhe do të sigurohen nga shumë burime.

Ne pranojmë këtë sugjerim që edhe një herë të punojmë me Komisionin për buxhet mu për këtë se mendojmë që janë të arsyeshme të gjitha amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kryetare e Komisionit, ju falemnderit. Do të ishte dashur korrektësi nga kolegu i të njëjtit Grup parlamentar deri ta kryeni fjalën bile, e pastaj ta prishë kuorumin, por edhe kjo është pjesë e jetës demokratike.

Unë mendoj se sugjerimet e Ministrit dhe të Komisionit të gjithë i akceptojmë dhe nuk mund ta vazhdojmë për të marrë vendime. Ne mund t'i shqyrtojmë ligjet, dhe nesër të kërkojmë miratimin e tyre, sepse ekziston një mundësi e tillë, por më mirë do të ishte ta ndërprejmë punën dhe të vazhdojmë nesër në orën 10. Ose, në qoftë se të pranishmit mendojnë që të lëhet për javën e ardhshme kjo, jam në dispozicion ta vazhdojmë.

#### (Ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit)

Si të doni, por po e shoh që kërkohet pretekst!

#### (Ndërhyrje – propozime)

Mbetet të vazhdojmë javën e ardhshme.

I kam premtuar kryetarit të Partisë së hashkalinjve, që në fund të seancës, t'i shfrytëzojë dy minuta për diskutim. Sabit, urdhëroni i keni dy minuta në disponim për atë që keni kërkuar.

#### DEPUTETI SABIT RRAHMANI:

Zotëri Kryetar, ju faleminderit. Të nderuar ministra, të nderuar deputetë, të nderuar mysafirë, As dje, as sot, nuk kam qenë i gatshëm për me prish rend e qetësi, dhe s'jam i gatshëm për debat.

Unë e kam një kërkesë shumë të thjeshtë. Meqenëse edhe vetë Kryetari i Kosovës në Deklaratën e tij e ka potencuar që Kosova u takon të gjithë njerëzve që jetojnë këtu. Unë mendoj se edhe pakicat kombëtare joserbe janë pjesë e proceseve pozitive në Kosovë. Unë kisha kërkuar nga ky Kuvend dhe nga këta kuvendarë që, meqenëse është aprovuar dhe është votuar dje kërkesa për grupin negociator, së paku neve pjesëtarëve të pakicave kombëtare joserbe të na jepni kohë që ne ta zgjedhim një përfaqësues që të pjesë e këtyre bisedimeve dhe të votohet në Kuvend për këtë propozim. Nuk besoj se është kjo diçka e keqe. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë, ma ke shkruar ndryshe në letër!? Lidhur me këtë, të gjitha sugjerimet dhe punët që i kemi bërë janë se do të kyçen në grupe për tema të caktuara dhe për këtë është votuar grupi punues. Ju faleminderit. Të hënën do të vazhdojmë punën. Me propozimin tuaj, do të vazhdojmë me rend dite – me pikën e katërt. Ju faleminderit.

(Me kaq, puna e Seancës plenare të datës 29 shtator 2005 mori fund. Seanca vazhdon punën të hënën më 03 tetor 2005)

---

(Seanca Plenare vazhdoi punën më 03 tetor 2005 në orën 10,00)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjesi. Mirëseardhje në vazhdim të Seancës Plenare.

Kuorum pune kemi.

Të regjistruar janë 82, prandaj lus t'i përdorni kartelat sepse 92 janë të pranishëm dhe nuk ka asnjë "eskjuz" për ata që s'i përdorin kartelat. Do të thotë, mund të punojmë.

Ju informoj se ishim në shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore.

Ishte kërkesë e Ministrit dhe e kryetares së Komisionit që t'i lihet pak kohë dhe të hiqet nga seanca. Për këtë propozim u dakorduam.

Megjithatë, para se të kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, zoti Thaçi paraqitet për fjalë. Urdhëroni zoti Thaçi.

DEPUTETI HASHIM THAÇI:

I nderuari zoti Kryetar, i nderuari zoti Kryeministër, të nderuar deputetë, mysafirë të nderuar,

Jemi dakorduar që për çështjen të cilën e kemi ngritur si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe pastaj me një, mund të them, konsensus çështja e ngritur e Rezolutës për rikonfirmimin e vullnetit të popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran të diskutohet në të ardhmen e afërt, do të thotë jemi dakorduar të enjten, prandaj sot mendoj kjo çështje duhet të futet në rendin e ditës, sepse është proceduar në mënyrë të rregullt të remtën dhe është çështje urgjente, çështje e jashtëzakonshme.

Prandaj në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetë të nderuar ju ftoj dhe në mënyrë më të sigurtë ju them se sot jemi thirrur si asnjëherë më parë për veprime unike dhe vendime të përbashkëta.

Në të njëjtën kohë, ritheksoj se çështja e riformimit të vullnetit të popullit të Kosovës assesi nuk duhet të jetë çështje procedurale burokratike sepse është një vendim politik, është vullneti i qytetarëve të Kosovës dhe nuk duhet t'i nxjerrim veti pengesa krejt të panevojshme sepse është qëllim fisnik dhe është vendim politik i domosdoshëm për interesat e qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, më lejoni që t'ju drejtohem në emër të Partisë Demokratike të Kosovës për këtë çështje, edhe një herë.

Sot jemi thirrur si asnjëherë më parë për veprime unike dhe vendime të përbashkëta. Fundi i shekullit të kaluar kulmoi me çlirimin e vendit. Fillimi i këtij shekulli të ri duhet të fillojë me ndërtimin e shtetit të Kosovës. Jemi brez me fat që mundemi të kulmojmë përpjekjet për liri të brezave me radhë dhe tani jemi po ashtu me fat që mund të ndërtojmë shtetin e ri modern dhe demokratik të Kosovës të ëndërruar shekuj me radhë nga qytetarët tanë që më shumë se çdokush e deshën lirinë, rendin, demokracinë dhe pavarësinë e vendit.

Deputetë të nderuar,

Sot jemi thirrur në shërbim të sublimes, në nxjerrjen e vendimit për rikonfirmimin dhe institucionalizimin e vullnetit të popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran të Kosovës.

Ky është vullnet i deklaruar shumë herë nga qytetarët tanë, i arritur në shkallë vetëdijesimi nacional dhe i shtruar qartë dhe në mënyrë demokratike para bashkësisë ndërkombëtare. Dhe, sot, ky akt është i qytetarëve tanë, është i të gjithë neve dhe i secilit veç e veç – edhe si qytetarë, edhe si parti, edhe si deputetë.

Sot shumë njerëz kishin pas dëshirë jetësore që të jenë këtu. Të gjithë qytetarët përcjellin me gëzim këtë akt dhe ne duhet t'u themi atyre këtu – është vullneti i juaj, këtu jeni ju. Dhe ne jemi vetëm zëri juaj, i qytetarëve të Kosovës.

Për lirinë tonë duhet të vendosim lirshëm. Gjashtë vitet e fundit për kosovarët ishin kohë të punës, përpjekjeve dhe sukseseve solide – bashkërisht me ndërkombëtarët, UNMIK-un, KFOR-in, OSBE-në, zyrat diplomatike dhe me mekanizmat tjerë diplomatik të instaluar në Kosovë.

Ne nuk duhet t'i nxjerrim vetes pengesa procedurale, komplikuese, krejt të panevojshme për këtë çështje. Statusi politik i Kosovës nuk është, e ritheksoj, punë procedurash, por vullneti i drejtë i popullit të Kosovës. Bindjet tona duhet t'i shprehim sinqerisht, në mënyrë të ndershme e jo fjalët t'i ndryshojmë sipas rrethanave. Çiltërsia dhe përgjegjësia është thelbësore në nxjerrjen e vendimit tonë.

Të nderuar deputetë,

Vullneti i qytetarëve të Kosovës, është më i vjetër dhe më i fuqishëm se të gjithë ne këtu dhe do të jetojë më gjatë se ne. Pavarësia e Kosovës është jo vetëm në interes të qytetarëve të Kosovës por edhe të vendeve fqinje, është në interes të paqes, stabilitetit në rajon. Është edhe në interes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian.

Prandaj, ftoj të gjithë që të ngriheni mbi interesat partiake, individuale, apo grupore. Vendimi për rikonfirmim të vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, nuk paraqet faj, por është qëllim i vetëm, fisnik, politik, vepër humane dhe vendim shumë i drejtë.

Dhe, më lejoni që edhe një herë, pasi që Rezoluta i është proceduar në tekst Sekretariatit të Kuvendit të Kosovës, e në të njëjtën kohë edhe i është dërguar të gjitha grupeve parlamentare, të shpreh para jush Rezolutën të cilën e ka hartuar Partia Demokratike e Kosovës, e cila do të duhej jetë e Kuvendit të Kosovës. Prandaj, Kuvendi i Kosovës miraton këtë

## REZOLUTË

1. Kuvendi i Kosovës rikonfirmon vullnetin e popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran të Kosovës.

2. Qëndrimi i Kuvendit të Kosovës është se pavarësia e Kosovës është e panegociueshme. Vullneti politik i qytetarëve të Kosovës është i panegociueshëm.
3. Kuvendi i Kosovës kërkon që çdo vendim politik apo marrëveshje të ratifikohet domosdo në Kuvendin e Kosovës apo t'i nënshtrohet referendumit nga qytetarët e Kosovës.

Të nderuar deputetë, i nderuari zoti Kryetar, i nderuar zoti Kryeministër, Ju ftoj edhe një herë të gjithëve për reflektim të unitetit të qëndrueshëm dhe nxjerrje të vendimit të drejtë. Çështja e rikonfirmimit të vullnetit të Kosovës nuk duhet të jetë çështje e pikave të rendit të ditës dhe cila është më e rëndësishme e cila jo e rëndësishme dhe se dikush mendon se e ka marrë kjo apo ajo parti primatin për këtë çështje. Ne, si Parti Demokratike e Kosovës jemi në favor që çdo parti që ta prezantojë këtë çështje ta mbështesim dhe ta rikonfirmojmë vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Kjo është çështje e Kuvendit të Kosovës dhe e asnjë lideri, e asnjë partie të caktuar. Prandaj, ju ftoj të gjithëve për solidaritet dhe mirëkuptim në kuptimin më të drejtë, më të sigurtë për implementimin dhe zyrarizmin e kërkesave të vullnetit dhe vendimit të qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran. Kemi pasur iniciativa edhe më herët rreth kësaj çështjeje, edhe atëherë Partia Demokratike e Kosovës i ka përkrahur, prandaj është koha vendimtare në të cilën ne duhet ta nxjerrim këtë vendim. Është çështje ditësh se kur do të prezantohet raporti i ambasadorit Kai Aide. Nuk është çështje muajsh. Prandaj nuk kemi kohë për të humbur, është koha për vendim. Nuk duhet ta presim në ankth raportin e ambasadorit Aide. Ne duhet të kemi besim të gjithë në suksesin që kemi arritur të gjithë, por nuk duhet ta presim as me entuziazëm. Prandaj, bota dhe qytetarët nga ne presin vendim, vendim të cilin besoj se do ta marrim ne sot. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit zoti Thaçi. E ka fjalën profesor Alush Gashi. Urdhëroni profesor.

#### DEPUTETI ALUSH GASHI:

I nderuari zoti Kryetar, Kryeministër dhe ju shumë të çmuar deputetë dhe mysafirë, Saherë që të përmendet apo të kërkohet konfirmimi apo rikonfirmimi për pavarësi të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës do të votojë dhe përkrahë me çfarëdo çmimi qoftë ajo.

Ne na vjen mirë që të gjitha partitë politike joserbe në Kosovë mbështesin thelbin e Programit të Lidhjes Demokratike të Kosovës që është jetësimi i pavarësisë së plotë të Kosovës. Në seancën e kaluar kemi dëgjuar për iniciativën e Grupit Parlamentar të PDK-ës, iniciativë e cila është thelb i Programit tonë dhe ne e kemi mirëpritur atë. Në ndërkohë, kemi pa tekstin, i cili i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës për procedim sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Zoti Kryetar,

Lidhja Demokratike e Kosovës, përmes Grupit Parlamentar të saj, kërkon nga Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit të Kosovës që në kuadër të Rregullores me seriozitetin më të madh ta shqyrtojë këtë nismë të Partisë Demokratike të Kosovës.

Ne ju ofrojmë propozimin tonë që të formohet një grup i cili do ta harmonizojë atë tekst dhe ju propozojmë që në një seancë të posaçme, duke kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që ta detyrojë grupin për të cilin ne propozojmë që të jetë nga Komisioni për çështje kushtetuese dhe legjislacion, Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar – kuptohet kryetarët e tyre, grupet parlamentare dhe sa më

parë që të jetë e mundshme seanca e posaçme lidhur me këtë çështje të zhvillojë punimet e veta në Kuvendin e Kosovës.

Ekziston një histori shumë e gjatë, e fuqishme dhe faqebardhë lidhur me këtë çështje, pjesë e së cilës është Lidhja Demokratike e Kosovës dhe fatmirësisht edhe partitë tjera të dalura pas lufte.

Ne e mbështesim iniciativën dhe kërkojmë seancë të posaçme lidhur me këtë çështje. Ju faleminderit zoti Kryetar.

#### KRYTARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, ju faleminderit. E ka fjalën Ministri Bujar Dugolli, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

#### MINISTRI BUJAR DUGOLLI:

Faleminderit zoti Kryetar. Unë jam edhe deputet edhe Ministër. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës duhet t'i paraqes disa qëndrime dhe duhet të rikujtoj të gjithë deputetët sa i përket nismave të tilla se si kemi vepruar edhe në mandatin e kaluar.

Ju e dini që ne sot kemi një Rezolutë prej 30 nënshkrimesh, ndërsa në mandatin e kaluar kemi pas një Rezolutë të nënshkruar nga 42 deputetë, e cila ka përmbajtur, sa për vëmendjen do ta lexoj dhe më në fund do t'i jap qëndrimet.

Me datë 03. 02. 2003, para Kuvendit të Kosovës, është paraqitur kjo Rezolutë për miratim:

### D E K L A R A T Ë

#### PËR KOSOVËN SHTET SOVRAN DHE TË PAVARUR

Duke pasur parasysh përpjekjet shekullore të popullit të Kosovës për liri, të shprehur në Konferencën e Bujanit 43-44; në Referendumin për pavarësi të vitit 1991 dhe luftën legjitime të popullit të Kosovës për çlirimin e Kosovës, të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës;

Duke shprehur vendosmërinë për krijimin e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në Kosovë dhe në rajon;

Duke pas parasysh krijimin, me votën e qytetarëve, të organeve legjitime legale të pushtetit në Kosovë;

Duke shpreh gatishmërinë dhe vendosmërinë e Kosovës për integritet euroatlantike;

Duke konfirmuar besimin në NATO dhe domosdoshmërinë për një mandat afatgjatë të NATO-s në Kosovë,

Kuvendi i Kosovës,  
S h p a l l:



## KOSOVËN SHTET SOVRAN, TË PAVARUR, DEMOKRATIK TË TË GJITHË QYTETARËVE TË SAJ.

Nën një. Rezoluta e mëhershme i ka përmbajtur këto pika:

Kosova në kufijtë e vetë administrativ të përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974, shpallet shtet sovran, i pavarur, demokratik, duke pranuar ushtrimin e të gjitha të drejtave, detyrimeve të dala nga të gjitha aktet ndërkombëtare e veçanërisht të drejtat dhe liritë e njeriut për qytetarët e Kosovës pa kurrfarë dallimi në bazë race, feje, etnie apo bindje politike.

Pika dy. Kuvendi i Kosovës obligon të gjitha institucionet legale legjitime të Kosovës qendrore dhe lokale, të gjitha forcat politike në Kosovë, të gjithë qytetarët e Kosovës pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, fetare, racore apo bindje politike të angazhohen fuqimisht për jetësimin e shtetit të pavarur të Kosovës.

Pika tre. Kuvendi i Kosovës kërkon nga të gjitha shtetet demokratike në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e Unionit Evropian që ta mbështesin dhe ndihmojnë popullin liridashës të Kosovës për krijimin dhe njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës.

Katër. Kuvendi i Kosovës kërkon nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara që realitetin e ri të krijuar në Kosovë ta njohë si të arritur të përbashkët të qytetarëve të Kosovës dhe të bashkësisë ndërkombëtare dhe këtë ta miratojë me një rezolutë të re për njohjen e shtetit të pavarur të Kosovës.

Dhe pesë. Kuvendi i Kosovës e fton NATO-n për prezencë afatgjatë në Kosovë duke konsideruar se kjo prezencë është në interes të qytetarëve të Kosovës dhe të paqes e stabilitetit në rajon.

Si rezultat i kësaj nisme, deputetët e Kuvendit të Kosovës, përmes grupeve tyre parlamentare dhe negociatat që i kemi pas në vazhdimësi, më 13 shkurt 2003 kryetarët e grupeve parlamentare të Lidhjes Demokratike, të Partisë Demokratike, të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të minoriteteve tjera, në lidhje me nismën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Deklaratës për Kosovën si shtet të pavarur sovran të datës 03 shkurt 2003, kryetarët e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës u pajtuan me sa vijon:

Nën një. Përkrahet nisma e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Deklaratës për Kosovën si shtet sovran e të pavarur, datë 03 shkurt 2003.

Nën dy. Nisma e deputetëve ka hyrë në procedurë të rregullt në Kuvend dhe vazhdon shqyrtimi i saj.

Nën tre. Kryetarët e grupeve parlamentare marrin përsipër harmonizimin e qëndrimeve për Deklaratën e pavarësisë me grupet parlamentare dhe institucionet tjera të pushtetit në Kosovë.

Nën katër. Deklarata e harmonizuar do të dalë për miratim në ndonjërin nga seancat e ardhshme të Kuvendit të Kosovës në procedurë të rregullt në bashkëpunim të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të Kryesisë së Kuvendit.

Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Sabri Hamiti, kryetar;

Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, Fatmir Lima, kryetar;

Për Grupin Parlamentar të Aleancës, Bujar Dugolli, kryetar,

Për Grupin Parlamentar të minoriteteve tjera, haxhi Merxha, kryetar.

Duke u nisur nga kjo përpjekje që ka qenë në Kuvendin e Kosovës dhe kërkesës tani të Partisë Demokratike, që për mendimin e Grupit të Aleancës, janë pika të qëndrueshme por nuk janë të mjaftueshme për të pas një vendim të tillë Kuvendi i Kosovës, ne duhet ta hulumtojmë metodën dhe mënyrën se si do ta bëjmë këtë akt në Kuvend.

Janë dy forma, ajo që të bëhet një seancë e veçantë dhe ne mbështesim që të ulemi e diskutojmë në seancë të veçantë për këtë çështje sepse është çështje që nuk mund të kalohet me një vendim të tillë shpejt e shpejt.

Ne do të preferonim që vetë Grupi, i cili është përcaktuar nga ky Kuvend, në mbledhjen e kaluar, t'i paraqet Kuvendit të Kosovës qoftë deklaratë, qoftë platformë dhe ne at miratojmë. Por, në rast se Grupi nuk do ta bëjë këtë, që të ulemi si përfaqësues të grupeve parlamentare, ta harmonizojmë një tekst të deklaratës apo të rezolutës dhe atë ta bëjmë tekst për Kuvendin dhe ta miratojmë.

Ne mendojmë se deklarata e paraqitur nga PDK-ja ka pika të qëndrueshme, por nuk janë të mjaftueshme, prandaj unë paraqita dhe lexova tekstin e Rezolutës së kaluar që parimisht është mbështetur nga të gjitha grupet dhe mendoj se mbi bazën e saj dhe të përpjekjeve të tanishme që janë bërë, mund ta bëjmë dhe mund të bimë vendim të qëndrueshëm para Kuvendit të Kosovës dhe edhe grupi që është përcaktuar për bisedime, në rast të bisedave të mundshme, do ta ketë shumë më lehtë dhe do ta ketë një vendim të fuqishëm të Kuvendit të Kosovës.

Ne jemi dakord që në seancën që do të bimë në dakord ta caktojmë, ose në procedurat që mos të bëjmë shkelje edhe procedurale dhe të dalë ndokush t'na anulojë një deklaram të tillë, ta kalojmë. Përndryshe, ne do të japim kontributin tonë karshi përpjekjeve të vazhdueshme që i kemi bë për të pas një vendim të qëndrueshëm në Kuvend. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Dugolli, ju faleminderit. Me radhë do të duhet të ishin përfaqësuesit e ORA-s dhe 6+, nuk kanë obligim, por megjithatë le të urdhërojnë. Urdhëro Teuta.

#### DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA:

I nderuari Kryetar, të nderuar deputetë, Qeveri dhe mysafirë,

Ne si Grup Parlamentar përkrahim nismën e deputetëve të Grupit Parlamentar të PDK-ës si një nismë të sinqertë. Pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës është një ëndërr e çdo kosovari dhe është luftë e vazhdueshme dhe sakrificë e shumë gjeneratave që secila në mënyrë të vetë kanë kontribuar në këtë çështje madhore.

Pasi si çështje e rëndësishme do të duhej një harmonizim detaj dhe plotësim, ne si Grup Parlamentar jemi të gatshëm të japim kontributin tonë për këtë çështje. Pasi të krijohet platforma, ajo do të duhej të konfirmohej nga Kuvendi në një seancë të jashtëzakonshme.

Zoti Kryetar, do të kisha pas edhe një pikë si çështje urgjente në lidhje me rendin e ditës. Duke pas parasysh se sot fillon greva e punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë, si dy fusha fundamentale për funksionimin e çdo shoqërie dhe duke pas parasysh se gjendja sot në Kosovë është gjendje jo e zakonshme, dhe se mund të eskalojë e paralizojë punën dhe jetën në Kosovë, Grupi Parlamentar ORA

kërkon që çështja e grevës së punëtorëve të arsimit dhe shëndetësisë të futet si çështje urgjente në rendin e ditës të seancës së sotme. Në këtë aspekt, kërkojmë që Kuvendi i Kosovës të themelojë një komision i cili do të merrej me këtë çështje urgjente për Kosovën, që Qeveria e Kosovës të na raportojë lidhur me hapat e ardhshëm që ka planifikuar t'i ndërmarr në funksion të zgjidhjes së kësaj çështjeje, që ne si Kuvend të organizojmë një takim me këshillin grevist për të kuptuar drejtpërdrejt hallet e tyre në mënyrë që të na bëhet e mundur të ndërmarrim hapa në funksion të menaxhimit të situatës në përputhshmëri me kompetencat tona.

Duke u bazuar në Rregulloren e punës, Rregulla 29 pika 2, si Grup Parlamentar kemi të drejtë të parashtrijmë kërkesën për futjen në rend dite të një çështje urgjente, ndërsa vendimin e merr Kuvendi i Kosovës dhe çështje më urgjente se grevat e punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë ne sot për sot nuk nuk po shohim. Ju faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Teuta. E ka fjalën Xhezair Murati, në emër të Grupit 6+.

#### DEPUTETI DŽEZAIR MURATI:

Poštovani Predsedniče, gospodo ministri, kolege poslanici, gosti, Parlamentarna grupa 6+ shvata ozbiljnost političkog trenutka u kojem se nalazi i Parlament i sve institucije Kosova ali i implementacija i želja gradjana.

Svakako da je primarno jedinstvo naroda i subjekata Kosova, ali prije svega onih subjekata koji su dobili najveću podršku gradjana svih zajednica. Ovaj Parlament je implementacija te izborne volje gradjana.

Mi još jednom, kao Parlamentarna grupa 6+, iznosimo stanovište da ćemo podržati svaki dogovor najvećih subjekata i nećemo biti kočnica niti demokratskih procesa niti sporavanja priprema za ulazak u početak rešavanja konačnog statusa Kosova.

Isto tako, podržavamo zahtev prethodne govornice koleginice Sahatqija oko ozbiljnosti trenutka u kojem se nalazi Kosovo povodom najnovijih zahteva zaposlenih u obrazovanje i u zdravstvu. Hvala.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë ju kërkoj falje të të paraqiturve për debat, sepse tutje nuk do të kemi debat. Më lejoni të rezymojmë sa për informacion.

Është bërë konsultim intensiv pas seancës së fundit që ishte në ditën e enjte. Ne do të qëndrojmë në frekuencat e një krijimi të një uniteti funksional dhe veprues në Kuvend, sepse parim ka qenë që Kuvendi duhet të jetë bartës dhe verifikues i çdo aktiviteti sa i përket statusit të Kosovës.

Për hir të korrektësisë, sepse nuk u përmend edhe ajo nismë që Lëvizja Popullore e Kosovës e ka pas kaheerë me përmbajtje të ngjashme, edhe në takimin e punës që kemi pas në përgatitje të kësaj seance. Është shtruar shumë seriozisht.

Do të thotë, me një punë shumë aktive, atë që kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-ës e tha, do të jetë një obligim i Kryetarit dhe i Kryesisë që pas përfundimit të kësaj seance të rregullt - me rend dite të aprovuar pa asnjë vërejtje nga askush, të fillojmë përgatitjet dhe më së voni, unë po ju them – më së voni deri në fund të javës së ardhshme të dalim me material të propozuar dhe të shkruar që deputetët ta kenë me vetëm një pikë të rendit të ditës për atë që propozuan edhe nga Partia Demokratike edhe nga Lidhja Demokratike dhe të gjitha grupet parlamentare.

Prandaj, lus Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, që në tentimet e saj për të krijuar unitet funksional të qëndrojnë me ne në këtë rrugë të shumicës absolute. Unë jam i bindur se edhe numër shumë i madh i deputetëve të PDK dhe vetë zoti Thaçi është për një unitet të këtillë, prandaj edhe të mos krijojmë tensione të mëtejshme.

Sa i përket kërkesës së ORA-s, është çështje që mund të thuhet e ngutshme dhe është edhe konform rregullave 29.2 dhe çdo gjë në rregull, por pa i pa mundësitë, përpjekjet e Qeverisë dhe të grevistëve do të hynim në një debat pa rezultat, në një kohë kur do t'i humbte vlera edhe nismës të Partisë Demokratike dhe të shumë qëndrimeve. Është edhe një kërkesë që unë e kam të Zyrës së Presidentit për këto çështje, prandaj po ju lus edhe një herë për mirëkuptim, sepse të gjitha energjitë janë të drejtuara pozitivisht në realizimin e asaj që populli e ka shprehur në të gjitha votimet e pasluftës, shumë gjenerata para luftës me dekada me radhë. Deputetët janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e Kosovës.

Edhe zoti Thaçi i di përcaktimet e të gjithëve, edhe në grupin e Presidentit, përcaktimet e vendosura që nuk ka negociime për pavarësinë e Kosovës, por të krijojmë një unitet në Parlament dhe nuk ka nevojë të trokitet në derë të hapur, por t'i ndjekim të gjitha këto sugjerime dhe të vazhdojmë. Ju lus, të mos insistohet... Zoti Thaçi, i dëgjuat të gjitha mendimet. Unë mund t'ua jap fjalën dhe urdhëroni edhe njëherë...

#### DEPUTETI HASHIM THAÇI:

I nderuari zoti Kryetar, të nderuar deputetë, edhe një herë, fillimisht i falënderoj të gjitha grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët që treguan vullnetin më të mirë, më të sinqertë dhe të dëshmuar kombëtarisht për të shprehur rikonfirmimin e vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran. Gjithashtu, falënderoj dhe mirëpres edhe vullnetin e Kryetarit të Parlamentit të Kosovës që të fokusohet në ruajtjen e këtij uniteti gjithparlamentar në Parlamentin e Kosovës.

Dua të sqaroj diçka këtu. Mendoj se çështjet janë paksa të ngatërruara dhe të përziera dhe mendoj se duhet të qartësohen. Diçka tjetër është rezoluta, diçka tjetër është platforma. Rezoluta mund t'i paraprijë platformës apo mund të jetë si pjesë preambulë e platformës për negociata.

Tjetra. Zoti Kryetar, me qëllimin më të mirë ftoj që të kemi një pauzë njëorëshe për konsultë në mes të shefave të grupeve parlamentare që të harmonizojnë qëndrimin e Parlamentit, sepse nëse vazhdohet me procedura të Kryesisë atëherë e di se do të vonohet kjo çështje shumë dhe natyrisht vetë shefat e grupeve parlamentare që janë këtu e na përfaqësojnë dhe që mund të marrin vendime në emër të

grupeve parlamentare, të përcaktojnë periudhën kohore apo datën se kur do të mbahet seanca e veçantë me pikë të veçantë të rendit të ditës.

Prandaj, lus për mirëkuptim, edhe juve si Kryetar, edhe juve të gjithëve si deputetë dhe shefa të grupeve parlamentare për një pauzë njëorëshe për konsultim dhe harmonizim të qëndrimeve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë mendoj se propozimi i shefit të Grupit Parlamentar të ORA-s të fuqizohet. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji dhe për shëndetësi, jo komision i veçantë, le të punojë nga sot dhe t'i jepet detyrë dhe të përcjelljet situata. Dakord jeni me propozimin e shefit të opozitës për një orë pauzë a s'e di sa do të jetë, por nuk do të ketë ndryshim të qëndrimeve. Grupet parlamentare kanë shpreh mendimin e vet. Ne do t'i mbahemi fjalës. Unë s'kam thënë as platformë, as deklaratë, as rezolutë. Do të jenë grupet parlamentare, siç i propozoi Alushi do të propozohet, do të debatohet këtu dhe do të shkojë më tej. Kjo do t'i hapë rrugë në të njëjtën kohë takimit edhe me Presidentin gjatë javës dhe ne do t'i kristalizojmë qëndrimet edhe me atë rast.

Tani, do të bëjmë pauzë njëorëshe dhe pastaj do të vazhdojmë.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po vazhdojmë punën e seancës. Kush dëshiron ta marrë fjalën?  
Urdhëroni. E ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të PDK-ës.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Zoti Kryetar, të nderuar deputetë,  
Nga konsulta me shefat e grupeve parlamentare, rezultoi me sa vijon:

Nën një. Grupi i punës për harmonizimin e tekstit të Rezolutës të përbëhet nga

- shefat e grupeve parlamentare;
- Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese; dhe
- Komisioni për bashkëpunim me jashtë.

Dy. Kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit që të obligojë Grupin e punës për harmonizimin e tekstit sa më parë, dhe jo më larg se sot një javë ta afrojë tekstin e harmonizuar.

Tre. Të mbahet seancë e posaçme brenda javës së ardhshme.

Dhe në fund të kësaj, pasojnë nënshkrimet e pesë shefave të grupeve parlamentare.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit shumë. Unë në emër të Kryesisë, për t'i dhënë mjaft kohë Grupit, sepse ishte unifikim i plotë, e kanë për obligim të mos e presin Kryesinë por le të fillojnë punën menjëherë në mënyrë që, siç keni kërkuar, jo më larg se sot një javë dhe besoj deri në fund të javës ta kemi tekstin e propozuar në mënyrë të finalizuar dhe Kryesinë ta mbajmë në kohë të përshtatshme dhe siç thamë brenda javës së ardhshme të mbahet seanca plenare. Ju faleminderit.

ORA, a është e kënaqur apo jo me atë dy komisione, apo ka mendim tjetër, sepse duhet t'i harmonizojmë çështjet para se të vazhdojmë. Urdhëroni Teuta.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA:

Faleminderit zoti Kryetar. Ne mendojmë se Kuvendi për këtë duhet të deklarohet. Sepse, Rregulla 29.2 parasheh që Kuvendi duhet të deklarohet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Ju lutem, dëgjuam kërkesën e ORA-s. Ju thash se dy komisionet funksionale duhet ta kryejnë punën. Greva është në fillim, dhe le të punohet në këtë drejtim. Megjithëkëtë, rregulla e kërkon për një votë formale.

Pyes, kush është për propozimin e ORA-s? Le të numërohen votat.

Meqë LDK nuk e ka të qartë, po them se propozimi i ORA-s është që të formohet komision i veçantë lidhur me grevën. Unë e pash të arsyeshme që dy komisionet funksionale për arsim, shkencë dhe teknologji dhe për shëndetësi ta përcjellin gjendjen dhe bashkërisht me Qeverinë të punojnë. Urdhëroni Teuta...

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA:

Zoti Kryetar, propozimi ynë është që kjo pikë e rendit të ditës të jetë si pikë e rendit të ditës në të cilën Kuvendi pastaj do të deklarohet, por kjo të jetë si pikë e rendit të ditës duke pas parasysh çështjen emergjente lidhur me këtë çështje. Po, për rend dite dhe të hyjë si pikë e rendit të ditës. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë de, por ky është një kërkesë e një Grupi parlamentar konform rregullës.

Dëgjuam propozimin e ORA-s.

Kush është për propozimin e Grupit Parlamentar ORA? Të numërohen votat, ju lutem.

Të pranishëm janë 91 deputetë. 35 deputetë janë për, prandaj nuk kalon. Do të thotë hyn në procedurë normale dhe komisionet e kryejnë punën e vet.

(Ndërhyrje e deputetëve – pa kycje)

Kush është kundër ORA-s!?

(Ndërhyrje, pa kyçje të mikrofonit)

(Nga Kryesia e punës: Jo, kundër ORA-s!)

Kundër ORA-s!? Po mëshoj sa të duash, dhe lëshoni prapë mbledhjen, nëse doni!  
A je i kënaqur?

(Ndërprerje e shkurtër)

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për duhanin.**

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 24 qershor 2005.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime, me amendamente të caktuara.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, si Komision funksional e raportues, Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale i ka bërë radhitjet e rekomandimeve.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për duhanin ka bazën juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për duhanin dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për duhanin dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Në vijim jepen amendamentet dhe rekomandimet e Komisionit funksional.

A dëshiron ndokush nga Komisioni funksional ta marrë fjalën? Nuk dëshiron.

Ftoj regjinë të bëhet gati për votim.

Amendamenti 1. Votojmë tani.

Nga 72 deputetë që kanë marrë pjesë në votim, 65 vota janë për.

Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2. Votojmë tani.

63 vota për. Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

64 vota për, kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.

66 vota për, kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
66 deputetë janë për, kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
63 vota për, kalon amendamenti.

Amendamenti 7. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
53 vota për, kalon amendamenti.

Amendamenti 8. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
67 deputetë janë për, kalon amendamenti 8.

Dhe, amendamenti i fundit 9. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
67 vota për, kalon amendamenti.

Ju lutem, pasi kemi aprovuar amendamentet, ju ftoj të marrim vendim për aprovimin e ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara sot.

Regjia, përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

67 vota për dhe konstatoj se me shumicë votash Kuvendi aprovoi Ligjin e amendamentuar në tërësi. Ju faleminderit.

Pika me radhë e rendit të ditës është:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ngrohjen qendrore.**

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 25. 07. 2005.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime, me amendamente të propozuara.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energjetikë, transport dhe telekomunikacion, si Komision funksional dhe raportues, Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale ka paraqitur amendamentet si në vijim.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për ngrohje qendrore ka bazën juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ngrohjen qendrore dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ngrohjen qendrore dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet janë të Komisionit funksional.

Amendamenti 1. Përgatitemi për vendimmarrje dhe votojmë tani.  
64 deputetë janë për, kalon amendamenti.



Amendamenti 2. Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.  
61 deputetë janë për, kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
61 votë janë për, kalon amendamenti.

Amendamenti 4. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
62 deputetë janë për, kalon amendamenti.

Amendamenti 5. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
66 deputetë janë për, kalon amendamenti.

Amendamenti 6. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
61 vota për, kalon amendamenti.

Amendamenti 7. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
59 vota janë për, kalon amendamenti.

Amendamenti 8. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
61 vota për, kalon amendamenti.

Amendamenti 9. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
64 vota janë për, kalon amendamenti.

Amendamenti 10. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
64 vota janë për, kalon amendamenti.

Dhe amendamenti i fundit 11. Përgatitemi për votim. Votojmë tani.  
59 vota janë për, kalon amendamenti.

Urdhëroni. E ka fjalën Fatmir Rexhepi.

#### DEPUTETI FATMIR REXHEPI:

E lash për fund t'ju njoftoj se të premten e mora një shkresë lidhur me këtë Projektligj nga Zyra ligjore e Shtyllës së katërt, e cila i ka 18 vërejtje, por që nuk kanë të bëjnë me materien brenda sa i përket amendamentimit, por janë krejt gjuhësore, sepse ligji është shkruar në gjuhën shqipe, përkthyer në anglisht me shumë gabime, prandaj vërejtjet e tyre janë që këto amendamente gjuhësore të përmirësohen. Para se të vëhen në votim, kisha dashur që t'ju njoftoj se me Zyrën i kemi shqyrtuar këto krejt, qëndrojnë ashtu si janë, shqip janë shumë mirë, por anglisht vërtetë janë gabim. Kjo është si ndihmesë që kur të bëhet ligji përfundimisht, të merren këto parasysht. Faleminderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Unë mendoj se seanca në plotni e përkrah këtë. Do të thotë kur të finalizohet gjuhësisht të kihet kjo parasysht dhe të jetë korrekt ligji.

Ju ftoj tani ta votojmë në tërësi ligjin, me amendamentet e aprovuara.  
Regjia të përgatitemi për votim. Votojmë tani.

58 vota janë për, konstatohet se me shumicë votash është aprovuar ligji.

Para se të kalojmë në pikën me radhë, për hir të korrektësisë në Transkript dhe Procesverbal, gabimisht jam shprehur me: “kush është kundër ORA-s”, e duhet të jetë: “kush është kundër propozimit të ORA-s”, prandaj ju lutem kjo të kihet parasysh, dhe kam të drejtë, dhe kur bëhet procesverbali të jetë në rregull, sepse e korrigjoj gabimin tim. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës. Më parë, mendoj se duhet ta kemi parasysh kuorumin.

Lus deputetët të kthehen në sallë, sepse pasi ta kalojmë shqyrtimin e dytë do të japim pauzë, ose ta ndërprejmë, nëse është kërkesë e deputetëve.

65 deputetë janë në sallë dhe kemi mundësi të vazhdojmë punën.

Kalojmë në pikën e radhës:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën e dhënies së koncesioneve.**

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 24.06.2005.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime.

Ju lutem, në Projektligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve, mos u çuditni, por po shoh për herë të parë diçka të këtillë: nuk ka amendamente.

Komisioni funksional, hartues i Projektligjit e miratoi Projektligjin pa amendamente, me të vetmen vërejtje:

“Preambula dhe neni 53, në kllapa: (Hyrja në fuqi e ligjit) të harmonizohet me rregullat përkatëse të Kornizës kushtetuese.”.

Bazuar në tekstin e lartshënuar, Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energjetikë, transport e telekomunikacion i rekomandon Kuvendit të Kosovës që ta miratojë Projektligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve në variantin e propozuar.

Arsyetimin për ta përforcuar raportin e Komisionit të Kuvendit, e paraqet kryetari i Komisionit Fatmir Rexhepi, apo i autorizuari i tij. Unë po e lexoj siç ma kanë shkruar. Fatmir urdhëroni.

**DEPUTETI FATMIR REXHEPI:**

Komisioni ka procedua në kohë të duhur, e ka shqyrtuar edhe një herë Projektligjin, ka qenë vetë hartues dhe e ka vetëm atë rekomandim, të cilin e lexuat edhe ju, prandaj nuk kemi bërë ndryshime dhe kërkojmë që ky Projektligj të shkojë në variantin e aprovuar. Faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Faleminderit. Regjia, të përgatitemi për vendimmarrje dhe aprovim të ligjit, siç ka qenë në shqyrtimin e parë.

Votojmë tani. 61 vota janë për, konsiderojmë se është i aprovuar Projektligji në shqyrtim me shumicë votash. Ju faleminderit.

Mendoj se duhet të deklarohejmë: a jemi për të vazhduar me rendin e ditës të shqyrtimit të parë apo të bëjmë pauzë për drekë dhe pastaj të vazhdojmë.

Faleminderit, atëherë do të vazhdojmë në orën 14, me shqyrtim të parë të projektligjeve. Ju faleminderit.

(Vazhdoi pauza)

(Vazhdimi i seancës plenare)

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Para se të vazhdojmë me rendin e ditës, për diskutim është paraqitur Enver Hoxhaj.

### **ENVER HOXHAIJ**

I nderuari z. kryesues, të nderuar deputetë. Më lejoni që në emër të të dy komisioneve, Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë Rini dhe Sporte dhe të atij për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale t'i paraqes qëndrimet tona në takimin paraprak që patëm gjatë pauzës dhe në takimin që e kishim edhe me kryetarin e Kuvendit z. Nexhat Daci..

Anëtarët e komisioneve mendojnë së gjendja e punëtorëve të arsimit është shumë e vështirë kështu që ndajmë brengën me ta. Siç dihet, ata në të kaluarën kanë qenë, janë dhe do të jenë edhe në të ardhmen shtyllë vitale e shoqërisë.

Pra, të dy komisionet nuk kanë përgjegjësi ekzekutive para Qeverisë së Kosovës që t'i paraprijnë zgjidhjes së problemit të punëtorëve të arsimit, kështu që ftojnë Qeverinë e Kosovës që me anë të dialogut të drejtpërdrejtë me grevistët të marrë një vendim pozitiv dhe këtë t'ia përcjellë Kuvendit të Kosovës. Kjo është një çështje jashtëzakonisht e ngutshme, prandaj kërkojmë që Qeveria e Kosovës urgjentisht t'i shqyrtojë kërkesat e grevistëve dhe ta informojnë Kuvendin për vendimin e saj pozitiv. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

I ftoj deputetët që me një votim formal t'i miratojmë qëndrimin e dy komisioneve, që u obliguan në këtë seancë, ose nuk ka nevojë për votim formal, të obligohet Qeveria e Kosovës ta njoftojë Kuvendin me masat e ngutshme që duhet ndërmarrë lidhur me grevën.

Kalojmë në pikën e 7 të rendit të ditës

### **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kujdesin shëndetësor dhe emergjent**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 22.7.2005.Pra janë përmbushur kushtet për shqyrtim me miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'i adresohen për shqyrtim Komisionit Funkcional - përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet ministri Sadik Idriz që në emër të Qeverisë së Kosovës ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

## **SADIK IDRIZ**

### **Poštovano Predsedništvo,poštovani Presedniče,dragi poslanici!**

Pozdravljam otvaranje procedure u ovoj Skupštini o usvajanju Zakona Urgentne Zdravstvene Zaštite,dokumenta veoma važnog značaja o urgentnoj zdravstvenoj zaštiti građana ,i zdravstvenog sektora kao i za Kosovu u celjini.

Uperkos raznih sistema zdravstvene zaštine u zemljma EZ,postojeće evropsko zakonodavstvo,obavezuje neke posebne zemlje da potpuno obezbede i osiguravaju načela solidarnosti,kao i da dokažu jasnu zakonsku obavezu državnih struktura radi osiguranja kvalitetnih zdravstvenih usluga svima kojima je to potrebno.

Ovaj Nact Zakon u potpunosti je u skaldu sa ovim pomenutim načelima.

Mnogo od pomenutih predloženih rešenja u ovom Nactr Zakonu kao što su,načela solidarnosti,forme javnih i privatnih urgentnih zdravstvenih službi,paket usluga primarne zdravstvene zaštite,način financiranja urgentnih zdravstvenih službi,itd,jesu zakonodavna rešenja koje postoje uskoro svim zemljama EZ-ce

Predloženi Nactr Zakon pruža optimalna rešenja u skladu sa postojećim Evropskim zakonodavstvom i zakonodavstvom drugih zemalja u ovoj oblasti kao :

- Pravilnik o uslovima,organizaciji i načinu rada prve pomoći van bolnica(br.146/03),Hrvatska
- Direktive saveta/odbora / 89/618 Euroatom od 27 novembra1989 o informiranju javnosti u opšte o zdravstvenim zaštitnim merama koje će se primenjivati i koraci koje treba preduzimati u urgentnim radiološkim slučajevima.
- Državni kod urgentnih zdravstvenih službi,deo800,Department Zdravstva NewYorka.

Zakonodavna osnova donošenja ovog Zakona Urgentne Zdravstvene Zaštite ,u celini se oslanja na :

\_ Ustavnom Okviru Institucija Samouprave na Kosovu,  
 Uredba 2001/9,15 maj 2001 ,član 3 i član 5 (e),gde se pravo na zdravstvo i zdravstvenu zaštitu kao i regulisanje odnosa u oblasti zdravstva određivaju se kao osnovno pravo i sloboda građana.  
 -Sporazumom postignutom sa Predsednikom i Vladom Kosova/28 februar 2002/, s'kojim se osigurava paket poboljšavanja kvaliteta zdravstvene zaštite za sve građane .

\_Zakona o Zdravstvu Kosova ,kojim se odredi osnivanje sistema Zdravstvene Urgentene Službe na Kosovu

\_Zakona o pravima i odgovornostima građana na zdravstvenu zaštitu Kosova.

Dame i gospodo,

Objektive koje i Vlada podržava sa ovim Nacrt Zakonom ,kao trajnost ,efikasnost,i zakonodavni sistem ,jesu i kao neophodnost za ispunjavanje standarda o Kosovu.

Nacert Zakon Urgentne Zdravstvene Zaštite rukovodi se od načela proporcionalnosti i elaboriran je na monotehnici od 53 članova sa sledećim sadržinom :

- Definicije
- Osnovne odredbe
- Principi urgentne zdravstvene službe
- Prava i odgovornosti građana u urgentnoj zdravstvenoj zaštiti
- Urgentna zdravstvena usluga
- Organizacija i primenljivost
- Urgentna sekundarna zdravstvena zaštita
- Urgentna zdravstvena zaštita na univerzitetskom nivou
- Sistem trauma
- Saradnja sa drugim urgentnim zdravstvenim službama
- Zdravstvena informativna služba urgente službe
- Sistem komuniciranja
- Posebne odrebe
- Prelazne odrebe.

Sve gore pomenute tačke su elaborirane u memorndumu koji imate pred sobom.

Proces implementiranja ovog Nacrt Zakona ,Vlada će osiguravati dopunsku koordinaciju između Ministarstva Zdravlja i Ministarstva Ekonomije i Financija

Vremenski rok primenjivanja Nacrt Zakona Urgentene Zdravstvene Zaštite je dvogodišnji.

Za implementaciju gore pomenutog zakona ,budžetska implikacije imaju i, Ministarstvo Zdravlja ,Ministarstvo Javnih Službi,(Urgentni department),Ministarstvo Transporta i telekomunikacije, Ministarstvo Obrazovanja,PSK,TKM, i Jedinica Vatrogasaca.

Financijski troškovi su u skladu sa budžetskim dvogodišnjim planiranjem, koji su previđeni politikom o razvoju zdravstva.

I na kraju ubeden sam da vi sa vašim diskusijama i predlozima ,davaćete doprinos u savršavanju ovog Nacrt Zakona,koji je za dobrobit svih građana Kosova

Hvala

**Kryesuesi Naim Maloku**

E hap debatim për diskutim në parim në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. E ka fjalën deputeti Naim Jerliu.

**NAIM JERLIU**

Ju faleminderit z. kryesues. Të nderuar anëtarët të kabinetit qeveritar, të nderuar kolegë deputetë.

Më lejoni që në fillim të them se Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet sjelljen e procedurës dhe miratimin në parim të Projektligjit për kujdesin shëndetësor dhe emergjencë, duke konsideruar se ky do të rregullojë një fushë të veçantë shërbimit shëndetësor, duke konsideruar se me këtë plotësohet një obligim ligjor i strukturave shtetërore për të siguruar shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor për të gjithë ata që kanë nevojë për te.

Ne vlerësojmë se zgjidhjet ekzistuese ligjore të ofruara në këtë propozim ligj janë në përputhjen me parimit në bazë të së cilave është ndërtuar sistemi shëndetësor në Kosovë dhe në veçanti me parimet e shërbimit shëndetësor të emergjencës në vendet e tjera evropiane. Në të adresohet në mënyrë të drejtë edhe realizimin i të drejtave dhe përgjegjësive të qytetarëve në këtë shërbim.

Dua të theksoj se ky propozim ligj që vjen në shqyrtim shënon një progres të konsideruar në përgatitjen cilësore të strukturimit dhe të adresimit të çështjeve me të cilat merret, në veçanti të disa fushave që janë pika të dobëta lidhur me funksionimin e sistemit shëndetësor në Kosovë.

Me këtë projektligj adresohet për herë të parë edhe sistemi i traumës dhe i bashkëpunimi ndërmjet hallkave të ndryshme të funksionimit të sistemit emergjent shëndetësor dhe sistemit të komunikimit në përgjithësi.

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet miratimin në parim të këtij projektligji dhe do të japë kontributin e vet sa i përket përmirësimit. Pra, në këtë kontekst duhet pasur parasysh edhe disa mangësi ose lëshime që vërehen në këtë projektligj siç është rasti i adresimit të disa ndarjeve administrative që me legjislacionin tonë të mëhershëm nuk janë pjesë e sistemit rregullator shëndetësor të Kosovës. Pra, fjala është për autoritetet shëndetësore të qarkut. Ne do të punojmë që ky projektligj jo vetëm të miratohet, por edhe të zbatohet në mënyrë që t'i plotësojë nevojat e qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Në emër të PDK-së fjalën e ka deputetja Flora Brovina, le të përgatitet deputetja Zylfije Hunduzi.

## **FLORA BROVINA**

E përshëndetje Kryesisë dhe kolegët deputetë.

Në mandatin e kaluar kur u miratua Ligji për shëndetësinë gjatë diskutimeve dhe në përfundime u tha se ky ligj është jo i plotë dhe se nuk bën rregullimin ligjor të sistemin emergjent mjekësor në tërësi në Kosovë.

Sot para nesh, në shqyrtimin e parë është projektligji që synon rregullimin e kësaj veprimtarie të rëndësishme dhe strategjike për shëndetin e qytetarëve dhe që drejtpërsëdrejti ndikon në buxhetin e shëndetësisë në Kosovë, që i edhe ashtu po derdhet jashtë Kosovës.

Projektligji pretendon të rregullojë fushën e shëndetësisë. Në një të ardhme të afërt pretendohet të ketë edhe helikopter bartës për të sëmurët, të funksionojë telemjekësia. Kjo në këtë moment sigurisht është një ëndërr, sepse gjendja është shumë e rëndë në përgjithësi në fushën e shëndetësisë e në veçanti në shëndetësinë emergjente. Kjo gjendje e rëndë është në resurset humane të trajtimit të stafit të objekteve që

ofrojnë këtë shërbim nëpër komuna si dhe në vetë Qendrën Emergjente në Prishtinë, ku ndihet mungesa e pajisjes së sallave me aparaturë për monitorim dhe diagnozë.

Sot pacientët me sulme kardiake të mos gabojnë të sëmuren gjatë ditëve të vikendit, sepse nuk ka analiza. Aparatura për analiza dhe enzime, që janë analiza thelbësore për disa muaj nuk është duke funksionuar. Temë e veçantë është bartja e pacientëve emergjentë, mungesa e automjeteve bartëse dhe adekuate dhe pa përcjellje mjekësore. Ne nuk kemi autoambulanca ku ofrohet ndihma në vendin e ngjarjes gjatë rrugës deri te emergjenca. Ka shumë brenga për shëndetësinë në këtë moment në Kosovë, por besoj se Kuvendi i Kosovës duhet ta vërë në rend dite në një seancë për debat gjendjen e shëndetësisë në Kosovë.

Mendoj, se kjo situatë në shëndetësi madje ia kalon edhe asaj në kohë lufte kur të paktën funksiononin ambulancat fushore dhe ato vullnetare dhe kur kishte ma shumë disiplinë, higjienë dhe rregull. Dikush mund të thotë se në shëndetësi e kemi atë nivel dhe çfarë e kemi ofruar. E kemi paracaktuar këtë menaxhim të dobët me pagat të ulëta të punëtorëve shëndetësorë me mos kontroll të disiplinës dhe në përgjithësi me shumë problemet që asnjëherë nuk u vuan në spikamë. Kjo me të drejtë i revoltonte qytetarët që janë të pakënaqur me shërbimet e ofruara, kështu punëtorët shëndetësorë me të drejtë ndihen të ofenduar keq para pacientëve të tyre.

Projektligji për kujdesin shëndetësor emergjent është një projektligj i përkthyer dobët dhe shpesh del jashtë realitetit objektiv ku çdo gjë nis nga e para. E meta e parë është përkthimi në aspektin gjuhësor vështirëson edhe kuptimin.

Vërejtjet e veçanta Grupi Parlamentar i PDK-së do t'i dorëzojë Komisionit të Shëndetësisë. Unë këtu do t'i veçoja vetëm disa nga këto.

Neni 5 ku flitet për format e shërbimit emergjentë në sektorin publik dhe në atë privat dhe më tutje në ligj harrohet sektori privat. Pra, a do të ketë sektor privat ose nuk do të ketë në shërbimin emergjentë shëndetësor. Neni dhe kapitujt në këtë ligj shpeshherë përzihen dhe përsëriten, pa nevojë. P.sh. nenet 12.6 dhe 12.7 mund të përfshihen si një nen i vetëm. Kapitulli 4 dhe neni 13 duhet të plotësohet si dhe neni 14.1. Nenet 14.2 dhe 14.3 dhe 14.4 janë për diskutime dhe në to nuk përmendet shërbimi emergjent laboratorik si në cilindo nivel. Në nenin 14.9 flitet për shërbimin emergjentë në gjendje të jashtëzakonshme. Ky nen nuk është i plotë dhe duhet të plotësohet, të paktën të thuhet: Kjo çështje do të rregullohet me një ligj të veçantë, sepse është shumë e rëndësishme.

Nenet 14.11 dhe 15.6 shqyrtohej një çështje e njëjtë. Mendoj se këto dy nene mund të bashkoheshin në një nen.

Neni 16.9 për mua është i paqartë, sepse kërkon betimin e Hipokratit ku mjekët betohen se do të ofrojnë ndihmë për secilin çdo rast kur aty është nevoja e jo dmth. sikur thuhet në këtë nen se ata janë të privuar nëse nuk janë mjek të licencuar të emergjencës. Unë nuk mund ta kuptoj një mjek i cili nuk e ndalë një gjakderdhje edhe nëse nuk është një mjek i emergjencës e pacienti mund të vdesë.

Neni 17.2 dhe 17.3 mund të jenë një nen, neni 17.5 dhe neni 17.6 gjithashtu mund të jenë një nen dhe të formulohen ndryshe. Grupi parlamentar ka vërejtje edhe rreth buxhetit që është caktuar për këtë ligj sepse dyshojnë se në mjetet e caktuara mund të realizohet një synim kaq ambicioz dhe pa dyshim i mirë, megjithatë me gjithë vërejtjet e thana ne do të votojmë për projektligjin që duhet plotësuar. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit. E ka fjalën, në emër të AAK-së le të përgatitet Fatmire Mulhaxha Kollçaku, deputetja në emër të Grupit Parlamentar ORA.

**ZYLFIJE HUNDOZI**

Z. kryesues, z. ministra, kolegë deputetë.

Projektligji për kujdesin shëndetësor emergjent është një kontribut pozitiv për legjislacionin që po formohet në fushën e shëndetësisë. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah miratimin në parim. Vërejtjet tona janë për nenin 16.9 ,që është në kundërshtim me parimet etike me të cilat udhëhiqet mjeku gjatë punës së tij dhe në kundërshtim me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Në këtë nen thuhet se stafi mjekësor që nuk është i ricertifikuar në kurset e mjekësisë urgjente nuk mund të ndërhyjë as në kushtet e emergjencës në terren ,ngase në rast incidenti përgjigjet para komisionit diciplinar, komisionit etik dhe para gjyqit.

Nuk dihet se si duhet të sillen mjekët që kanë licenca nga fushat e tjera të mjekësisë dhe dinë të japin ndihmën emergjente.A do të jenë para dilemës të ndihmojnë ose jokështu që nëse nuk ia japin ndihmën personit që ka nevojë për te do të përgjigjen penalisht dhe para komisionit etik.

Gjithashtu kemi vërejtje për nenin 17.8. Edhe ky është në kundërshtim me nenin 16.9. Në këtë nen i lejohet vozitësit të ndihmës së shpejtë ,që ka kaluar nëpër disa kurse të ndihmës emergjente t'ia jap personit sidomos në terren ndihmën e kërkuar, por mjeku që ka kryer një trajnim një kohë më të gjatë është licencuar për punën e tij ka kaluar më tepër se kurse, nuk ka të drejtë ta japë këtë ndihmë.

Edhe një herë po them se po e përkrahim në parim dhe do të japim kontributin tonë në komisionin funksional që t'i përmirësojmë gabimet e cekura. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputetë E ka. fjalën Fatmire Mulhaxha Kollçaku në emër të Grupit Parlamentar ORA, le të përgatitet deputetja Nurshahe Hulaj.

**FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU**

Ju faleminderit z. Kryesues, deputetë të nderuar.

Grupi Parlamentar ORA e përkrahim votimin normal të një Projektligji të tillë siç është ky për mjekësin emergjente.

Se sa e madhe është rëndësia e një Projektligji të tillë, dhe e kisha cituar një mjek të emergjencës i cili thotë : Unë mund të jem personi i fundit të cilin e shef pacienti apo personi i parë pas kthimit të tij në jetë.

Një projektligj i tillë është me të vërtetë i kushtueshëm sepse nevoiten ekipet e trajnuara shumë mirë si dhe aparaturë shumë e shtrejtë siç u përmend këtu deri te një helikopter i cili do të shërbente këto raste.



Duhet pasur para sysh se ne deri tani kryesisht jemi bazuar në sistemin e mjekëve në gadishmëri dhe mundeni me pas parasysh se sa muajmë të bëjmë në raste emergjente deri sa pritet ardhja e ndonjë mjeku në gadishmeri.

Kryesisht duke mos i përjashtuar shërbimet ekzistuese të emergjencës. Gjithashtu dua ta përmendi edhe një rast tjetër se sa është me rëndësi të kemi ekipet e trajnuara si në qendër në Prishtinë, ashtu, edhe në terren është edhe një rast konkret kur një person i ri ka dhënë jetë mu për shkak që ka ndodhur një aksident në aksin rugor Pejë-Prishtinë në pjesën ku është më afër Prishtinës ndërsa i njejtë një herë u transferu në Klinë prej Klinës në Pejë dhe ma në fund në klinikën univerzitare ku edhe ka dhënë jetë person i cili normal në raste të tjera ishte shpëtuar sikur të kishte bërë një triazhim me kohë dhe i duhur i këtij pacienti. Ne gjithashtu kemi disa vërejtje unë nuk i kisha përsërit vërejtjet e parafolësve, gjithashtu edhe me qenëse është hartu ka kohë nevoiten edhe disa intervenime edhe siç u përmenden edhe disa institucione këtu që përmenden e tani janë ndoshta në funksionin e monitorimit. Ato gjitha vërejtjet që kemi do të tentojmë së bashku në komisionin funksional t'i korigjojmë, pra në parim e përkrahim nevojën për një projektligj të tillë. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Fjalën e ka deputetja Mirishahe Hulaj, le të pregaditet Zahrije Jusufi.

### **NURISHAHE HULAJ**

Të nderuar z. Të Kuvendit të nderuar zotri ministra deputetë.

Paraqitja e Projektligjit për kujdesin shëndetësor emergjentë është nevojë e domosdoshme edhe për mbushjen e standardit shëndetësor për të gjithë qytetarët. Me qëllim të qasjes më të afër të shërbimit emergjent në kushte normale dhe rethana të jashtëzakonshme.

Projektligji është i strukturuar mirë dhe i bazuar në modelatitete moderne të formave të organizimit e veprimit emergjent shëndetësor, me ndërlidhje të komunikimeve vrtikale e horizontale në tërë kompleksin organizativ emergjent para spitalor e spitalor duke i zbatuar masat dhe metodat e shkencës mjekësore. Projektligji mbështetet në parimet e proporcionalitetit dhe solidaritetit në format publike private të shërbimeve emergjente në pakon e shërbimeve të kujdesit themelor të shëndetësor dhe në mënyrën e finansimit.

Finansimi i veprimtarisë emergjente përcaktohet me Ligjin për shëndetësi të Kosovës në vi të veçantë buxhetore kurse kostoja e shpenzimeve për implementimin e këtij Projektligji paraqitet me 3.450. 000 €. Ligji paraqet implikime buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Shërbimeve Publike siç është departamentin e emergjencave, Ministrinë e Arsimit, SHPK-në, TMK-në, dhe shërbimin e zjarrfikësve që do të thotë se është implikim mendoj pozitiv për në të mirën e qytetarit.

Organizimi i shërbimit të kujdesit shëndetësor emergjent me këtë ligj i qartëson format e shërbimeve emergjente në nivelin porsor që përcaktohen në zonat komunale dytësor në zonat spitalore dhe tretsor si institucione referente univerzitare që paraqesin sintezën e një kompleksi administrativ-akademik klinik si dhe format e veçanta të dispeqerive emergjente dhe organizimin e shërbimit emergjent në trupat mbrojtëse të Kosovës.

Hallkë e rëndësishme në këtë ligj është sistemi informativ shëndetësor dhe mekanizmat ndërlidhëse me institucionet me veprimtari të ngjajshme si TMK-ja, SHPK-ja, KFOR-i dhe shërbimi i zjarfikësve. Me qëllim të veprimit në kohë të duhur për t'i dhënë shërbimin emergjent qytetarit. Në parim e përkrahim ligjin përkujdesjen emergjent shëndetësor dhe do t'i japim kontributin tonë në amendamentimin e vazhdueshëm. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. Deputete, fjalën e ka Zahrije Jusufi, le të përgatitet Teuta Hadri

### **ZAHRIJE JUSUFI**

I nderuari z. kryesus, të nderuar zotërinj deputetë.

Projektligji për kujdesin shëndetësor emergjentë është i domosdoshëm si bazë ligjore për funksionimin e shërbimit shëndetësor. Ky ligj obligon zbatuesit e emergjencës mjekësore që të jenë sa më afër qytetarit kur ata kanë nevojë emergjente.

Projektligji siguron respektim të plotë të parimit të solidaritetit për shërbimin emergjent mjekësor në institucione publike dhe private në kushte normale dhe gjendje të jashtëzakonshme.

Baza e projektligjit mbështetet në Kornizë Kushtetuse në Rregulloren 2001/19 dhe në Ligjin për shëndetësinë e Kosovës.

Projektligji ka mangësi të shumta duhet të pësojë ndryshime substanciale, i duhet një ripunim gjuhësor dhe përmbajtësor riformulim të disa neneve.

Për të zhvilluar veprimtarinë çdo emergjencë së pari duhet të krijojë kushtet themelore për funksionim sipas protokoleve e jo pastaj ato të nxiren me akte nënligjore. Faktori kohë minut si standardi i artë për shpëtimin e jetës së njeriut përgjegjësisë së lartë dhe vendosmërisë emergjente nuk i kushtohet rëndësi në projektligj.

Në projektligj nuk qartësohet shërbimi i kujdesit privat dhe financimi i tij kur dihet se shërbimi emergjent kryhet pa bashkëfinancim. Në projektligj shumë nene janë të pakuptimta. Disa duhet të përmirësohen. Do të veçoj mos të përsëris nënin 1, nënin 12.6, nënin 14.4, 17.3, 16.7. 18.2, 19, 20, 27, 36.5, 38 etj.

Në deklaratën financiare afati kohor për zbatimin e ligjit është dyvjeçar. Propozoj që afati të shkurtohet në një vit. Meqë për implikime buxhetore do të ketë përpos ministrisë së shëndetësisë edhe komunat edhe ministrinë tjera në projekte për shëndetësi, si Ministria e Transportit dhe Telekomunikimit, TMK-ja, SHPK-ja, kompanitë kontraktuese të sigurimeve shëndetësore dhe shtetet e huaja për qytetarët e vet. Projektligjin e miratoi në parim që në procedurë të mëtutjeshme të përmirësohet. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Fjalën e ka Teuta Hadri, le të përgatitet Behxhet Brajshori.

### **TEUTA HADRI**

Të nderuar deputetë, i nderuari z. kryesues.

Edhe unë si parafolëset e mi deri tani e përkrahi në parim këtë ligj, mirëpo dua t'i shtroj edhe vërejtjet e mia që i kam për këtë ligj. Mirëpo, para se t'i shtroj vërejtjet e ndiej si obligim moral t'i bashkëngjitëm kolegëve të mi që e kanë protestuar deri tani para klinikës shëndetësore se pajtohem me kërkesat e tyre vetëm shpresoj që Qeveria e Kosovës të marrë sa më shpejtë masa për qetësimin e gjendjes punëtore shëndetësore.

Vërejtjet e mia për këtë ligj janë gjuhësore dhe teknike. Përveç vërejtjeve gjuhësore, në nenin 1 që shprehet këtu te ambulancat nën 1. c nuk është përkthyer direkt fjalën "ambulancë". Ajo fjala këtu duhet ta ketë një kuptim më të veçantë në gjuhën shqipe, sepse është bërë përzjerja ndërmjet ambulancës ajrore. Pra, këtu nuk është fjala për ambulancë tokësore, siç thuhet: Ambulanca nënkupton automjetin motorik të konstruktuar dhe të pajisur në mënyrë speciale dhe menjëherë përzien me atë nenin 1 nën a, prandaj tutje duhet të jetë adekuat në gjuhën shqipe.

Vërejtje përsëri kam nën neni 1.e. Shëmbëlltyra e personelit mjekësor. Shëmbëlltyra është një kuptim shembull i më i lartë i edukatës njerëzore edhe personale dhe mjekësore, prandaj, këtu nuk duhet të jetë shëmbëlltyrë, mendoj se të jetë qëndrim pasi flitet edhe vetë që e nënkupton sjelljen dhe dukjen e ndërgjegjes të punëtorit shëndetësor.

Nenin 14.6, e kemi një shtesë ku përshkruhen gjitha shërbimet të pacientëve të traumatizuar si i ka përshkruar edhe lëndimet ka munguar edhe një kategori e shërbimeve mjekësore që kërkohet, janë kafshimet e shtazëve si të qenve dhe thumbimet që popullata jonë në disa rajone Malishevës dhe Dukagjinit vazhdimisht kërcënohen nga thumbimet e rriqrave, prandaj nëse kjo kategori nuk futet e kafshimeve rreth shtazëve siç janë qetë, gjarpërinjtë dhe thumbimet e rriqrave mbetet si kategori që nuk i përket emergjencës dhe është një kategori shumë emergjente te popullata jonë.

Pastaj kemi nenin 14.8, këtu nuk është fut, nën g, duhet të jenë edhe rrezatimet radioaktive që TMK-ja duhet të mirët kohëve të fundit siç është paraqit edhe rrezatimi në rrethin e Malishevës afër Mirushës që i ka materialet toksike dhe ata persona që banojnë aty kujt t'i mbështeten, ti mbështeten shërbimit primar shëndetësor apo kjo është një aktivitet dhe një sektor i shëndetësisë që duhet të mirët urgjent.

Nenin 18.2, veprimtari e shërbimit emergjent parësor, janë shprehë te 18.2 kushtet themelore për veprimtarinë emergjente mjekësore. Janë caktuar gjitha kategoritë e shërbimit, por, nuk është caktuar nën ajo që duhet të jetë, Kryesorja është harruar personeli shëndetësor. Të gjitha bëhen, por nëse nuk je ti personel shëndetësor, atëherë si të bëhet shërbimi i territorit të pacientit ku nuk ka ekip të caktuar posaçërisht për këtë.

Dhe në fund kisha për të pyetur si është bërë lidhshmëria me entet e tjera shëndetësore? Sektori privat shëndetësor ka mbetur i anashkaluar. Nuk i është dhënë mundësia të bashkëpunojë ashtu siç bëhen bashkëpunimet me qendrat e tjera bashkëpunon me emergjencë që ta ketë shërbimi privat një lidhje direkt me emergjencën dhe t'i mundësohet mjekut privat ta udhëzon me një udhëzim rastin urgjent qoftë në klinika private gjinekologjike ose interne ta ketë komunikimin direkt. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputete, dhe i fundit z. Behxhet Brajshori.

**BEHXHET BRAJSHORI**

Z. kryesues, ministra, të nderuar kolegë deputetë .

Unë e mbështesë në parim miratimin e këtij ligji dhe nxjerrjen e tij, dhe shkurtimisht do të ndalem te financimi i këtij Projektligji i cili parashihet në nenin 7 ku në mënyrë recidive thuhet: Financimi i kësaj veprimtarie përcaktohet me ligjin për shëndetësi të Kosovës në linjë të veçantë buxhetore brenda buxhetit të institucioneve gjegjëse. Për të siguruar implementimin e sigurt të këtij Ligji unë do të doja që në periudhën deri në leximin e dytë të leximit të këtij projektligji Ministria përkatëse të na e konfirmon faktin se implikimet buxhetore të parapara nga agjencitë e ndryshme shpenzuese a janë të përfshira në kornizën afatmesme buxhetore apo jo me qëllim që mos të vijmë në situatë sikur që kemi ardhur me ligjin për sigurime shëndetësore.

Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputetë

Ju lutem që të deklarohe mi për miratimin në parim e Projektligjit, prezentë janë 65 deputetë kemi forum, lus regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Për janë 63 deputetë. Ligji është miratuar në parim., Në bazë të rregullës 23 pika 6 dhe rregullës 35 pika 2 Kuvendi i ngarkon këto komisione.

- Komisioni për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, si komision funksional dhe referues,
- Komisioni për Gjuhësi Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese
- Komisioni për Buxhet dhe
- Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin 2 muaj nga shqyrtimi i parë tu e shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e 8 të Projektligjit.

### **8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin.**

Ministri nuk është këtu për ta shqyrtuar projektligjin. Më lejoni që në emër tuaj t'ju ja paraqes vërejtjet Qeverisë. Pra, ministri është dashur të jetë këtu. Për shkak të mos pranisë së tij ne duhet të kalojmë në pikën 9 të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e 9 të rendit të ditës, prapë nuk është ministri i arsimit, por zëvendësministri.

### **9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për edukimin parashkollor.**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 28.07.2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimi ne tij në parim. Vërejtjet parimore do t'i adresohen për shqyrtim Komisionit Funksional-përgjegjës për raportim dhe komisionet kryesore. Në emër të Qeverisë së Kosovës këtu z. kryeministri do ta paraqes para deputetëve.

**FEVZI BERISHA**

### **I nderuar z. kryetar, Të respektuar deputetë,**

Nga ditët e para të zbatimit të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë (Ligji nr. 2002/2), përveç anëve pozitive, u vërejtën edhe mangësi, të cilat kishin reflektime negative në organizimin e jetës dhe të punës së përditshme të institucioneve arsimore të Kosovës, në veçanti në nivelin parashkollor.

Ligji mbi Arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, nivelin parashkollor e trajton si temë të dorës së dytë dhe nuk e përmend as në emërtimin e vet, por vetëm përmes 3-4 neneve, synon të ofrojë zgjidhje të nevojshme për shumë probleme të këtij niveli të sistemit shkollor.

Për shkak të problemeve që u paraqitën në funksionimin dhe punën normale të institucioneve parashkollore dhe të pamundësisë së zgjidhjes së tyre përmes ligjit në fjalë, u shtrua nevojë urgjente që MASHT-i të fillojë punën për përgatitjen e ligjit të veçantë për edukimin parashkollor të Kosovës.

Komisioni u formua nga MASHT pati strukturë profesionale premtuese, në të cilin u përfshirë përfaqësues të institucioneve, që drejtpërdrejt ose indirekt, merren me edukimin parashkollor si dhe përfaqësuesit e disa OJQ-ve, që kanë dhënë kontribut të veçantë në edukimin parashkollor në Kosovë.

Komisioni ka konsultuar disa modele të ligjeve për edukimin parashkollor nga shtete të Bashkësisë Evropiane: si të Gjermanisë, Portugalisë e Sllovenisë dhe të shteteve kandidate: Kroacisë, Malit Zi, si dhe të Kosovës.

Punën për hartimin e projektligjit komisioni e ka filluar në mënyrë intensive dhe versionin e parë të tij e ka bërë gati më 29.12.2004.

Projektligji ka 10 kapituj me 51 nene.

Këtë version komisioni ua ka dërguar për diskutim publik të gjitha subjekteve të interesuara, në intervalin kohor prej 6 - 31.01.2005

Me kënaqësi mund të them se nga diskutimi publik, komisionit i kanë ardhur mjaft vërejtje e sugjerime të vlefshme, shumicën e të cilave i ka inkorporuar në dokumentin përfundimtar.

Me qëllim që ky ligj të jetë në përputhje me standardet e Bashkësisë Evropiane, MASHT ka angazhuar ekspertin ndërkombëtar të kësaj fushe, Znj. Shoon Wiliams, që ka dhënë kontributin e saj, që ligji në fjalë t'i përmbushë të gjitha elementet e duhura profesionale e juridike të aplikuara në nivel ndërkombëtar.

### **Të çmuar deputetë,**

Ky projektligj, pas përfundimit të diskutimit publik të organizuar nga MASHT, i është dërguar Qeverisë së Kosovës, që ka formuar komisionin e vet me përfaqësues të MSHP, MEF, USAID dhe UNMIK-ut.

Komisioni i Qeverisë ka mbajtur takime të përbashkëta pune me Komisionin e MASHT-it, ku u dhanë sugjerime të dobishme.

Sipas procedurës, projektligji në fjalë është sot para jush për miratim.

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme MASHT po vazhdon punën për kompletimin e infrastrukturës së domosdoshme ligjore në arsim.

Me dëshirë që edhe ky debat i sotëm të sjellë rezultate të reja lidhur me dokumentin në fjalë, i mirëpresim sugjerimet e tuaja.

Urojmë punë të mbarë dhe ju faleminderit

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

E hapim debatin në parim, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së i kemi të lajmëruar dy, Naxhije Doçi, fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi.

## **NAXHIJE DOÇI**

I nderuari z. kryesues i Parlamentit të Kosovës, të nderuar ministra, të nderuar deputetë, të nderuar mysafirë dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë.

Fëmijëria e hershme që e përfshin edukimin dhe arsimin parashkollor është periudhë e zhvillimit të shpejtë fizik, intelektual, emocional dhe social të fëmijëve. Zhvillimi personal që zë vend në këtë fazë është bazë për edukim dhe arsimim gjatë tërë jetës, prandaj me të drejtë studimet e ndryshme shkencore vlerësojnë se shoqëritë bashkëkohore duhet për t'i krijuar mundësi dhe kushte edukimit parashkollor.

Projektligji për edukimin parashkollor që sot po e shqyrtojmë në lexim të parë, krahasuar me legjislationin e mëparshëm, është më gjithëpërfshirës për zhvillim dhe edukim, përmban në vete shumë risi dhe është në përputhje me reformën arsimore në Kosovë.

Projektligji është i rëndësishëm për shoqërinë e Kosovës se vë në kornizë ligjore edhe institucionale arsimin parashkollor përfitues të të cilit janë të gjithë fëmijët e Kosovës, pa dallim etnie, gjuhe dhe përkatësie sociale etj. Projektligji ka 10 kapituj dhe 50 nene krahasuar më të mëparshmet që i kishte 38 nene.

Me këtë Projektligj fëmijët duhet t'u nënshtrohen normave elementare të bashkëjetesës sociale dhe të vihen në situata në të cilat liria individuale duhet balancuar me disiplinën dhe me rregullat individuale kolektive.

Projektligji e nxit kureshtjen e fëmijëve për vetveten, natyrën, shoqërinë, kulturën teknologjinë duke nxitur kreativitetin dhe duke u ndeshur me përvojat e tjera, inkurajon fëmijët që të përmirësojnë përdorimin e gjuhës së folur dhe të shkathtësive të komunikimit, por edhe mundësinë për të mësuar gjuhët e huaja. Gjuha e komunikimit është baza e të gjitha veprimtarive në kopsht, se nëpërmjet saj fëmijët shprehin ndjenjat dhe përshtypjet në rrethin ku jetojnë, si dhe bëjnë vlerësimin e gjërave dhe vendosjen e raporteve ndërmjet njëri tjetrit.

Duke u bazuar në këtë pranimi i kuadrit edukativ në institucionet parashkollore duhet të bëhet me kriteret e të folurit bukur dhe normativ të gjuhës shqipe. Fëmijët duhet të reagojnë drejt ndaj

mesazheve të thjeshta që arrihen me pjesëmarrjen e tyre në lojëra dhe me veprimtaritë e ndryshme duke kryer detyra individuale dhe në bashkëpunim me të tjerët.

Projektligji nëpërmjet procesit mësimor ushtron edukim dhe arsim parashkollor formal institucional nga edukatori, në familje sidomos për fëmijët që nuk vijnë në institucione parashkollore..

Me dispozitat e përgjithshme të këtij projektligji rregullohet gjithë përfshirja pa dallime e fëmijëve në institucionet parashkollore, mbrojtja e tyre, parimi i standardit dhe edukimi, krijimi i kushteve dhe e drejta e zgjedhjes së programeve nga ana e prindërve.

Projektligji u vë detyrë institucioneve parashkollore t'i shkoqitin plan programet duke ofruar objektivat, përmbajtje dhe metodat e punës që duhet të jenë në harmoni me standardet e përgjithshme të arsimit parashkollor, që publikohen dhe u ofrohen për zgjedhje prindërve.

Prindërit kanë të drejtën e zgjedhjes së programeve parashkollore për fëmijët e tyre, të institucionit parashkollor qofshin ato me orar të plotë, me gjysmë orari , afatgjata apo afatshkurtra. E veçanta e këtij projektligji është se rregullon edukimin dhe arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, të cilëve u duhen instruksione të ndara me ndihmë profesionale shtesë ose me programe speciale si dhe mundëson edukimin formal në familje për fëmijët e sëmurë. U ofron mundësi grupeve të veçanta të fëmijëve të jenë përfitues të buxhetit të Kosovës si grupeve parashkollore të hospitalizuara në spitalet e Kosovës, grupet parashkollore të fëmijët me nevojat e veçanta, fëmijët e dëshmorëve të luftës, fëmijët e invalidëve të luftës.

Unë do të propozoja që përfitues të buxhetit të Kosovës të jenë edhe fëmijët e invalidëve të punës dhe të kategorive të tjera të invaliditetit, si edhe fëmijët e të zhdukurve.

Në mjediset ku mungojnë institucionet parashkollore në këtë projektligj mundësohet hapësira për nisma të komunitetit për vetorganizim për të ofruar shërbimet e edukimit parashkollor, si dhe ndërtimi i objekteve dhe pajisja e tyre me inventar dhe me mjete edukativo arsimore në bashkëpunim me institucionet komunale të arsimit.

Themelues të institucioneve parashkollore publike janë komunat ,përkatësisht ato me deklaratë duhet ta bëjnë zgjedhjen e udhëheqësve në institucione parashkollore, mbikëqyrjen, inspektimin si dhe pranimin e kuadrit dhe mbikëqyrjen profesionale pedagogjike të edukatorëve, kjo krejt në aspektin pozitiv në raport me MASHTIN.

Ndërsa themeluesit e institucioneve të tjera parashkollore private janë persona juridikë privatë që duhet të jenë të licencuar nga komunat përkatësisht në bazë të deklaratave,por mjetet financiare për funksionimin e institucioneve parashkollore i sigurojnë themeluesit e tyre. Financimi i institucioneve parashkollore dhe plotësimi i kushteve të domosdoshme për një proces të mirë edukativo arsimor, që trajtohet në nenin 18 deri në 27 është paraparë me të drejtë që të rregullohet me këtë ligj dhe të jetë nga buxheti i Kosovës, i komunave të Kosovës nga prindërit dhe nga burimet e tjera.

Mirëpo, siç dihet se gjithnjë e më tepër po rritet numri i nënave të punësuar dhe krahas saj po rriten edhe kërkesat për strehim apo edukim të fëmijëve në institucionet parashkollore. Numri i këtyre institucioneve parashkollore as për afërsisht nuk i plotëson kërkesat e fëmijëve për t'u vendosur në këto institucione. Ne e dimë se nëpër shumë vende të rajonit e të botës ekzistojnë fonde të posaçme vetëm për fëmijë. Kur është fjala për donacione financiare për ndërtimin e institucioneve parashkollore

propozoj të parashihet në nenin 27 nën numrin themelor 3 teksti nga buxheti i Kosovës dhe nga buxheti i komunave të Kosovës të formohen fonde financiare për fëmijë.

Edhe mbikëqyrja shëndetësore edhe kujdesi social të bëhen nga komunat. Projektligji, pos çështjeve të mira që i parasheh për parashkollorët, ka aty këtu edhe disa mangësi, së pari titulli i këtij projektligji është, Projektligji për edukimin parashkollor, që duhet të plotësohet me fjalën fëmijë dhe duhet të jetë: Projektligji për edukimin e fëmijëve parashkollorë, tani si vërejtje e përgjithshme është që Projektligji nuk ka fare faqe, prandaj sugjerimet, plotësimet dhe vërejtjet që do t'i bëhen këtij projektligji do të bëhen sipas neneve dhe paragrafëve të tij. Në paragrafin 6 të nenit 1 në bazë të Konventës ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës bëhet fjalë për mbrojtjen e fëmijëve, me të cilën, si shkruan, mbrohet fëmija nga çdo formë e dhunës fizike dhe mendore, fyerja, ose keqtrajtimi, braktisja ose mospërfillja, nëpërkëmbja e tjera, Do të ishte mirë që këtij nëntitulli për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë t'i shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: të dënohen me ligj qoftë me të holla ose edhe me masa të tjera ndëshkuese të gjithë ata që i rrahin ose i keqtrajtojnë sidomos fëmijët parashkollorë.

Neni 5 parasheh përdorimin e gjuhës së minoriteteve nëpër institucione parashkollore në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe me ligje të veçanta, kuptojmë se duhet të përdoret gjuha e minoritarëve nëpër institucione parashkollore të Kosovës ashtu siç veprojnë shtetet e përparuara demokratike, por me ligje ndërkombëtare e jo me ligje të veçanta të dallohet Kosova prej shteteve të tjera.

Në Projektligj përmenden dy kategorizime të moshave të fëmijëve për edukim, kopshti i fëmijëve që i referohet kujdesit ditor të fëmijëve të moshës 9 muajsh deri 6 vjeç, edukimi parafillor që i referohet klasës përgatitore jo obligative në shkollë, fillore dhe përfshin moshën 5 deri 6 vjeç, do të duhej që me ndonjë paragraf të veçantë të planifikohej me ligj edhe kategorizimi (ndarja) e tretë e edukimit parashkollor që do të dominohej (emërtohej) çerdhe, ku do të kategorizoheshin fëmijët e moshës 9 muajsh deri 3 vjeç. Në fakt një ndarje e tillë ekziston natyrshëm dhe përkujdesjen dhe edukimin e kësaj moshe të fëmijëve i merr përsipër kuadri me përgatitje të mesme për (motër) edukatore ose me shkollë të mesme për (motër) pediatre. Por shtimi i ndonjë paragrafi ose neni të veçantë në kudër të Projektligjit do t'i konkretizonte më mirë obligimet dhe detyrat për edukim të planifikuar të kësaj moshe shumë të ndjeshme të fëmijëve.

Në fund po them se gabimet gjuhësore teknike dhe të tjera nuk janë të pakta në këtë projektligj, dhe për të theksuar të gjitha këto gabime mbase do të duhej të mbarshtrrohej një tekst i gjerë, por unë për shkak të kohës së paraparë do t'i theksoj vetëm një ose të paktën disa nga këto gabime.

Së pari është shumë frymëzues fakti se kur kryetari i komisionit të caktuar funksional që projektligjin e caktuar për koncesione e kanë përgatitur vetë komisioni parlamentar, por këtë e kanë kthyer për shkak të përkthimit jo në nivel në gjuhën angleze.

Do të ishte shumë më mirë të marrim mësim nga kjo që edhe ne ta bëjmë këtë kur projektligjet janë me gabime logjike ose me gabime të shumta gjuhësore. Ju lutem ta keni këtë parasysh. Kujtoj që vërtet kjo është në të mirën tonë për gjeneratat e ardhshme që t'i shohin se çfarë ligjesh vërtetë edhe funksionale dhe sipas logjikës hartoheshin edhe me një gjuhë të rrjedhshme.

Gabimin që ceka do të thotë është në nenin 1, kryerreshti i dytë, në reshtin e tretë e që pastaj kjo fjalë nuk është përdorur në vijim, por ka kaluar në rasën tjetër që është një gabim shumë i madh logjik. Kush do ta kuptoj? ("dëmtimeve") "Në fund qëllimet, parimet dhe objektivat e këtij projektligji janë në përputhje me standardet dhe me dispozitat e Bashkësisë Evropiane, prandaj, në emër të Grupit



Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim në parim këtë projektligj me një sugjerim që në komisionin funksional të përpunohet me vërejtjet e dhëna dhe të amendamentohet dhe të bëhet më funksional dhe më i përsosur për ne. Ju faleminderit .

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputete, në emër të grupit parlamentar të PDK-së deputetja Sala Ahmetaj, le të përgatitet Mazllum Kumnova

### **SALA AHMETAJ**

Përsëritje për të gjithë të pranishmit dhe për ju z. kryesues.

Projektligji për edukimin parashkollor është i një rëndësie të veçantë, sepse edukimi i mirëfilltë dhe i domosdoshëm do të duhej të fillonte që në fëmijërinë e hershme, prandaj ne e përkrahim në parim miratimin e këtij projektligji që është tejte i rëndësishëm për normimin e jetës dhe për kultivimin e integritimit social e kulturor të fëmijëve. Ne kemi edhe disa vërejtje për nenet e caktuara siç janë disa çështje të përdorimit të gjuhës rreth çështjeve të standardeve dhe të normave ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve e tjera. Pastaj, si zakonisht, rreth gabimeve të shumta gjuhësore që na bëjnë të mos ndjehemi aq mirë, sepse për gjërat e tilla po flasim vazhdimisht. Vërejtjet për këto nene do t'i ofrojmë si kontribut për punën tonë në komisionin përkatës, në mënyrë që ligji të bëhet më i zbatueshëm dhe më përfitues, sidomos për disa kategori dhe për disa shtresa sociale, siç janë: fëmijët e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve të luftës etj. Ne në parim e përkrahim ligjin dhe shpresojmë se me amendamentim do të bëhet më i përkrye, në mënyrë që të jetë edhe më i zbatueshëm. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Deputeti Mazllum Kumnova, le të përgatitet në emër të Grupit Parlamentar ORA.

### **MAZLLUM KUMNOVA**

Z. kryesues, ministra.

Projektligjin për edukimin parashkollor Grupi i AAK-së e ka shqyrtuar dhe më parë ka përgëzuar hartuesin për përpjekjet për ta bërë një ligj që konsiston të rregullojë funksionin ligjor të edukimit parashkollor në Kosovë. Për këtë hallkë të edukimit deri tani kemi pasur një rregullativë ligjore: ligji për edukimin dhe arsimin parashkollor i vitit 1978 ,që si i tillë pas luftës nuk u zbatua në Kosovë dhe mirë u bë, sepse ishte ne kundërshtim me realitetin e krijuar ne fushën e edukimit dhe të arsimit te ne.

Ky projektligj ka mbështetje ne përvojën e përparuar, është harmonizuar me legjislacionin, standardet dhe direktivat e Bashkësisë Evropiane sot të zbatueshme. Përveç kësaj hartuesi ka bërë përpjekje për te krijuar një favor për kushtet tona edhe pse kjo mbetet vetëm përpjekje. Ky projektligj krijon kushte për përmirësime të treguesit të përfshirjes se fëmijëve ne këtë hallkë te edukimit, tregues qe sot është mjaft i ulët, shqetësues dhe na detyron qe si problem ta debatojmë në ndonjë seancë te këtij kuvendi. Në vlerësimin qe e kemi bërë Grupi i AAK për një përkrahje në parim, kemi vërejtur se ka lëkundje, paqartësi në shpjegimin e përkufizimeve si: parafillor, parashkollor, edukim ,që mbetet për një përpunim të qartë sidomos për disa nene ,që do t'i japim me shkrim. Në të njëjtin vit të trajtimit mendojmë edhe për përdorime të gabuara të fjalëve të shqipes. Pa dyshim gjatë

procedimit duhet të merrën në dorë këto vërejtje dhe të përmirësohet Projektligji. Si përfundim Grupi i AAK-së në terësi e vlerëson të kalueshëm këtë projektligj ,prandaj kërkojmë t'i hapet rrugë duke e siguruar kontributin tonë gjatë procedimit. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Genc Gorani, në emër të Grupit Parlamentar ORA, le të përgatitet Kamber Kamberi

### **GENC GORANI**

Z. kryesues, zonja dhe zotërinj deputetë dhe të tjerë të pranishëm.

Projektligji për edukimin parashkollor ofron një bazë të nevojshme për funksionimin e sistemit të edukimit parashkollor. Megjithëkëtë ka vend për vërejtje serioze sa i përket centralizimit etatist dhe monitorimit të funksionimit të institucioneve parashkollore.

Si vërejtje të dytë do të doja ta theksoja atë se theksi i veçantë duhet të vihet mbi organizimin dhe edukimin parashkollor në zonat rurale.

Grupi parlamentar ORA e përkrah në parim Projektligjin për edukimin parashkollor. Sugjerimet tona do t'i paraqesim në formë të amendamenteve në kuadër të komisionit përkatës funksional. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka Kamber Kamberi. Le të përgatitet deputetja Flora Brovina

### **KAMBER KAMBERI**

Ju faleminderit z. Kryesues. Ky projektligj për edukimin parashkollor, bashkangjitur me shkresën shpjeguese është i domosdoshëm tashmë për rregullimin e punës edukative për fëmijët parashkollorë.

Është një projektligj, por para se të kaloj në vërejtjet për të do të doja të thosha edhe për vërejtjet e bëra shpeshherë nga deputetët, për gabime të shumta gjuhësore dhe sintaksore. Megjithëkëtë këto vërejtje nuk janë marrë në konsideratë dhe këto gabime, madje edhe për ligjen pa u vënë re, sepse edhe z. kryeministër e hedhur nënshkrimin për t'u dhënë vizë projektligjeve nën titullin e tij kryeminis, që vazhdimisht i shkruhet gabimisht. Vërejtje përmbajtjesore të këtij projektligji mund të bëhen për nenin 6, pika 2, ku përdoren gabimisht termat: dëmtime mendore, dëmtime të shikimit, dëmtime të dëgjimit etj. Këta duhet të zëvendësohen me termat: të meta mendore (mentale), të meta në shikim, të meta në dëgjim e tjerë, sepse kështu nënkuptohen të metat që mund të jenë të lindura ose të shkaktuara pas lindjes, ndërsa dëmtime nënkuptohen ato që mund të shkaktohen pas lindjes të fëmijës.

Në neni 24 pika 4 duhet të ndërhyhet gjithashtu, sepse nuk është definuar qartë. Një lëshim tjetër ndoshta alogjik paraqitet në neni 25, pika 2 ku thuhet: "Kategoritë e fëmijëve që janë përfitues të veçantë nga buxheti i Kosovës j pos të tjerëve janë nën c: "fëmijët e dëshmorëve të luftës" Kjo duhet të fshihet tërësisht, sepse dihet që parashkollorët janë të moshës 5 dhe 6 vjeç dhe tashmë nuk mund të ketë lindje të këtyre fëmijëve të dëshmorëve. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka Flora Brovina. Le të përgatitet Fetah Berisha.

**FLORA BROVINA**

Me vëmendje kam lexuar Projektligjin për institucionet parashkollore në Kosovë, më vjen mire për një kujdes të tillë ndaj fëmijëve të Kosovës, sepse tek e fundit për ta dhe jemi munduar dhe meritojnë një fëmijëri ndryshe. Megjithëkëtë kam disa vërejtje për këtë projektligj, pikërisht për institucionet parashkollore në zonat rurale, pra në zona të varfra si do të financohen ato dhe sipas këtij projektligji vërej një dallim ndërmjet atyre që janë më të pasura, pra dallim në mbrojtjen institucionale të fëmijëve të Kosovës. Në Projektligj, gjithashtu, bashkohem me parafolësin se nuk figurojnë dhe nuk mund të figurojnë fëmijët e mbetur pa prindër gjatë luftës, sepse ata janë të moshës më se 6 – 7 vjeçare dhe dihet së brezi më i ri i lindur në kohën e luftës, tani hyn në klasën e parë. Megjithëkëtë kujtoj se shoqëria jonë i ka mbetur borxh kësaj kategorie shumë të vuajtur edhe me pasoja. Këta kanë shumë pasoja posttraumatike të luftës dhe kanë nevojë për përkrahje institucionale. I vetmi institucion vullnetar që prej themelimit në vitin 1998 është Qendra e Rehabilitimit të Nënës dhe të Fëmijës e Prishtinës që grumbullon një numër më të madh të fëmijëve më shumë se 400 sish, mirëpo me hyrjen në moshën madhore e lëshojnë Qendrën dhe tani janë numër më i vogël. Momentalisht kjo qendër ka 250 fëmijë pa prindër, me njërin nga prindërit kryesisht me nëna vetëmbajtëse dhe jo të shkolluara, që mund ta mbajnë familjen në mënyrë shumë adekuate. Ato edhe vetë kanë nevojë për përkrahje institucionale. Fëmijë invalidë të luftës dhe të mbetur në gjendje shumë të rëndë materiale. Kujtoj se një aneks këtij projektligji për institucione të veçanta për qëndrim ditor, do të ishte i mirëseardhur për këtë kategori jo vetëm në Prishtinë, por dhe në qytetet e tjera. Unë do përmend vetëm me çka ballafaqohet, ta zëmë, kjo qendër në mungesë të mbrojtjes institucionale. Këta fëmijë që vijnë gjatë ditës, e thashë, janë 250, nuk kanë ushqim, nuk kanë ngrohje dhe nuk kanë energji elektrike Ju faleminderit. Vërejtjet do t'i jap edhe me shkrim.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju falemnderit, zonja deputete

Para se t'ia jap fjalën folësit tjetër, i lus deputetët të kthehen në sallë

Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha

**FETAH BERISHA**

Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar kolegë deputetë, në këtë seancë po diskutojmë për Projektligjin në parim për edukimin parashkollor që e ka përpiluar Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. Ky projektligj ka një rëndësi të veçantë, sepse parasheh funksionimin ligjor dhe institucional të arsimit, edukimit parashkollor. Projektligji parasheh parapërgatitjen e fëmijëve për arsimin dhe edukimin e tyre të mëtutjeshëm për vijimin e mësimëve në shkollat fillore, gjithashtu parasheh parimin gjithëpërfshirës pa dallim në edukimin parashkollor dhe edukimin në familje për fëmijët që nuk kanë mundësi t'i vijnë në objektet institucionale. Në këtë projektligj po ashtu është sanksionuar edhe përpilimi i plan-programeve në përputhje me praktika e standarde bashkëkohore ndërkombëtare. Mirëpo, me përpjekjet e bëra që ky projektligj të dalë sa më komplet nga përpiluesi, prapëseprapë hetohet se edhe në të ka mangësi dhe duke pasur në konsideratë anët pozitive dhe rëndësinë e këtij projektligji del se nuk është bërë një analizë e thuktë që të dalë sa më komplet. Gjatë leximit të Projektligjit bie në sy se shumë nene janë lënë të sqarohen me udhëzime administrative, pra 16 nene të sqarohen me 16 udhëzime administrative. Kjo bie në sy sidomos te neni 27 që duhet të sqarohet më

mirë.Po kështu është vepruar kur është fjala për fondin e orëve të edukatorëve, për mënyrën institucioneve parashkollore, edukimin parashkollor formal në familje, kohëzgjatja e programeve parashkollore etj, këto kompetenca që të rregullohen me udhëzime administrative sado që e plotësojnë Projektligjin, ma thotë mendja se kaq shumë udhëzime administrative sikur e zbrazin këtë projektligj nga kompetencat, gjithashtu me plan-programet për edukimin parashkollor përzgjedhjen dhe përpilimin e tyre duhet t'i bëjë Këshilli i ekspertëve i pedagogëve për këtë fushë e jo të merret kuvendi komunal ose këtë punë ta bëjnë pedagogët e DKA-së. Në këtë projektligj nuk janë caktuar qartë as grup moshat e fëmijëve, por thuhet:” Në edukimin parashkollor do të vazhdojnë fëmijët derisa të fillojë mësimi në klasën e parë fillore”. Është punë në kompetenca të këshillit drejtues të prindërve dhe të këshillit drejtues të institucioneve parashkollore,që duhet të qartësohen më hollësisht Ky projektligj i ka edhe disa gabime teknike,por edhe gjuhësore që mund ta përmend vetëm një. Në nenin 6 të këtij projektligji shkruhet në të tri gjuhët” cllan” 6. Sidoqoftë ky projektligj në parim duhet të miratohet. Natyrisht vërejtjet e bëra të kihen parasysh në variantet e tjera që do të vijnë pas tij.

Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit zoti deputet.

Pasi e kemi përfunduar debatin, deputetë të nderuar,ju ftoj të deklaroheni për miratimin në parim të Projektligjit.

Lus regjinë të bëhemi gati për votim.

Votojmë tani:

63 deputetë kanë votuar për Projektligjin për miratimin në parim të projektligjit në fjalë

Në bazë të rregullës 23, pika 6 dhe rregullës 35, pika 2, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si Komision funksional dhe referues,
2. Komisioni për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisioni për Buxhet dhe
4. Komisioni për Komunitete

Komisionet duhet ta shqyrtojnë Projektligjin jo më shumë se dy muaj pas shqyrtimit të parë dhe Kuvendit t'i paraqesin Raportin me rekomandime.

Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Të nderuar deputetë, para se të kalojmë në pikën 10 të rendit të ditës, me keqardhje sapo e morëm lajmin se ka vdekur kryetari i komunës së Mitrovicës zoti Faruk Spahia.

Lus deputetët që me një minutë heshtje t'ia bëjmë nderimin e fundit- Lavdi .

Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjueti. Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 3.08.2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'u drejtohen

për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore. Ftohet zëvendësministri Tomë Hajdaraj, që në emër të Qeverisë të Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin. E keni fjalën shoku Zëvendësministër

### **TOMË HAJDARAJ**

Faleminderit zoti kryesues. Të nderuar deputetë, meqenëse të gjitha procedurat janë kryer konform rregullativës dhe punës në Kuvend dhe në Qeverisë unë vetëm në pika të shkurtra po ju njoftoj për qëllimin e hartimit të këtij projektligji, përkatësisht për miratimit e tij sot në parim. Qëllimi kryesor i Ligjit është krijimi i bazës ligjore për përdorim të qëndrueshëm të faunës duke siguruar mbrojtjen adekuate të kafshëve të egra dhe ekosistemeve të tyre. Ky projektligj bazohet në ekonominë e tregut dhe parasheh mundësinë e caktimit të një vend gjuetie privat dhe mundësinë për ta dhënë për menaxhim vendin e gjuetisë personave juridikë ose fizikë vendorë dhe të huajve. Qëllimi i këtij Ligji është edhe rregullimi normativ i gjuetisë sipas parimeve të Këshillit Ndërkombëtar për Gjueti dhe Mbrojtjen e Kafshëve të Gjahut sipas konventave të miratuara ndërkombëtare dhe standardet botërore për mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen dhe ruajtjen e kafshëve të egra dhe qëndrimin të tyre, ruajtjes së baraspeshës biologjike ose mbrojtjes së llojit të caktuar të kafshëve të egra dhe të rralla kur vlerësohet se ato janë të rrezikuara. Bazën e qëndrueshme për hartimin e Projektligjit paraqet edhe strategjia e menaxhimit të kafshëve të egra e hartuar nga Ministria jonë në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Ushqimit FAU. Ky projektligj përbëhet prej 11 kapitujve duke u nisur prej dispozitave të përgjithshme deri te dispozitat e fundit, prandaj duke pasur parasysh edhe kohën në të cilën jemi, do të thotë është një periudhë ku duhet ta kemi këtë ligj. Ju ftoj ta miratoni në parim. Për vërejtje eventuale ne do t'ju jemi mirënjohës dhe to t'i inkorporojmë në komisionet parlamentare, përkatësisht në Komisionin funksional. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit zoti zëvendësministër.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, hapim debatin në parim. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputetja Zyhrije Maloku. Le të përgatitet në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Xhelal Canziba.

E keni fjalën zonja deputete

### **ZYHRIJE MALOKU**

I nderuari zoti kryesues, të nderuar ministra dhe zëvendësministra, kolegë deputetë.

Projektligji për gjuetinë rregullon në mënyrë të qëndrueshme dhe të pranueshme një problematikë shumë të gjerë, sepse edhe kafshët e egra janë pasuri natyrore, me interes të përgjithshëm, që duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë. Mendoj se është bërë një punë e mirë në përgatitjen e këtij projektligji për të menaxhuar ashtu siç duhet faunën e egër, duke siguruar një kultivim dhe mbrojtje të posaçme ndaj kafshëve të egra dhe ekosistemeve të tyre, andaj ky projektligj, si i tillë, me të gjitha vërejtjet parimore dhe përmbajtjesore që do t'i bëhen në shqyrtim të parë dhe në vazhdimësi në shqyrtimin e Komisionit Funksional, me procedurë të amendamentimit, do të bëhet një ligj i mirë, i kompletuar, funksional dhe i zbatueshëm. Ligjin e kam lexuar me kujdes dhe me pak fjalë do të përqendrohem me disa vërejtje dhe mangësi në masë të konsiderueshme në disa nene. Në nenin 6, te Federata e Gjuetarëve të Kosovës mendoj se ky nen nuk është sqaruar sa duhet me të dhënat e mjaftueshme për shembull nuk përmendet se në cilin qytet të Kosovës do të jetë selia e Federatës, mandej thuhet se Federata do të financohet nga kontributi i anëtarëve, çka do të ndodhë nëse Federata nuk ka anëtar të mjaftueshëm, nga kush do të

financohet, pastaj funksionet, detyrat, përgjegjësitë, veprimtaria, mënyra e anëtarësimit ka qenë dashur të rregullohen me këtë ligj e të mos mbeten për në të ardhmen që të rregullohen me akte nën ligjore ose të mos rregullohen fare. Në nenin 9, pika 5 thuhet citoj:” Leja për gjuajtjen gjatë natës, përveç tjerash, duhet të përmbajë: kohën, vendin, llojin e kafshëve, dhe emrat e personave që marrin pjesë në gjueti. Mendoj se në këtë renditje duhet të hyjë edhe metoda apo mënyra e gjuajtjes, sepse gjahu i natës duhet të dalloj nga gjahu i ditës.. Nata është kohë kur nuk duhet të shqetësohen banorët e zonave gjege me zhurma të ndryshme, andaj gjuetari duhet të paralajmërojë në çdo mënyrë të gjuetisë se do të përdorë edhe mjete për t’i lajmëruar me kohë banorët e asaj zone të vendit të gjuetisë. Në nenin 11, pika 8 nën (b) thuhet se Ministria me akt nënligjor mund të pranojë gjuetarë të kualifikuar të moshës më se 65 vjeçare dhe mund të caktoj rregulla të veçanta për ta. Shtrohet pyetja çfarë rregullash të veçanta do të vlenin për një gjuetar që është në prag të 70-tave ose athua çfarë gjahu efektiv do të bënte një 80 vjeçar .mendoj se regjistri i gjuetarëve duhet të ripërtërihet por jo me gjuetarë mbi moshën 65 vjeçare, por nën moshën 65 vjeçare. Në nenin 13, pika 7, thuhet se askush nuk mund t’i gjuajë llojet e kafshëve të egra dëmtuese në vendet e ndaluara për gjah. Por çka nëse kafsha dëmtuese rrezikon jetën e banorit jashtë vendit të gjuetisë, atëherë duhet të lejohet dëmi që shkakton ajo ase të presim derisa të futet brenda vendit të gjuetisë për të ndërmarrë masa të duhura. Kujtoj se kafsha e egër dëmtuese, që rrezikon jetën e njeriut, duhet të gjuhet edhe jashtë vend të gjuetisë pa i kufizuar kohën dhe vendin. Duke qenë se sot është vetëm shqyrtimi i parë i Projektligjit nuk do t’ju marr kohë më tepër edhe pse i kam edhe disa vërejtje të tjera, por ato do t’i shqyrtojmë me anëtarët e tjerë të Komisionit. Propozoj që ky projektligj të marr përkrahjen e Kuvendit dhe të miratohet në parim, pra edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Jo faleminderit zonja deputete

Fjalën e ka deputeti Gjeral Canziba, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, le të bëhet gati deputeti Mazllum Kumnova

## **XHELAL CANZIBA**

I nderuar zoti kryesues, i nderuar zëvendësministër dhe ju kolegë deputetë  
Nxjerrja e këtij projektligji bëhet me qëllim që të krijohet bazë e mirë ligjore që do të rregullon gjuetinë. Ligji që është në zbatim edhe sot është i sistemit të kaluar totalitar dhe nuk mund të jetë më i aplikueshëm në rrethana të reja të krijuara në Kosovë pas lufte, që synon ekonominë e tregut. Ligji i mëparshëm nuk e ka rregulluar në tërësi çështjen ,posaçërisht siç e rregullon ky projektligj. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e ekosistemeve dhe e baraspeshës ekologjike, në rregullimin e raporteve ndërmjet mbrojtjes dhe përdorimit të llojeve të caktuara të kafshëve të egra, mbrojtja adekuate dhe sigurimi i mirëqenies të kafshëve të egra si dhe sigurimi i kushteve për shfrytëzimin ekonomik të resurseve natyrore. Ky projektligj i ka për bazë pronën private dhe ekonominë e tregut, që parasheh mundësinë e themelimit të një vendi të gjuetisë private dhe mundësinë që t’u jepet për menaxhim vend-gjuetie personave juridikë ose fizikë. Ligji i vjetër ka pasur për bazë ekonominë e planifikuar dhe pronën shoqërore, prandaj si e tillë nuk mund të zbatohet më . Është mirë që Projektligji qenka harmonizuar me ligjet e Baashkësisë Evropiane. Ky projektligj ka mjaft paragrafë të neneve që nuk janë të sqaruara mirë. Grupi Parlamentar i PDK-së në parim e përkrah Projektligjin për gjuetinë me disa vërejtje që besoj se do të mënjanojnë gjatë shqyrtimit nëpër komisionet kryesore të Kuvendit dhe do të bëhet amendamentimi i ligjit. Prandaj, kujtoj se me rastin e miratimit është dashur të mendohej mirë a mund të

zbatohet në praktikë apo edhe ky ligj do ta ketë fatin e ligjeve të tjera që janë miratuar në këtë Kuvend, por sot e kësaj dite nuk zbatohen fare në praktikë. Ju faleminderit

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit zoti deputet. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Mazllum Kumnova, Le të përgatitet në emër të Grupit Parlamentar të ORA deputetja Teuta Sahatçija

### **MAZLLUM KUMNOVA**

Zoti kryesues, ministra, Grupi i AAK-së e përgëzon Ministrinë e Bujqësisë për Projektligjin e propozuar. Projektligji synon ta rregullojë këtë veprimtari në Kosovë. Këtë projektligj të propozuar në përgjithësi, e kemi vlerësuar se është i mirë, por ne do të ngritim disa çështje, që duhet të reflektohen gjatë punës së mëtejshme. Së pari projektligji për gjuetinë ka bërë përpjekje të rregullojë si veprimtari e njerëzve që e kanë pasion apo një degë ekonomike të ardhshme të Kosovës. Këtu janë dilemat, besojë se kjo e dyta në Kosovë është vështirë të mendohet duke pasur parasysh territorin e vet, por edhe faktorët e tjerë që ndikojnë, e nëse tentohet që të kombinohen këto të dyja, Projektligji duhet të jetë shumë më konkret dhe më i qartë në definimin e tij, sidomos nenet 1 dhe 2 që c janë gjithëpërfshirës. Së dyti, shtrohet pyetja a kemi ndonjë studim më të thelluar nga institucionet kompetente si Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në fushën e faunës së egër të përfshirë në ligjin e vjetër të zbatueshëm, si dhe të asaj të propozuar në këtë projektligj. Shkurt, a është bërë deri sot ndonjë inventarizim i llojeve dhe i popullacioneve të shtazëve të egra që propozohen si kafshë gjuetie në këtë projektligj. Ky studim do të jepte një bazë të mirë se ku e kemi gjendjen në këtë aspekt dhe kah mund të shkojmë më tutje. Mendoj se projektligji duhet të vendosë një kornizë si definohet raporti mes numrit të gjuetarëve, numrit të popullacionit të shtazëve, gjuetisë në territorin e Kosovës. Edhe pse në projektligj thuhet se janë konsultuar konventat ndërkombëtare dhe direktivat evropiane, këtu e kam fjalën te habitatet e shpeneve, lista e shtazëve të futua në projektligj bie ndesh me aneksin 2 dhe 4 të kësaj direktive të habitat. Gjatë punës së komisioneve mendoj se duhet bërë një ndryshim i domosdoshëm, por shumë thjeshtë. E njëjta shtazë nuk mund të jetë e trajtuar si lloj në zhdukje me direktivat e habitateve, në anën tjetër e lejuar për gjueti me ligjin tonë dhe atë pa kurrfarë kufizimi. Në projektligj nuk u është dhënë hapësirë e duhur kompetencave të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor si institucion kompetent për mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në Kosovë. Këtë fushë duhet ta futim në këtë projektligj, duhet të gjendet një mekanizëm ligjor, në bazë të cilit popullacionet e një shtaze që sot i kemi në listë për gjueti, të zvogëlohen ose të rrezikohet dukshëm numri i tyre. Ministria e Mjedisit të ketë të drejtë ndalimi të gjuetisë, qoftë edhe me ndalesa të përkohshme për mos u zhdukur lloji siç edhe po ndodh aktualisht. Pastaj, kemi edhe vërejtje të tjera konkrete edhe për nene, kemi vërejtje se lista që është futur në aneks ka edhe shtazë të egra që sot nuk ekzistojnë as në Kosovë e as në Ballkan, sikur e kemi për çështjen e Federatës së Gjuetarëve që mendoj se nuk është e definuar a është OJQ a është fondacion, a çka është, prandaj mëgjithëkëto vërejtjeve ne mendojmë që të përkrahim në parim këtë projektligj me kusht që të bëhen këto përmirësime në punën e mëtejshme. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit zoti deputet, në emër të Grupit parlamentar ORA, deputete Teuta Sahatçija dhe le të behet gati i fundit deputeti Fadil Gashi  
Keni fjalën zonja Teuta

**TEUTA SAHATQIU**

Ju faleminderit zoti kryesues, ne si grup parlamentar e përkrahim në parim Projektligjin për gjuetinë dhe amendamentet dhe punën tonë do ta paraqesim në Komisionin funksional. Komisioni funksional duhet të ketë parasysh që ekosistemet të respektohen dhe të kihet parasysh baraspesha ekologjike. Gjithashtu edhe resurset natyrale të shfrytëzohen në mënyrë ekonomike me ç'rast të ndihmohet dhe të kontribuohet në ekonominë e Kosovës. Pra, si Grup Parlamentar e përkrahim. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit

Ftoj deputetët të kthehen në sallë. Fjalën e ka i fundit deputeti Fadil Gashi

**FADIL GASHI**

Ju faleminderit zoti kryesues. Do të tërhiqem nga diskutimi dhe do ta dorëzoj me shkrim.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit

Ftoj deputetët të deklarohen për miratimin në parim të projektligjit.

Regjia të përgatitemi për votim, votojmë tani.

Për janë 61 deputetë dhe konsideroj se projektligji është miratuar në parim.

Në bazë të rregullës 23, pika 6 dhe të rregullës 35, pika 2, Kuvendi ngarkon këto Komisione:

1. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor si Komision funksional dhe referues,
2. Komisioni për Gjyqësi, Legjilacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisioni për Buxhet dhe
4. Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin Raportin me rekomandime.

Të nderuar deputetë, në fund të kësaj pike, pra pikës së 10 të rendit të ditës propozoj që seanca të vazhdojë të mërkurën në orën 10,00.

Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Mirëmëngjesi, mirëseardhje në vazhdimin e seancës plenare.

Pika e radhës në rend të ditës është:

**Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare.**



Konstatimet hyrëse: Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 18 gusht 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'ia adresojmë Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet Ministri Bujar Dugolli që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantoj Projektligjin.

Ministër foltorja është e juaja.

## **BUJAR DUGOLLI**

Z. Kryetar e nderuar Kryesi e Kuvendit, të nderuar deputet.

Në vijim do të përpiqem të paraqes në vija të shkurtra qëllimet, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e ligjit për markën tregtare. Projektligji për markën tregtare ka për qëllim të siguroj mbrojtjen adekuate të markave tregtare, emërtimeve tregtare në përputhshmëri me konventat ndërkombëtare si dhe me legjislacionin dhe praktikën e Unionit Evropian. Duhet theksuar se ky Projektligj është i zbatueshëm për të gjithë personat, ndërmarrjet dhe autoritetet publike në Kosovë. Rëndësia e marrjes së Ligjit për markën tregtare rrjedh nga fakti që ky instrument ligjor rregullon një fushë të rëndësishme të ekonomisë së tregut, atë të mbrojtjes së markave tregtare, emërtimeve tregtare duke siguruar në këtë mënyrë një përputhshmëri të normave vendore me ato ndërkombëtare dhe me legjislacionin dhe praktikën e Bashkimit Evropian, për sa i takon mbrojtjes së markës tregtare në Kosovë.

Projektligji për markën tregtare ka një gjerësi të rregullimit të këtyre fushave. Është i strukturuar gjithsej në 6 pjesë dhe përmban dy anekse, aneksin për markën kolektive dhe aneksin për markën e certifikuar. Pas përkufizimit të fushës së rregullimit dhe qëllimit pjesa e dytë e projektligjit ka të bëjë me: Kushtet, fushëveprimin dhe kufijtë e mbrojtjes së markës tregtare dhe emërtimeve tregtare. Në këtë pjesë bëhet përkufizimi i nocionit të markës tregtare duke i përkufizuar të gjitha kategoritë që në një mënyrë ose tjetër përfshihen në kategorinë e markave tregtare sipas dispozitave të Projektligjit.

Në kreun dy, hartuesit e Projektligjit për markën e mbrojtjes së markave tregtare më rezistent duke filluar nga pronësia, baza absolute dhe relative për furnizimin e regjistrimit të markës tregtare e cila është dhënë në formë të kushteve, ekzistenca e të cilave pamundëson regjistrimin e markës tregtare.

Kapitulli tre, rregullon çështjen e prodhimit të efekteve juridike që krijohen me rastin e regjistrimit të markës tregtare, me fjalë të tjera: Projektligji përcakton të drejtat që pasojnë me rastin e regjistrimit të markës tregtare. Kufijtë e markës së regjistruar tregtare dhe çështjet që kanë të bëjnë me humbjen e të drejtave që barten me regjistrimin e markës tregtare.

Në kapitullin e katërt, janë ofruar zgjidhjet juridike përkitazi me procedurat e zbatueshme në rast të kundërvajtjes, përdorimi i mjeteve juridike dhe rastet e shkeljes së markës tregtare. Mjetet juridike kundër kërcënimeve për iniciimin e procedurave të pa baza kundërvajtës duke rregulluar edhe çështjen e rregullimit dhe konfiskimit të mallrave, artikujve dhe materialeve.

Në kapitullin e pestë, është rregulluar licencimi i markave të regjistruara tregtare e cila manifestohet qoftë në formë të licencës së kufizuar apo të përgjithshme, për më tepër ky kapitull definon dhe përcakton edhe të drejtat e licencmarrësve dhe licencdhënësve.

Si pjesë procedurale për regjistrimin e markës tregtare në regjistrimin e markave tregtare.

Kapitulli i gjashtë, rregullon paraqitjen e aplikacionit të markës tregtare duke përcaktuar përmbajtjen e tij, datën e paraqitjes së aplikacionit si dhe kushtet për paraqitjen e aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare.

Procedimi dhe shqyrtimi i aplikacionit në kuptim të kushteve juridike të përcaktuara me ligj janë të rregulluara në kapitullin e 8 të Projektligjit. Me fjalë të tjera këtu kemi të bëjmë me një procedurë tipike administrative në të cilën zyra për patentim shqyrton secilin aplikacion dhe cili aplikacion i plotëson kushtet e përcaktuara për regjistrim. Bën verifikimin e kushteve ligjore si pjesë finale e kësaj procedure dhe kryen regjistrimin e markës tregtare. Duhet theksuar se në kuptim të procedurës administrative për regjistrimin e markës tregtare. Projektligji përcakton edhe çështjen e afatit, vazhdimin dhe ndryshimin e markës tregtare. Sipas këtij drafti rregullativën ligjore pronari i markës tregtare mund të paraqesë kërkesë para zyrës së patentimit për lejen, modifikimin e markës tregtare në çfarëdo mënyre, për deri sa modifikimi në fjalë nuk ndikon në identitetin e saj.

Në kapitullin dhjetë janë propozuar dispozitat për anulimin, evakuimin dhe shfrytëzimin e markës tregtare. Sipas zgjedhjes së tanishme juridike pronari i markës tregtare mundet vullnetarisht ta anuloj markën e regjistruar tregtare plotësisht ose pjesërisht, kurse revokimi bëhet vetëm nëse konstatohet shkelja e kushteve dhe kriteri i përcaktuar me këtë Projektligj.

Kapitulli i 11 dhe 12, përcakton kuptimin dhe bën rregullimin e markave tregtare kolektive dhe markës certifikuese. Kjo e fundit tregon se mallrat ose shërbimet në të cilat është përdorura janë të certifikuara nga pronari i markës, si për nga prejardhja, materiali, metoda e prodhimit të mallit ose kryerjes së shërbimeve, cilësisë, saktësisë dhe veçorive tjera. Në kontekst të së drejtës ndërkombëtare kapitulli i 12 i referohet protokollit të Madridit, regjistrimit ndërkombëtar. Protokollin e Madridit nënkupton protokollin i cili ka të bëjë me marrëveshjet e Madridit lidhur me regjistrimin ndërkombëtar të markës, të miratuar me 27 qershor 1989 në Madrid. Për më tepër Projektligji për markën tregtare i referohet edhe Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronës industriale të 20 marsit 1983, të ndryshimeve dhe plotësimeve ndërmjet protokolleve për këtë Konvent dhe atë në drejtim të mbrojtjes së markave të njohura tregtare, emblemave kombëtare të shteteve të konventës si dhe për emblemat e organizatave ndërkombëtare.

Pjesa e katërt e Projektligjit rregullon aspektet e procedurës së regjistrimit të markave tregtare një formë e procedurës administrative sipas versionit aktual, zyra e patentimit mban një regjistër të markave tregtare i njohur si regjistër i markave tregtare e cila në mes tjerash përfshin markën e regjistruar tregtare dhe veçoritë e transaksioneve të cilat kanë ndikim në markën e regjistruar tregtare. Në këtë drejtim Projektligji e njuh të drejtën e qytetarëve të interesuar që jo vetëm të kenë qasje në regjistrin në fjalë por ju garanton edhe të drejtën për të aplikuar për korrigjime ose përmirësime të ndonjë gabimi ose lëshimi në regjistër. Për deri sa një ndryshim i tillë nuk ndikon në vlefshmërinë e regjistrimit të markës tregtare. Sa i takon veprimeve që bëhen në personat ose ndërmarrjet lidhur me regjistrimin e markës tregtare ose çdo procedurë që ka të bëjë me markat tregtare. Projektligji mundëson kryerjen e veprimeve të tilla nga agjentët tregtar konform rregullave në pjesën e pestë.

Sipas këtyre rregullave një veprimtari të tillë mund ta ushtrojë vetëm agjenti i licencuar në Kosovë nga zyra e patentimit në pajtim me rregullativën ligjore dhe aktet relevante nënligjore të cilat përcaktojnë kushtet dhe procedurat e regjistrimit të agjentëve tregtar. Siç është përmendur edhe me lartë Projektligji përmban edhe një kornizë rregullative të dizajnuar. Sa i përket markave tregtare kolektive dhe certifikuese e cila është dhënë në formë aneksi në fund të Projektligjit duke përcaktuar në hollësi shenjat përbërëse të markave kolektive dhe certifikuese, prejardhjen gjeografike, kontratat për shfrytëzimin e markave tregtare

kolektive dhe certifikuese dhe aspektet e tjera të cilat në një mënyrë ose tjetrën garantojnë një regjistrim dhe mbrojtje të plotë ligjore për të dy këto kategori të markës.

Të nderuar deputet, rëndësia e rregullimit juridik të kësaj fushe është vitale për ndërtimin e një ekonomie formale në Kosovë të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut. Ky Projektligj do të vendos një rregull ligjor sa i takon regjistrimit dhe përdorimit të markave tregtare në Kosovë duke ofruar edhe garanci juridike institucionale, gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi i markës tregtare.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij Projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në fushën e ekonomisë në përgjithësi kërkoj të nderuar deputet që pas shqyrtimit të miratoni në parim këtë ligj dhe të vazhdojnë procedurat e mëtutjeshme.

Ju faleminderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Ministër ju faleminderit, hapim debatin në parim. Z. Fatmir Rexhepi në emër të LDK-së, kurse le të përgatitet Bajrush Xhemajli në emër të PDK-së.

### **FATMIR REXHEPI**

Z. kryetar, të nderuar deputet, të nderuar ministra. Lidhur me projektligjin për markat tregtare është Ligji më i rëndësishëm në lëmin e pronës intelektuale, sa i përket mbrojtjes së saj dhe nxitjes së investimeve në Kosovë. Kjo ndodh se investitorët e shohin mbrojtjen e markave të tyre tregtare si një element kyç për ushtrimin e afarizmit në një vend, kështu ndërtimi i një ligji të mirë mbi markat tregtare që është në harmoni me standardet dhe legjislacionin e bashkësisë Evropiane dhe kërkesat tjera është një hap përpara duke krijuar mundësi të mëdha për investime dhe zhvillim ekonomik në të ardhmen. Projektligji u lejon pronarëve vendor dhe të huaj të markave tregtare që të regjistrojnë dhe mbrojnë markat tregtare. Është mirë që ligji nuk parasheh ndonjë agjenci të veçantë që të mirret me regjistrimin e markave tregtare por këtë e mbështet tek zyra për patenta në kuadër të ligjit mbi patentat. Nëpër kapituj të këtij Projektligji trajtohen çështjet që fillojnë nga përkufizimet, njohja prioriteti, licencimi, anulimi i markave tregtare dhe vazhdojnë deri te masat ndëshkuese. Brenda Projektligjit është vendosur edhe pjesa e veçantë që mbulon çështjet që duhet të jenë në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare mbi markat tregtare si Konventën e Parisit dhe protokollin e Madridit bazuar dhe vlerësuar edhe në shpjegimet e ekspertëve ligjor që unë i kamë konsultuar. Po ashtu në Projektligj janë dhënë dhe trajtuar drejtë çështjet administrative që kanë të bëjnë me themelimin dhe mbajtjen e regjistrit të markave tregtare si dhe përgjegjësitë e zyrës së patentave. Struktura dhe detajet që siguron Projektligji mundëson një nivel të lartë të sigurisë juridike e cila i nevojitet përgjithësisht kuadrit ligjor të Kosovës.

Përfundimisht grupi parlamentar i LDK-së është që ky Projektligj të përkrahet në parim dhe të procedohet në Komisionin funksional të Parlamentit për shqyrtim të mëtutjeshëm. Ju faleminderit për vëmendjen.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Bajrush Xhemajli, kurse le të përgatitet Xhevdet Neziraj.

**BAJRUSH XHEMAJLI**

Ju faleminderit z. kryetar, përshëndetje kolegë deputet, ministra.

Projektligji për markat tregtare është një Projektligj të cilin grupi parlamentar i PDK-së e përkrah në parim. Është një ligj i punuar mirë, kemi vërejtje në si grup parlamentar në nenin 3.2. (c), nenin 10 etj, mirëpo ato do t'ia paraqesim komisionit funksional pasi që janë lehtë të riparueshme. Ky projektligj ka një strukturë pak të rënd dhe të ngatërruar s.p. që janë dhënë përkufizimet në termet dhe ato vazhdojnë edhe në nenin 21, 52, 54 etj, pra këto duhet strukturuar të gjitha në një vend e vendin e kanë në nenin 2. Pastaj kualifikimi i falsifikimit si vepër për kundërvajtje më duket se është stimulimi më i madh që i bëhet keqpërdorimit të markës tregtare, prandaj duhet ndërruar këtë kualifikim në nenin 84 dhe 85 dhe kjo vepër duhet të trajtohet si vepër penale. Ajo që do të ndalem posaçërisht dhe njëherit që më befason pak në këtë projektligj është se në nenin 54.1 nën (b). jep kompetenc ministrit për ta ndërruar vetë ligjin pasi të hyjë në fuqi. Ministri pas hyrjes së këtij ligji në fuqi dhe sipas nevojës mund të bëjë ndryshime në ligj dhe në rregullat e këtij ligji për aq sa të arrihet ndonjë përputhshmëri me ndonjë ndryshim që pason në konventën e Parisit. Kjo nuk do të duhej të ishte, sepse vetëm Kuvendi është kompetent për ndryshime në ligj, e di që ministrat tonë i marrin disa punë në dorë që nuk ju takojnë por kjo çka është shumë është shumë. Këtë punë lëna neve z. Ministër. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Xhevdet Neziraj, kurse le të përgatitet Teuta Sahatçia

**XHEVDET NEZIRAJ**

I respektuari kryetar i Parlamentit, të respektuar ministra dhe kolegë deputet, edhe grupi parlamentar i AAK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka konstatuar se Projektligji për markën tregtare do të plotësoj një vakum ligjor në lëmin e ekonomisë dhe kështu do të luaj një rrol të rëndësishëm në zhvillimin bashkëkohor të saj. Qëllimi i këtij ligji do të siguroj mbrojtjen adekuate të markave tregtare, emërtimeve tregtare të bazuar në praktikën dhe legjislacionin e vendit, të Unionit Evropian. Prania e një numri të madh të ndërmarrjeve ka të bëjë edhe me pròdhimin e produkteve dhe shërbimeve të cilat destinohen për plotësimin e nevojave të njëjta dhe për këtë shtrohet nevoja për identifikimin e të gjitha vlerave dhe karakteristikat e së cilës ndërmarrje, produktet e pronës industriale apo shërbimi. Me markë kuptojmë fjalën shenjën, simbolin, emrin ose formën e kombinimit e dy apo më shumë elementeve që për qëllim të identifikon ndërmarrjen, pronën industriale, produktin ose shërbimin e asaj ndërmarrjeje që dallohet nga ndërmarrjet dhe shërbimet e ndërmarrjeve tjera. Marka shërbehet me mjete të ndryshme që të kryej funksionin e vetë. Projektligji rregullon të drejtat dhe obligimet e shfrytëzuesve të markës tregtare të cilët mund ta shfrytëzojnë në tregti lidhur me llojin, kualitetin, vlerën, kohën, prodhimin apo shërbime të kryera dhe karakteristika tjera që karakterizohen mallrat apo shërbimet.

Përgëzoj Ministrinë për këtë ligj edhe pse ka të mirat dhe të metat, mirëpo grupi parlamentar i Aleancës do të jep kontributin e saj në komisionet përkatëse ku do të kaloj ky ligj. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Ju faleminderit. Teuta Sahatçija

## **TEUTA SAHATQIJA**

Faleminderit z. kryetar. Së pari dëshiroj që të gjithë besimtarëve mysliman t'u uroj fillimin e muajit të ramazanit, muaj i shenjtë për ta.

Ky projektligj duhet të plotësoj zbrazëtirën ligjore që ka të bëjë me përdorimin e markës tregtare si pronë intelektuale në vendin tonë. Si i tillë ky ligj është i mirëpritur për krijimin e bazë ligjore dhe për sigurimin e mbrojtjes adekuate për markat tregtare duke pasur parasysh se deri në fillimin e aplikimit të këtij ligji nuk ka pasur mbrojtje ligjore për përdorimin e markës tregtare dhe se prodhuesit e vërtetë kanë qenë të diskriminuar për përdorimin e prodhimeve të cilat i kanë keqpërdorur pa autorizim të markave të tyre tregtare. Rëndësia e këtij ligji gjithashtu konsiston në rritjen e mundësive të investimeve të huaja e cila gjë është një hap i rëndësishëm ka zhvillimi ekonomik i Kosovës, pasi investitorët e huaj potencial kanë mbrojtje ligjore për produktet e tyre. Në krahasim me ligjet tjera të cilit vinë në Kuvend, ky është një ligj voluminoz dhe i detajuar e cila gjë zvogëlon nevojën e plotësimit të më vonshëm me akte dhe urdhëresa administrative si dhe e bënë më të lehtë implementimin e tij në praktik dhe e zvogëlon mundësin e keqinterpretimit të ligjit. Është për t'u përshëndetur fakti që në këtë projektligj nuk kërkohet themelimi i Agjencionit special por kjo detyrë i besohet zyrës për patente edhe pse kohët e fundit është bërë praktik që për ç'do ligj të themelohet nga një agjencion. Duke analizuar deklaratën financiare krijohet përshtypja se numrat janë nxjerr pa ndonjë analizë me shifra tejet të rumbullaksuara nga 10 mijë euro ose siç thotë populli me tahmin. Në si grup parlamentar sidoqoftë e përkrahim miratimin në parim të këtij projektligji dhe kontributin tonë do ta japim gjatë punës së komisionit funksional.

Ju faleminderit!

## **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Tani e ftoj regjinë që të bëhet gati për të votuar me që nuk ka të paraqitur, po edhe ministri Dugolli urdhëroni.

## **BUJAR DUGOLLI**

Nuk e pata ndërmend të reagoj por më shtyri deklarimi pak ironik i përfaqësuesit të PDK-së se dihet që ministrat nuk shkruajn ligje dhe nuk ja përshtatin ata vetes, por te neni 54 ku flet për konventën e Parisit, Qeveria dhe ministratë janë të obliguara ta përcjellin çdo ndryshim që pason në aktet ndërkombëtare në bazë të të cilave janë hartuar edhe ligjet që i procedon Qeveria e Kosovës dhe në moment kur ka ndryshime të tilla Qeveria i implementon ato konform konventave ndërkombëtare dhe i fut në procedurat për ndryshim dhe kështu duhet të kuptohet ky nen e jo në atë mënyrë që e paraqiti z. nga PDK-ja.

## **BAJRUSH XHEMAJLI**

Këtu është e thënë shumë decidivisht për ate e lexova dhe u befasova se ministri nuk mund ta ndërroj ligjin dhe këtë duhet ta pranoj ministri se pa e prurë në Kuvend s'mund ta ndërroj e nëse mund ta ndërroj bravo i qoftë sepse ministrat tonë i bëjnë edhe këto, po këtu shkruan shumë mirë se ministri i ndërroi, a nëse i inicion atëherë mundet sikur edhe ne. Ju faleminderit.

## **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Të nderuar deputet, Projektligji për miniera dhe minerale është i sistemuar në 13 pjesë që paraqesin një tërësi koherente të normativave me qëllim të pasqyrimin adekuat të tërë kompozicionit të ligjit dhe qasjes më të lehtë, për mbajtjen e tij konkrete duke respektuar parimet themelore të metodologjisë legjislative dhe teknikës juridike për hartimin e ligjit. Projektligjin e përshkon fryma transparente e jo diskriminimit dhe konkurrencës. Projektligji përmban dispozitat që përkufizojnë: Qëllimin, fushëveprimin dhe përkufizimin themelor, autorizimet për kërkim si: Kërkesat, kriteret e dhënies, të drejtat dhe detyrimet e bartjes së lejes për kërkim, vazhdimin e lejes për kërkim, leje për ruajtjen e të drejtave, lejet për shfrytëzim, aktivitetet e veçanta xehtare si dhe aktivitetet në fushën e mineraleve. Përveç kësaj në Projektligj janë përcaktuar rentat xehtare, taksat dhe tarifat administrative që duhet të paguhet për ushtrimin e aktiviteteve minerale në Kosovë. Projektligji gjithashtu përmban dispozitat që i përkasin themelimit dhe funksionimit të zyrës së rregullatorit për miniera, dispozita mbi rolin dhe zgjerimi i Ministrisë së Energjetikës dhe minierave si dhe atë për themelimin e inspektoratit të minierave.

Të nderuar deputet, fuqizimi i këtij projektligji do t'i hap rrugë shfrytëzimit racional mineraleve të Kosovës, përmirësimit të gjendjes së përgjithshme sociale dhe zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të vendit tonë duke krijuar bazën e mirëfilltë ligjore për një konkurrencë të denjë të pjesëmarrësve në këtë fushë. Ky projektligj është në përputhshmëri të plotë me mandatin e Ministrisë së energjisë dhe minierave dhe nuk shkakton mbivendosje të kompetencave në këtë fushë, prandaj propozoj që në bazë të shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendi i Kosovës të nënshkruhet sa më shpejtë edhe nga përfaqësuesi special. Ju faleminderit.

## **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Ministër ju faleminderit.

Hapim debat në parim, Ibush Jonuzi në emër të LDK-së, kurse le të përgatitet Sala Bereisha – Shala në emër të PDK-së.

## **IBUSH JONUZI**

I nderuari z. kryetar i Parlamentit, kryesi e punës, ministra dhe deputet të nderuar dhe ju të pranishëm. Projektligji për miniera dhe minerale që sot e kemi në shqyrtim të parë do të duhej të ishte bërë shumë më herët. Arsyeja pse është vonuar është e qartë, nuk dua të flas për rëndësinë që e ka ky Projektligj sepse me vetë faktin që Kosova ka resurse të mëdha minerale, të atyre nëntokësore dhe sipërfaqësore, të metaleve dhe jometaleve, projektligji jo që është i rëndësishëm por i domosdoshëm që në kohë sa më të shpejtë të jetë në aplikim. Çdo ligj për fushën që e mbulon e ka rëndësinë e vetë por edhe njëherë po e potencoj se ligjet duhet të bëhen funksionale dhe të aplikueshme për secilën fushë dhe për fushën e mineraleve. Gjithashtu, po thuaj se në shumicën e Projektligjeve të hartuara ka gabime të shumta të cilat edhe në rastin konkret ia humbin kuptimin, kurse kur të shiqohen në aspektin profesional del se në shumë raste jo e paqartë por krejt pa kuptim. Çdo respekt për grupin punues që e ka hartuar këtë projektligj, por edhe gjatë punës së tyre janë bërë lëshime përmbajtësore. Tani projektligji po shqyrtohet në parim dhe grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar me kujdes dhe unë në emër të grupit parlamentar them shkurt se vërejtjet, sugjerimet dhe plotësimet të cilat mendoj se gjatë punës së mëtutjeshme mund të korrigjohen.

Ka vërejtje që duhet të korrigjohen pa dashur t'i komentoj tash. Llojet e lejeve dhe të pëlqimeve, leje duhet të ketë edhe për përdorim të mineraleve e jo vetëm siç është cekur në Projektligj. Pastaj neni 6 është i paqartë, duhet të shikohet mundësia e mos përzierjes së kompetencave të ministrave në mes veti në ato

raste kur nuk është e arsyeshme, pastaj te neni 17 zyra e rregullatorit të minierave. Në Projektligj thuhet se: Mund të hartoj dhe publikoj, por duhet thënë: Të hartoj dhe të publikoj. Te pjesa e tretë e projektligjit, Lejet për kërkim pika 21 nën (c) pasusi i fundit nuk është në rregull dhe duhet të bëhet korrigjimi i këtij pasusi. Pika 24.4 nën (a) shprehja “vrime” të mos përdoret sepse nuk është adekuate për kontestin, aty bëhen kërkime dhe shpuarjet janë të thellësive të ndryshme qofshin ato horizontale, vertikale apo të pjerrëta, prandaj çdo shprehje “hapen vrimat” duhet të thuhet: “Shpuarjet” apo “bëhen shpime të thella”. Neni 33 është i paqartë dhe lihet përshtypja se bëhen përzierje të kompetencave të paarsyeshme. Pika 34.1 është paraqitur gabim por në pikën (b) është e pakuptim ajo që thuhet në Projektligj. Nën (b) duhet të sqarohen se nuk prodhohen minerale por përpunohen e pastaj nën 2 (i) duhet të sqarohet pjesa e nëntë themelimi i zyrës së rregullatorit për miniera pika 58.7 si është e mundur të bëhet intervistimi i kandidatëve për bordin e zyrës së rregullatorit për miniera njëherë nga Qeveria e njëherë nga komisionet përkatëse të Kuvendit. Pika 58.8 thotë se: Të gjithë kandidatët që i janë propozuar Kuvendit duhet të plotësojnë minimumin e kushteve. Pyetja është- pse të jetë minimumi i plotësimit të kushteve, gjithashtu në të njëjtën pikë pasusi i parë, mendoj se nuk duhet të ekzistoj dhe nëse një forum ka 5 anëtar siç është bordi i zyrës së rregullatorit të minierave në Projektligj thuhet se mbledhja edhe me dy anëtar ka kuorum gjë që nuk është në rregull dhe mendoj se Projektligji duhet të ketë edhe: Pjesën ku parashihet forma dhe mënyra e hulumtimeve kërkimore, punimet e objekteve minerare për hulumtime, pjesën ku parashihet forma dhe mënyra e shfrytëzimit, respektivisht e eksploatimit të pasurive minerale, masat tekniko-teknologjike, pjesën ku parashihet përpunimi i lëndëve minerale, masat e sigurisë pa të cilat projektligji është i mangët dhe krejt në fund Projektligji është shumë i nevojshëm dhe në parim grupi parlamentar i LDK-së e mbështet por duhet që komisioni funksional të bëjë shumë punë të madhe për ta korrigjuar dhe plotësuar Projektligjin për miniera dhe minerale. Ju faleminderit.

## **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Ibush ju faleminderit, Sala Berisha dhe le të përgatitet Xhylnaze Syla

## **SALA BERISHA**

z. Kryetar, të nderuar deputet, anëtar të Qeverisë.

Dihet se Kosova ka pasuri shumë të rëndësishme minerare që shfrytëzimi racional i tyre paraqet një shfrytëzim potencial për zhvillimin ekonomik. Bazuar në këtë si dhe në fazën e kalimit të kompetencave nga ndërkombëtarët tek vendorët në fushën e gjeologjisë dhe minierave, rregullimi i kësaj lëmie me këtë ligj ka qenë një kërkesë imediate. Prandaj në emër të grupit parlamentar të PDK-së përshëndes nismën e Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave për hartimin e këtij Projektligji.

Pasi që nuk ishte një situatë e lehtë duke qenë në një situatë brenda hamendjeve për t’ju qasë një kompetence të rezervuar siç janë gjeologjia dhe minierat e cila fushë vazhdon të mbetet peng të neglizhencës së Qeverisë dhe mosgatishmërisë së UNMIK-ut për ta kaluar këtë kompetencë tek vendorët. Projektligjin në fjalë e përcjellin mangësi dhe dobësi të shumta edhe pse në shqim të parë duket mjaft voluminoz pasi që shumë nene përsëriten nëpër kapituj që kanë mund të rregullohen me një nen të veçantë. Të nderuar deputet, vetë titulli i këtij Projektligji nuk përkon me materien që rregullohet me të. Projektligji titullohet si Projektligj për miniera dhe minerare në realitet në asnjë nen të tij nuk trajtohet linja e minerareve, faktikisht këtu është fjala për një Projektligj që rregullon më tepër fushën e licencave për shfrytëzimin e pasurive minerare të Kosovës se këtu është fjala vetëm shfrytëzim të pasurive minerare, shihet edhe në memorandumun shpjegues ku thuhet se përcakton parimet themelore për shfrytëzimin e pasurive minerale të Kosovës. Mangësi e theksuar është se nuk trajtohet fare fusha e hulumtimeve gjeologjike që do të duhej t’i paraprinin problematikës së minierave, në kuadër të këtij

kapitulli do të duhej përfshirë p.sh hulumtimin e mineraleve të dobishme, hulumtimet regjionale gjeologjike, hulumtimet hidrogeologjike, hulumtimet gjeologjike, hulumtimet gjeologjike dhe mbrojtje të ambientit, formimin e një shërbimi gjeologjik të Kosovës etj. E metë tjetër e theksuar e natyrës së veçantë është mbrojtja e mjedisit që paraqitet këtu në mënyrë tepër të përgjithësuar e që do të duhej të kishte një definim të çartë ose të rregullohej me një kapitull të veçantë si mbrojtje e mjedisit nga ndotjet minerare. Mbrojtja e mjedisit është një kapitull i veçantë nga se nisemi nga të dhënat se të gjithë jemi dëshmitar të ndotjes nga hedhurinat në rajonin e Mitrovicës, Kastriotit etj. Jemi dëshmitar se lumi Sitnica është i ndotur nga hedhurinat, ndotja e ujit, ajrit dhe tokës, hedhurina me përmbajtje alarmante për shëndetin e njeriut me qindra hektar tokë në mes të Prishtinës dhe Kastriotit janë të mbuluara me djerrinë pluhur të termocentraleve. Andaj nëse Projektligji mbetet si i tillë investitorët nuk do të kenë obligim për pasojat e ndotjes gjatë shfrytëzimit. Dobësi të tilla paraqiten edhe në kapituj të tjerë p.sh te dispozitat e përgjithshme të neni 7. nuk janë të përcaktuara mirë, pastaj të neni 34. nga leja dhe detyrimet për shfrytëzim ku në mes tjerash thuhet se bartësi i lejes për shfrytëzim ka të drejtuar për të shitur ose bartur në mënyrë tjetër të drejtat ndaj minerareve të nxjerra, mendoj se këtë duhet rishikuar se a duhet t'i ipet kjo e drejtë bartësit të lejes apo jo. Pastaj neni 41. (c) të drejtat dhe detyrimet nga pëlqimi i veçantë edhe këtu duhet rishikuar mirë nën 45.1. etj.

Pjesa e 9. ku është e paraparë zyra e rregullatorit të minierave nuk janë të precizuara edhe aq kompetencat e kësaj zyre të rregullatorit të minierave. Në pjesën e 10. të këtij Projektligji ku përcaktohen dispozitat si rroli i Ministrisë të Energjetikës dhe Minierave, dispozitat mbi strategjinë e minierave mendojmë se edhe këtu ka pasur një mundësi që të plotësohet vakumi i linjës minerale, mendoj se në këtë kapitull mbetet e paqartë se cilat janë institucionet përkatëse për bashkëpunim.

Neni 70. i këtij kapitulli parasheh strategjinë e minierave. Lind pyetja- se si strategjia në mungesë të një komisioni profesionalo-shkencor siç është p.sh shërbimi gjeologjik në shumicën e shteteve evropiane, si do të bëhej kjo strategji e pa rregulluar me ligj pa e rregulluar me ligj hulumtimin gjeologjinë pasuritë minerare etj. Çdo qeveri në botë duhet të jetë mbrojtëse e një sektori të kores së tokës. Ky sektor në mënyrë më metaforike kuptohet si pasuri kombëtare, dihet se Kosova ka një trashëgimi të pasur gjeologjike sa i përket burimeve minerare, ujit dhe ambientit natyror ku të gjitha këto kanë ndikim të rëndësishëm pozitiv shoqëror dhe ekonomik, kështu që duhet menaxhuar në mënyrë shumë të përgjegjshme.

Të nderuar deputet, duke ditur se trashëgimia gjeologjike e Kosovës karakterizohet me këto fenomene siç janë: ..... këta faktorë t'i ketë parasysh gjatë planifikimit urban apo hapësinor. Menaxhimi i mirë i burimeve minerare përfshinë marrjen, përpilimin e gjerë shkencor sa i përket gjeologjisë, gjeofizikës, hidrogeologjisë pasurive minerare të Kosovës dhe definimin e burimeve minerare të cilat duhet të mbrohen për shfrytëzim nga brezat e ardhshëm. Përveç kësaj rroli i një shërbimi gjeologjik do të ishte këshillues për Qeverinë d.m.th do t'i ofronte shërbime këshilluese ekspertëve për çështjet që kanë të bëjnë me licencimin e kërkimeve dhe shfrytëzimit të minerareve.

Me që Projektligji është i rëndësishëm për shkak të arsyeve siç është kalimi i kompetencave tek vendorët në fushën e minierave dhe si shtyllë e rëndësishme jo vetëm ekonomike dhe arsyeve tjera që u përmendën më lartë grupi parlamentar i PDK-së e përkrah miratimin në parim të këtij Projektligji duke kontribuar më tutje në procesin e tij gjatë fazës së amendamentimit në komisionin funksional të cilin e pret një punë mjaft e madhe për ta sjellur Projektligjin në fjalë në nivelin e duhur. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**



Sala ju faleminderit, fjalën e ka Gjylnaze Syla, kurse le të përgatitet Teuta Sahatçiu

## **GJYLNAZE SYLA**

I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, deputet të nderuar.

Ringjallja ekonomike e sektorit të minierave ka rëndësi të madhe ekonomike, por edhe politike, sepse ndërton rëndësinë ekonomike, kurse pavarësia ekonomike është shtyllë e pavarësisë politike. Industria e Kosovës në të kaluarën ka qenë e mbështetur në dy sektor të cilët kanë siguruar zhvillimin ekonomik të Kosovës, sektori i minierave dhe energjisë, dy gjigant që kanë punuar në këta dy sektor Trepça dhe Elektrokosova kanë punuar me leverdi të madhe ekonomike. Kosova konsiderohet të jetë vendi me rezerva të mëdha minerare në Evropë të cilat janë të koncentruar në një hapësirë. Këto rezerva janë pasuri e Kosovës e cila duhet të shfrytëzohet ekonomikisht. Deri sa Kosova sot ballafaqohet me probleme të mëdha të zhvillimit ekonomik, riaktivizimi i këtyre dy sektorëve ka rëndësi jetike, që të dy konsiderohen strategjik dhe tërheqës për investime të huaja. Nga studimi i pavarur të cilin në media e ka prezantuar edhe ministri Qeku është konkluduar se këta dy sektor duhen të hapen për investime private. Projektligji mbi minierat dhe mineraret hap mundësinë e investimeve të mëdha në këtë sektor, përkujdeset që pasuria e Kosovës në këtë sektor në mënyrë racionale dhe në pajtueshmëri me standardet për mbrojtjen e ambientit dhe hap rrugë për zhvillimin e industrisë i cili me vite të tëra nuk ka funksionuar. Ne jemi dëshmitarë të një periudhe kohore kur në mënyrë të pakontrolluar eksportohen rezervat strategjike të Kosovës, kemi persona fizik dhe ndërmarrje të paautorizuara që nxjerrin xehe, minerale, gurë të çmuar etj pa licencë dhe pa kompensim për eksploatim ekonomik të Kosovës. Këtij eksploatimi duhet t'i jepet fund dhe ky ligj ofron edhe zgjidhjen e menjëhershme të këtij problemi. Në projektligj është paraparë licencimi i ndërmarrjeve për shfrytëzimin e pasurisë minerare të Kosovës. Licencimi është mekanizëm i cili duhet të mbështetet politikisht në mënyrë që vetëm personat e autorizuar të mund të bëjnë eksploatimin e minerareve të Kosovës. Ky licencim duhet të vlejë edhe për dy ndërmarrje të rëndësishme që është KEK-u dhe Trepça.

Në këtë mënyrë sigurohet kontrolli i pasurive strategjike në Kosovë dhe sigurohet qasja e barabartë dhe në pajtim me rregullat e ekonomisë së tregut për të gjithë pjesëmarrësit e interesuar për këtë sektor. Po ashtu është me rëndësi se me licencim është paraparë edhe licencimi për eksploatimin e mineraleve ndërtimore me që jemi dëshmitar gjithashtu të eksploatimit të pakontrolluar të zallit, gëlqeres, gurit, çimentos. Sa i përket kriterëve të licencimit të përcaktuara me këtë Projektligj janë adekuate me gjithë atë kemi një vërejtje në nenin 6b (ii) ku përjashton nga mundësia licencimin ata të cilët konsiderohen të papërshtatshëm, po citoj, nga një organizatë që ofron fonde zhvillimore. Është e arsyeshme që personat të cilët bëjnë veprime të paligjshme të jenë të përjashtuar nga kualifikimi për licencim dhe kjo është e paraparë me ligj, me gjithë atë veprimet e paligjshme duhet të vërtetohen nga organet e pavarura, pra nga gjykatat. Me që kredibiliteti financiar është përfshirë në Projektligj si kriter, vlerësimet e subjekteve tjera nuk mund të merren si bazë si kriter për përjashtim nga kualifikimi nga se ato vlerësime mund të jenë edhe subjektive, fakti dhe vlerësimi duhet të jetë relevant si kriter licencimi. Grupi parlamentar i AAK-së përgëzon Ministrinë për punën e bërë dhe konsideron se ky Projektligj është i një rëndësie të veçantë për ringjalljen ekonomike të Kosovës dhe e përkrahim në parim dhe ftojme deputetët që ta përkrahin miratimin e tij.

## **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Gjylnaze ju faleminderit, fjalën e ka Teuta Sahatçiu, kurse le të përgatitet Behxhet Brajshori.

## **TEUTA SAHATÇIU**

Ky projektligj duhet të zëvendësoj rregulloren e UNMIK-ut 2005/2 dhe 2005/3 e cila deri tani ka rregulluar sektorin e xehetarisë në afrimin e bazës ligjore të nevojshme për zhvillimin e këtij sektori në Kosovë. Ligji është voluminoz dhe i detajuar me që ka sigurinë juridike dhe zvogëlon mundësinë për keq interpretim të ligjit dhe nevojën që ligji të plotësohet më vonë. Edhe pse gjatë leximit haset në mjaft vende, në mjaft nene në të cilët do të duhej të intervenohej dhe të përmirësohej. Gjithashtu duhet t'i kushtohet edhe rëndësi dhe të shtohet pjesa që do të përmban masat mbrojtëse gjatë eksploatimit, e gjithashtu tekst i veçantë në mbrojtjen e ambientit nga ndotja. Shfrytëzimi i minierave dhe i mineraleve konsiderohet si një krah i fuqishëm i cili ka mundësi potenciale për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Së bashku me ligjet tjera si ai për investime të huaja, Ligji për koncesione etj, krijohet hapësira e nevojshme për joshjen e investitorëve.

Me gjithë atë është i paqartë statusi ligjor i rregullatorit për miniera dhe interaksioni i tij në ministrinë përkatëse. Gjithashtu duhet të qartësohet edhe statusi ligjor i inspektionit të minierave. Ne si grup parlamentar e përkrahim në parim këtë Projektligj dhe kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit gjatë punës së Komisionit funksional. Ju faleminderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Teuta ju faleminderit, fjalën e ka Behxhet Brajshori, kurse le të përgatitet Bajrush Xhemajli

### **BEHXHET BRAJSHORI**

I nderuari z. kryetar, ministra, të nderuar kolegë deputetë.

E çmoj si të rëndësishëm faktin e miratimit sa më të shpejtë të ligjit për miniera dhe minerale së paku për 2 arsye më qenësore. E para, Projektligji synon që të normoj dhe të sanksionoj një fushë të rëndësishme të aktiviteteve ekonomike e cila deri më tani ka qenë e pambuluar me ligj, siç janë aktivitetet në kërkimin, shfrytëzimin dhe në përpunimin e burimeve minerale në Kosovë dhe me që rast do të krijohet një disiplinë e kërkuar në shfrytëzimin e burimeve minerale dhe e dyta, në fazën e implementimit të tij, Ligji siguron një rritje të qëndrueshmërisë ekonomike dhe buxhetore në vend për çka edhe neve nuk na paraqet probleme në lidhje me implikimet buxhetore. Duke u nisur nga këto dy komponente qenësore. Projektligji është i pranueshëm në parim me gjithë këtë Projektligji në disa aspekte i nevojiten norma të qartësimeve më të përafërta me qëllim që ai të bëhet sa më i zbatueshëm. Ligji duhet të sanksionoj në mënyrë më të qartë se si do të rregullohet raporti në mes të pronarit ku gjendet burimi mineral dhe të paraqitjes së kërkesës për shfrytëzimin e burimit mineral, përkatësisht nëse marrëveshje nuk arrihet lidhur me këtë. Ky raport i ndërsjellë në mes të pronarit që disponon të drejtën pronësore të regjistruar në mënyrë të ligjshme mbi sipërfaqen tokësore dhe të paraqitësit të kërkesës që propozon ta shfrytëzoj gjatë kryerjes së aktiviteteve përkatëse shfrytëzuese. Të bëhet përpjekje që të rregullohet në bazë të nenit 32, 33 dhe 39.3 në përputhshmëri me ligjin mbi eksproprijimet, ligj të cilin Kuvendi i Kosovës duhet ta nxjerrë me urgjencë. Po ashtu ligji duhet saktësisht të sanksionoj në normë domosdoshmërinë e rehabilitimit të hapësirave sipërfaqësore ku shfrytëzohet burimi mineral nga ana e shfrytëzuesit të të drejtës sipërfaqësore me qëllim të ruajtjes dhe rikultivimit të ambientit jetësor. Me gjithë mangësitë që mund t'i ketë ligji që i thanë edhe parafolësit unë mendoj dhe marrë pëlqimin se ky Projektligj të miratohet në parim dhe natyrisht se në fazat tjera dhe procedurat parlamentare të begatohet. Ju faleminderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Ju faleminderit, fjalën e ka Bajrush Xhemajli, kurse le të përgatitet Qibrje Hoxha

## BAJRUSH XHEMAJLI

Një përshëndetje për të gjithë e në veçanti për z . Çeku.

Sa ju përket ligjeve në sferën e ekonomisë pa dyshim që është njëri ndër ligjet më të nevojshme dhe që rregullon një materie të ndërlikuar, prandaj e përshëndes shqyrtimin e këtij Projektligji edhe pse tepër të vonuar, por jo me fajin e ministrit apo të Ministrisë. Po e potencoj këtë sepse ky Projektligj e ka pasur një rrugë të gjatë deri sa ka mbërritur këtu dhe ka pasur pengesa prej më të ndryshmeve vetëm e vetëm që ndërkombëtarët t'i ruajnë kompetencat në duart e veta, kjo është sfera më e bunkerizuar e UNMIK-ut. Prandaj vetëm si arritje deri në shqyrtimin e parë është një sukses në vete. Unë me kaq po e përfundoj së lavdëruari. Marrë në tersi Projektligji ka një notë kaluese dhe prandaj unë e përkrahu në parim dhe i jap mbështetje për të shkuar në shqyrtimin e dytë. Ajo që më së shumti më intereson të dijë dhe që është vështirë të dihet se sa kompetentët e shtyllës së katërt janë të gatshëm ta pranojnë këtë Projektligj dhe së bashku me Komisionin e pavarur të minierave të pranojnë të zbatohet ky si ligj, d.m.th se sa krahas implementimit të ligjit do të lejohen kompetencat që të kalojnë nga ndërkombëtarët te vendorët, por nëse nuk e kanë ndërmend ta bëjnë këtë e kemi bërë kot Projektligjin apo na nevojitet për më vonë sepse as nuk do të mundemi ta zbatojmë dhe as të nënshkruhet fare nga BSSP-ja. Në këtë drejtim shumë indikative është mospjesëmarrja e përfaqësuesit të AKM-së në hartimin e Projektligjit, a thua që më vonë të kemi destruksione ashtu që projektligji të mos nënshkruhet dhe të ruhen kompetencat e rezervuara për çka besoj se shihet më vonë. Deklarata financiare se sa kushton implementimi i Projektligjit na jep edhe një argument në favor të aprovimit të Projektligjit në parim. Ajo që duhet diskutuar seriozisht në shqyrtimin e dytë është se ku duhet të vendoset organi rregullativ, pra a vihet në kuadër të neneve siç është parapar këtu apo në kuadër të Qeverisë që është organ i pavarur siç e kemi atë për energji dhe po ashtu duhet shikuar se a e ka vendin inspektorati i minierave në vendin ku është në nen apo duhet rregulluar ndryshe, duket qartë se ka shumë konflikte të kompetencave dhe e gjithë kjo materie është në kuadër të një Projektligji që është vështirë të mos pranohen të gjitha këto kompetenca në raport me rregullatorin në Inspektoriat, kam përshtypjen se Ministria ka dashur që t'i ruaj të gjitha kompetencat për vete, të veprimit dhe të kontrollit.

Këtu ka vërejtje parimore, por ka edhe konkrete. Neni 40 paragrafi (b) thuhet: Programi i aktiviteteve të veçanta është i bazuar në standardet Evropiane dhe ndërkombëtare. Kjo thënie e këtij paragrafi ka pasur vend në letrën shpjeguese po jo në tash të tregojmë se është me standarde me nen. Vetë kriteret për dhënien e lejeve duhet të paraqesin nivelin e standardeve ndërkombëtare e jo të figuroj e tërë ana deklarative. Ne po mundohemi që të përbelemi edhe në ligj që jemi me standardet evropiane, por mendoj se po bëhen disa gabime kështu, se aty ku nuk ka nevojë të përbelemi, gjë që nuk duhet bërë. Neni 46 nën (b), te ky nen janë kriteret e dhënies dhe nën (b) është një paragraf jo logjik: ZRM-ja e lëshon lejen në fjalë nëse kushtet janë të përmbushura. Thuhet nën a, b, c dhe d, e nën (d) thuhet: Kërkesa dhe Komuna janë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, kërkesa dhe komuna janë në pajtim me ligjin, sigurisht do të mund të jetë edhe ndonjë llapsus.

Neni 54.1 dhe neni 68 nuk ka nevojë që ligji të thirret në rregullore, sepse Ligji është më i lartë se rregullorja. Neni 54.1 thotë: Në bazë të nenit 11.2 të rregullores së UNMIK-ut 2001/9 themelohet organi rregullativ që njihet si zgjidhje për minierat. Unë mendoj që nuk rregullohet mbi bazën e rregullores, por themelohet mbi bazën e këtij ligji, tash në cilën të thirremi në rregullore apo në ligj, themelohet organi rregullativ që do zgjidh rregullat për miniera.

Po ashtu është edhe më vonë, se pa i kufizuar autorizimet dhe përgjegjësitë që i janë dhënë Ministrisë sipas shtojcës 8 të Rregullores 2005/15 Ministria etj. Thirrja në rregullore e Projektligje është i pa vend, sepse ligji është më i lartë se rregullorja. Ndoshta është frikuar Ministria se me këtë ligj po i merret ndonjë

kompetencë e ndonjë rregulloreje që i ka, s'më duket aspak funksionale. Strategjia e minierave është nevoja që me ligj të deklarohet, apo jo, për shkak se te energjia ka pasur vend sepse është memorandum i Athinës e tjera që kërkojnë një gjë të tillë. Ende nuk jemi liruar nga një terminologji e tejkaluar dhe në dy vende neni 19 dhe 79 që thirreni në ligje të aplikueshme, në vend që të thirreni në ligje në fuqi, thirreni në ligjin për konsesione që në mbledhjen e kaluar i thamë ligj i aplikueshëm, a në fakt është një ligj në fuqi, po nëse nuk është ai do të jetë një tjetër, kështu që jemi në një terminologji të kaluar.

Neni 19, përcaktimi i minerareve dhe zonave ku thuhet se: Leja për kërkim dhe shfrytëzim jepet në bazë të procedurave. Dua ta them një ngatërresë që është bërë në tërë ligjin sepse kjo më habit se po e shoh listën e atyre që e kanë hartuar ligjin dhe si kanë mundur ta bëjnë një ngatërresë të tillë, vazhdimisht minerare dhe minerale është ngatërruar, aty shpeshherë e kundërta ndodh, aty ku është dashur të thuhet minierar është thënë mineral, aty ku mineral është thënë minierar d.m.th përpunimi i një burimi mineral, burimi është minierar e jo mineral etj, këtu duhet shikuar sepse janë njerëz të profesionit. Ju faleminderit.

## **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Bajrush ju faleminderit, Ligjin që e kamë lexuar unë nuk ka askund paragraf (d) dhe profesorët nuk e kanë shkruar minierar dhe mineral por gjatë shtypjes është bërë, prandaj nuk janë këto gabime.

Qibrije Hoxha, kurse le të përgatitet Fatmir Rexhepi

## **QIBRIJE HOXHA**

Ju faleminderit z. kryetar.

Mendoj se Projektligji për minierat dhe mineralet është përpunuar mirë dhe e mbështes në parim. Me gjithat kam disa sugjerime për plotësimin e këtij Projektligji të rëndësishëm për pasuritë minerale të Kosovës.

Në nenin 6 pika (b) thuhet: Aplikuesi dhe asnjëri nga drejtuesit drejtorët ose pronarët e rëndësishëm të mos jenë të dënuar gjatë 10 viteve të kaluara. Unë mendoj se nëse mirret parasysh se para 10 vitesh një numër i madh i shqiptarëve kanë qenë të dënuar nga organet e dhunshme të serbëve, atëherë kjo pikë disi merret e paqartë

Neni 34, mendoj se përpunimi i mineraleve të nxjerra nuk i është dhënë rëndësi e duhur në këtë Projektligj dhe nocioni "përpunimi i mineraleve të nxjerra" përmendet së pari në pikën 36.1 b dhe mendoj se eksploatimi i mineraleve nga minierat në afërsi të minierave nuk do të kishte leverdi ekonomike as kuptim pa përpunimin e tyre. Duke marrë parasysh që përpunimi i mineraleve të nxjerra është proces fiziko-kimik mjaft i ndërlikuar mendoj se duhet t'i ipet më shumë hapësirë në këtë Projektligj, nuk duhet të lihen anash edhe agjendët e shumtë që përdoren në këtë proces të ndërlikuar, po i numëroj vetëm disa: Cianidi i natriumit që është komponim i helmueshëm si për njeriun po ashtu edhe për ambientin, Acidi sulfurik 98% i koncentruar dhe prandaj përdorimi i tyre duhet të rregullohet me ligj. Kam përshtypjen që ligji është hartuar nga njerëz me njohuri për minierat dhe jo nga ata me njohuri të përpunimit të mineraleve të nxjerra, këto janë dy gjëra të ndryshme. Në të njëjtat nene pika 36.1 d dhe 34.4. vetëm shkurtazi përmendet fjala "deponim" dhe vetëm si alternativ e hudhjes çka nuk përkon me realitetin sepse deponimi i mbeturinave ose i sterilit pas përpunimit të mineraleve të nxjerra është po ashtu një proces shumë i rëndësishëm dhe shumë i ndërlikuar. Mos të harrojmë se në digat e ngritura nga mbeturinat ka raste kur kanë shpërthye dhe është rrezikuar jeta e njerëzve, shtazëve e po ashtu janë shkatërruar hapësira të tokave pjellore, raste të këtilla ka pasur shumë herë në bot dhe si te ne në Kosovë në të kaluarën ashtu edhe në

shtetet e ndryshme perendimore që kanë përvojë të madhe në këtë drejtim si është Spanja para disa vitesh, Suedia në vitin 2000 etj. Ju faleminderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Ju faleminderit dhe Fatmir Rexhepi i fundit

### **FATMIR REXHEPI**

Projektligji për minierat dhe mineralet synon rregullimin adekuat ligjor të të gjitha aktiviteteve në sektorin e minierave dhe mineraleve duke përcaktuar parimet themelore për shfrytëzimin dhe valorizimin e tyre. Si në çdo vend tjetër po ashtu edhe për Kosovën rëndësia e këtij ligji është e madhe, sepse nga momenti i aprovimit dhe implementimit të tij ai do të vihet në funksion të nxitjes së investimeve si dhe të zhvillimit ekonomik të vendit. Duke lexuar me vëmendje përmbajtjen normative nga 13 kapituj të këtij Projektligji unë do të veçoj tri vërejtje për vlerësim në parim. Nën një, parimin e shfrytëzimit racional të resurseve të minierave dhe mineraleve nëse ligji në mënyrë të mjaftueshme e rregullon me aspektet shoqërore dhe ato të zhvillimit ekonomik këtu dilema ime është tek marrëveshjet për investime në sektorin e xehetarisë dhe sidomos është për t'u vlerësuar më mirë si dhe sa është siguruar mbrojtja e interesit të përgjithshëm publik në raport me interesin afarist të investitorit.

Nën dy, çështja e kompetencave në mes institucioneve vendimmarrëse vendore dhe të UNMIK-ut. Nga fusha e ekonomisë tek zgjidhjet e parashtruara, vërejtja dhe dilema se si ato të ndryshohen për të reflektuar me përgjegjësi konkrete në krijimin dhe zbatimin e politikave dhe të strategjisë në mbrojtjen e interesit të theksuar gjatë implementimit të tij dhe nën tre, nevoja për të vlerësuar më mirë dhe ndryshuar dispozitat lidhur me rregullatorin për minierat si organ i pavarur në raport me institucionet tjera vendimmarrëse si dhe statusin e inspektoratit të minierave. Përkundër dallimeve dhe interesit të shfaqur, me menagjimin e këtyre pasurive përmes një rregulloreje që ekziston tani dhe vonesa e paarsyeshme dhe shumë e madhe e këtij Projektligji, unë e përkrahi në parim me bindjen se çështjet e diskutuara do të sqortohen gjatë procedimit të mëtutjeshëm me ekspert të fushave përkatëse, po ashtu mendimi im se këto ndryshime nuk do të jenë të lehta, por me gjithë ato të angazhohemi që të mos kemi mosmarrëveshje lidhur me marrëveshjen ekzistuese, përfaqësuesve të shtyllës së katërt dhe problemeve që na kanë dalur shpeshherë në këtë fushë. Ju faleminderit.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Ju faleminderit. Nekibe Kelmendi ka diçka për fund, urdhëroni.

### **NEKIBE KELMENDI**

Deputetja Qibrije Hoxha pati të drejtë kur foli diçka për denimet që tha se është afati i gjatë, por në këtë kontekst kamë edhe një vërejtje tjetër, duhet të dihet se cili denim paraqet ndalim për me marrë licencën, sepse dihen se p.sh denimet për aksident trafiku janë vepra të rastit dhe nuk mundet me ju ndalu, por duhet të precizohet se për cilat vepra se nëse dikush është i gjykuar nuk mund t'i jepet licenca.

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI**

Lus regjin që të përgatitet për votim, e dëgjuam debatin dhe ju ftoj që ta përkrahim në parim Projektligjin e debatuar, dhe votojmë tani.

75 deputet janë për, prandaj konsideroj se ligji është aprovuar nga seanca, pas këtij miratimi në parimi Komisionet që duhet ta shqyrtojnë këtë Projektligj janë Komisioni për Ekonomi, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion si komision funksional dhe referues, Komisioni për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për Komunitete.

**Me që një pjesë e përmbajtjes së programit, pjesa funksionale është përfunduar ne propozojmë një pauzë 30 minutash.**

Vazhdimi i seancës pas pauzës.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Pika vijuese e rendit të ditës është:

### **Shqyrtimi i projekt Strategjisë për energjinë në Kosovë 2005-2015**

Qeveria e Kosovës e ka miratuar projekt Strategjinë e Kosovës për periudhën 2005-2015 dhe i propozon Kuvendit që ta shqyrtoj në seancë plenare.

Dokumenti u është shpërndarë deputetëve në kohë më 18 gusht 2005. Projektstrategjia e energjisë së Kosovës 2005-2015 është shqyrtuar në Komisionin funksional për Tregëti dhe Industri dhe i njëjti i rekomandon Kryesisë që ta radhitë për shqyrtim në seancë plenare. Ftohet ministri Ethem Qeku që në emër të Ministrisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantoj këtë Projektligj.

**ETHEM QEKU**

I nderuari Z. Kryetar i Kuvendit; E nderuara Kryesi e Kuvendit; Te nderuar Deputete.

*Kam nderin që në emër të Qeverisë dhe të Ministrisë së Energjisë dhe e Minierave(MEM) t'ia paraqes për miratim Kuvendit të Kosovës - Strategjinë e Energjisë të Kosovës.*

*Kam kenaqesi që në emër të Qeverisë dhe të MEM t'i falenderoj të gjitha institucionet dhe ekspertët vendor e nderkombetar që me mbështetijen financiare dhe dijen e tyre mundesuan që ne sot të kemi një Strategji të energjise të Kosovës.*

Strategjia e Energjisë e Kosovës është hartuar në përputhshmëri me Ligjin e Energjisë dhe me Programin e Qeverisë së Kosovës dhe përbën kornizën themelore në bazë të të cilës pas aprovimit nga Kuvendi i Kosovës përcakton objektivat dhe prioritetet zhvillimore sipas sektorëve të energjisë.

Hartimi i Strategjisë mbështetur në këtë bazë juridike dhe në këto studime:

- Ligjin per Energjine 2004/8
- Ligjin per Rregullatorin e Energjise 2004/9
- Ligjin per Energji Elektrike 2004/10
- Rregulloren per miniera dhe minerale 2005/3
- Ligjin per mbrojtjen e Ambientit 2003/9
- Marreveshjen per Komunitetin e Energjise; si dhe ne keto studime:

- *ESTAP I ; II; III dhe GIS (General Investment Study) te financuara nga Banka Boterore Studimet e financiar nga EAR, BKK, USAID, etj.*

Ligji për Energjinë përcakton që Ministria e Energjisë dhe e Minierave (MEM) duhet të përpilojë dhe propozojë Strategjinë e Energjisë , që mbulon periudhën 10 - vjeçare. Obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Kosova janë pjesë integrale e Strategjisë së Energjisë.

Organet e tjera të qeverisë, siç janë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave kanë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e përgjegjësive sociale, ekonomike dhe mjedisore të energjetikes të Kosovës.

Strategjia e Energjisë është e orientuar kah Koncepti i TREGUT. Prandaj , i repektohen dy parimet kryesore, e qe janë:

- a. Demonopolizimi i infrastruktures energjetike -Korporatizimi i KEK-ut, dhe b. Tregun e hapur për të gjithë pjesëmarrësit.*

Ku qëndron rëndësia e sektorit të energjisë për zhvillimin ekonomik të Kosovës?

Rëndësia e sektorit të energjisë për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës duhet të shikohet në dy aspekte :

(a) në funksion të krijimit të infrastrukturës së energjisë për zhvillim dinamik, ekonomik dhe social duke ruajtur mjedisin dhe

(b) pesha që kanë resurset e konsiderueshme të energjisë primare, veçanërisht lignitit dhe shfrytëzimi racional i tij, në kontekstin e strategjisë së gjithmbarshme të zhvillimit të Kosovës. Zhvillimi i sektorit të energjisë dhe shfrytëzimi i saj racional krijon parakushtet për rritjen e ekonomike si dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe nivelit të jetesës. Nga ana tjetër dinamika dhe cilësia e këtij zhvillimi ndikojnë në rritjen e kërkesës për energji.

Te nderuar deputete,

Vizioni i Strategjisë të Energjisë të Kosovës (SEK -ut) është qe Sektori I energjetikes të jete:

- Teknologjikisht i avancuar;
- Financiarisht i qëndrueshem;
- Pjesë e sistemit rajonal dhe evropian të energjisë dhe
- Kontribues dhe jo shfrytëzues i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK).

*Sektori i energjisë i Kosovës të jetë teknologjikisht i avancuar dhe financiarisht i qëndrueshëm dhe të bëhet pjesë e sistemit rajonal dhe evropian të energjisë. Ai brenda kësaj periudhe transformohet dhe zhvillohet nga një sektor që varet nga mjetet buxhetore dhe subvencionet në një sektor që do t'i kontribuojë buxhetit të qëndrueshëm të Kosovës, nga një sektor importues i energjisë elektrike në eksportues të rëndësishëm .*

Misioni i Staregjise (SEK -ut) - është promovimi i shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshem të resurve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik, mbrojtjes të mjedisit dhe të sigurimit të mireqenjes sociale të Kosovës.

Cilat janë objektivat strategjike të SEK-ut?

Duke u bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese, kërkesës për energji, analizës SWOT vizionit dhe misionit - objektivat strategjike të zhvillimit të energjisë në periudhën 2005-2015 janë:

Brenda kësaj periudhe të disponohet me kapacitete të prodhimit të energjisë elektrike prej së paku rreth 1800 MW, për AF siguruar furnizimin e qëndrueshëm të konsumatorëve në Kosovë dhe për të eksportuar 30-50% të energjisë së prodhuar.

Përmirësimi i ekonomisë së sektorit, nëpërmjet përfundimit të ristrukturimit dhe reformimit të KEK-ut dhe rritjes së aftësisë së tij konkurruese, duke siguruar arkëtim të plotë AU energjisë elektrike të faturuar deri më 2009.

Modernizimi i rrjetit të bartjes dhe të shpërndarjes duke siguruar integrimin e tyre me rrjetin rajonal dhe evropian AF energjisë dhe duke reduktuar humbjet teknike në nivel të standardeve ndërkombëtare deri me 2010-2012.

Rritja e efijencës në sigurimin burimeve të nevojshme financiare dhe menaxhimin efikas investimeve me theks të veçantë në sigurimin e kushteve më joshëse për investime të jashtme, të cilat duhet të marrin pjesë me mbi 60% në financimin e investimeve AF gjithmbarshme të këtij sektori.

Deri në fund të 2012 qendrat rajonale të Kosovës të bëhen me sistem të ngrohjes qendrore dhe Kosova të lidhet me gazsjellës rajonal,

Sanimi i pasojave të krijuara në mjedisin përreth TC deri në 2010 si dhe zbatimi i përpiktë i normave dhe standardeve të larta të mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë duke synuar arritjen e detyrimeve nga marrëveshja e KYOTO-s.

Rritja e vetëdijes mbi dobitë e përdorimit racional të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve alternative të energjisë

Ngritja e ndjeshme e kapaciteteve vendore për hulumtim dhe zhvillim dhe zbatimi i teknologjive të avancuara e të menaxhimit modern brenda institucioneve dhe ndërmarrjeve publike të energjisë.

Një vend të vecantë në kuadër të Strategjisë ka - Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për investitorë privatë strategjikë - IJD - dhe hapja e mundësive të lidhjes së aranzhmaneve kreditore me institucionet financiare ndërkombëtare ( IFN/ IFI ). Për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për investime me rëndësi primare janë përmirësimet e mëtejme në krijimin e :

- Situatës së qartë politike - statusi politik; kornizës legale dhe mjedisit institucional;
- situatës së përgjithshme të sigurisë dhe shtetit ligjor; pronësisë së qartë ndaj aseteve ;
- aktiviteteve promovuese.

Kosova me resurset e disponueshme energjetike, ka parakushte reale të bëhet faktor i rëndësishëm dhe aktiv në tregun regional të energjisë. Zhvillimi ekonomik i Kosovës do të varet jo vetëm nga posedimi i resurseve por edhe nga shfrytëzimi dhe menaxhimi efikas i tyre.

Te nderuar deputet,

Miratimi i Strategjisë për zhvillimin e energjisë së Kosovës - do të mundesoje një menaxhim efikas të burimeve ekzistuese energjetike dhe një zhvillim të burimeve të reja. Ajo përcakton politikat dhe masat për të shfrytëzuar burimet energjetike në dobi të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale, duke siguruar ruajtjen e mjedisit sipas standardeve të pranuar ndërkombëtare.

*Me shprehje se strategjia do të perkrahët dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës - Ju pershendes e ju falenderoj për vemendjen.*

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. kryeministër, hapim debatin për këtë pikë të rendit të ditës, kurse për fjalë është paraqitur Fatmir Rexhepi, kurse le të përgatitet në emër të PDK-së Bajrush Xhemajli.



Unë para se të përfundoj diskutimin po ju njoftoj se shkresa e dërguar në emër tim si kryetar i Komisionit nga z. Viker shef i shtyllës së katërt është që t'ju njoftoj se shtylla e katërt e mbështet në princip strategjinë, por për specifika të caktuara energjetike gjatë implementimit të tij do të ketë mundësi që të ketë diskutime edhe për ndonjë çështje që e vlerëson se është me interes.

Lidhur me implementimin dhe rekomandimi jonë lidhur me punën për menagjmentin në KEK që ka të bëjë me ESBlA-in i cili ka kontratë të caktuar, pse nuk duhet t'i vazhdohet kontrata, janë dobësi të mëdha me këta tregues që do t'i përmendi para Parlamentit të Kosovës, jo që është hera e parë në kemi debatuar për këtë sferë, por mendoj se është mesazhi i fundit që ne ta qojmë mesazhin tonë dhe kërkesën tonë, që të mund të implementohen këto politika duhet që të kemi parasysh këto vërejtje. Krahasuar me vitin paraprak 03, 04 dhe 04, 05 pra një vit është ardhur deri te zvogëlimi i prodhimit të thëngjillit për 300.000 tonë gjatë kësaj periudhe, kemi z vogëlimin e prodhimit të energjisë elektrike në termocentralët e Kosovës "A" për 800 orë megavat energji, për kundër investimeve nga AER-i që shpesh përmenden me qindra miliona euro si dhe subvencionimit nga buxheti i Kosovës po ashtu me qindra miliona që i ka dhënë Qeveria e Kosovës në mandatin e kaluar, por edhe në këtë mandat. Rritja dhe ulja e përgjithshme vetëm për këtë vit është për +4%, kemi z vogëlimin e inkasimit të mjeteve për 1.3%, ndërsa rriten borxhet ndaj KEK-ut për 50 milion euro, a nuk janë këto argumente të mjaftueshme që ky agjencion të mos e vazhdoj punën ma, prandaj me probleme të vazhdueshme të kësaj natyre nuk mundet të kemi as zhvillim të ekonomisë, nuk mund t'i ngarkojmë ma ata qytetarë të cilët e paguajnë rrymën e ata që nuk e paguajnë të vazhdohet me kontinuitet pa marrë masa, prandaj si përfundim jam në përkrahje të strategjisë së bashku me vlersimet që i dhamë si dhe politikave dhe programin që e ka ofruar Ministria e Energjetikës dhe minierave, por edhe njëherë po kërkoj që nga 1 janari menaxhmenti i tanishëm që e ka marrë me e udhëheqë KEK-un të mos i vazhdohet kontrata. Ju faleminderit.

#### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli, kurse le të përgatitet deputeti Gazmend Muhaxheri.

#### **BAJRUSH XHEMAJLI**

Faleminderit z. kryesues.

Që në fillimi dua të them se është për t'u përshëndetur përpjekja e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave për ta hartuar strategjinë për energji sepse me këtë do të plotësohej në rend të parë një obligim i rëndësishëm që ka kjo Ministri dhe në anën tjetër do të plotësoheshin kërkesat që dalin nga ligji për energjinë dhe memorandumit i Athinës për të pasur një strategji. Por këtu duhet shtruar një çështje thelbësore se kjo përpjekje a është e suksesshme apo më mirë të themi se sa ia ka arritur Ministria që këtë dokument ta bëjë një strategji vërtetë të dobishme funksionale dhe të zbatueshme. Grupi parlamentar i PDK-së kemi vërejtje shumë serioze dhe substanciale aq sa mendojmë se nuk ka mundësi që të implementohet në mënyrën se si thuhet në këtë dokument dhe në disa segmente do të jetë shumë e dëmshme po të implementohej. Në mënyrën se si është shtruar kjo materie dhe në mungesën e shumë parametrevë që nevojiten më shumë do të mund ta quanim dokumentin një politikë orientuese për energji se sa ta quajmë strategji. Për kaq kohë sa kamë në dispozicion do të mundohem të jap disa vërejtje më qenësore në mënyrë që hartuesi i këtij dokumenti të ketë mundësi t'i merr parasysh.

Dihet se që nga viti 1981 nuk është bërë ndonjë regjistrim i popullsisë në Kosovë dhe parametri shumë i rëndësishëm i përmendur edhe aty ai i numrit të banorëve nuk dihet e rrjedhimisht nuk mund të përcaktohen as të ardhurat për kokë banori d.m.th shkalla aktuale dhe parashikuar e prodhimit shoqëror,

pra parametri ekonomik real i mungon, pastaj mungon analiza mbi bazën e një statistike konkrete të tendencave të zhvillimit të sektorit të energjisë në vendet rreth Kosovës etj. Një ndër premisat më të gabuara të këtij dokumenti pa dyshim është se niset mbi bazat e rezervave 12 miliardëshe të qymyrit. Kamë konsultuar shumë ekspert dhe ata thonë se nuk bën të mbillen iluzione të tilla, kur dihen se rezervat e qymyrit që mund të eksploatohen janë 5 e më së shumti 6 miliard tonelata, me këtë nuk dua të them se 6 miliard nuk na mjaftojnë, por kjo tregon se strategjia nuk është paguar nga parametrat që i japin studimet vendore, por nisemi nga të dhënat që na janë seruar nga Beogradi shumë vite ndoshta edhe dekadë më parë si të tilla për çështje politike duke glorifikuar rezervat në mënyrë që të ketë trysni më të lehtë për të bindur vendorët për të prodhuar për nevojat e ish Jugosllavisë, kurse tani të njëjtat teza lansohen prej Beogradi përveç se na vijnë përmes UNMIK-ut dhe strategjisë që kemi përpara, kjo strategji është punuar nga ndërkombëtarët që në realitet është letra e bardhë e UNMIK-ut dhe tani me disa modifikime është promovuar si strategji e MEM-it. Prej kur insistohej që Kosova të eksportoj sa më shumë energji në viset tjera të Jugosllavisë e tani me këtë strategji insistohet që të bëhemi fuqi e madhe prodhuese për të eksportuar për regjionin dhe atë deri në 50% mbi plotësimin e nevojave të vendit, pra strategjia është punuar në orientimin e strategjisë për eksport dhe jo sa për të mbuluar nevojat e brendshme të ekonomisë Kosovare kjo ka ndodhur se ky nuk është projekt i ekspertëve vendor dhe si i tillë tenton që Kosova të jetë prodhuesi në regjion e që pashmangshëm ka pasojat veta e ndër të tjera prishet rebalanca ekologjike, në asnjë mënyrë mendojmë që nuk do të duhej që prodhimi për eksport të ishte më i madh se 15% realisht, më parë do të duhej një strategji e përgjithshme ekonomike e vendit në mënyrë që të dihej edhe vendi i energjisë në strategjinë e përgjithshme, të dihet se cili është vendi i energjisë në zhvillimin ekonomik dhe sa do të rritej bruto produkti si rezultat i realizimit të strategjisë për energji. Këtu nuk ka ndonjë parametër përpos asaj që thuhet që do të ndikoj në fuqizimin ekonomik. Ky dokument nuk ka mbështetje ligjore sidomos mungon korniza e duhur ligjore në përcaktimin e zonave të interesit nacional dhe projektit për eksproprijim i cili do të nevojitej në veçanti tani për hapjen e minierës së Sibovcit,

Në faqen 25 flitet për procesin e ristrukturimit të KEK-ut me qëllim të tejkalimit të situatës aktuale të sektorit të energjisë. Kjo situatë nuk do të mund të tejkalohet pa e qartësuar shumë çështje të cilat kanë të bëjnë me KEK-un dhe pa shtruar çështjen e fenomeneve kriminale dhe korruptive që e kanë shoqëruar udhëheqjen e KEK-ut ka aty ende shumë trashler ndërkombëtar e shqiptar, andaj pa spastrimin e këtyre çështjeve nuk mund të pretendohet të zgjidhet as problemi i inkasimit.

Lidhur me veprimet strategjike të periudhës afatshkurtër faqe 25 flitet për forcimin e menaxhmentit strategjik të KEK-ut po në të njëjtën faqe flitet për shtruarjen e plotë të KEK-ut brenda kësaj periudhe kohore kjo kontradiktë vjen në situatë konfuze. Në pikëpamje gjuhësore ka të meta të mëdha, ky nivel gjuhësor flet se dokumenti është frytë i një pune qoftë profesionale, qoftë i ngutisë duket një metodë eklektike e punës dhe një përkthim i keq, për çka tregon më së miri fakti se disa tabela janë ngatërruar, tjetër gjë thuhet në tabelë e tjetër përfundi tabelës e disa prej tyre nuk janë përkthyer fare nga anglishtja. Plani i implementimit të kësaj strategjie sigurisht që do të jetë problemi më i madh dhe më kontraverz që ka nuk do të mund të jetë i suksesshëm, çështja e mungesës së kompetencave, vazhdimi i kontratës së HSB-së për të cilën foli edhe kolegu Fatmir Rexhepi me të drejtë tregon se sa i dobët është karshi UNMIK-ut dhe i AKM-së edhe pse u konstatua se ka dështuar plotësisht dhe asnjë parametër nuk e ka përmbushur sipas kontratës HSB-së ju vazhdua kontrata, unë e di zoti ministër që MEM-i nuk mund ta ndalë nënshkrimin e kësaj kontrate ose vazhdimin të kontratës, por MEM-i së paku ka mundur të mos e jap pëlqimin dhe vërtet në asnjë mënyrë nuk ka qenë dashur të jepet pëlqimi. Unë ju falënderoj për konsultën që keni bërë me mua dhe kryetarin e komisionit dhe ne kemi dhënë mendimin tonë por vërtetë kjo nuk ka qenë dashur të ndodh, edhe vetë thonë se nuk ke ka përmbushur asnjë parametër të kontratës dhe prapë t'i vazhdohet pse, me këtë pavendosmëri të ministrisë nuk mund të implementohet as kjo strategji dhe asnjë strategji tjetër, strategjitë bëhen për t'u zbatuar e jo për të thënë se bëjnë strategji besoj

se pajtoheni të gjithë. Të nderuar kolegë deputet, i nderuari z. ministër përkrahja e Kuvendit të cilin edhe e kërkon sot ka qen e veçantë për të krijuar klimën e përshtatshme për zhvillimin e energjetikës, në veçanti komisioni funksional si në mandatin e kaluar po ashtu edhe në këtë mandat ka bërë çmos që të krijoj një klimë më të mirë, një kornizë ligjore më të favorshme me që rast ne si komision dihet se jemi hartues të 5 projektligjeve që kanë të bëjnë direkt edhe me funksionalizimin e kësaj strategjie siç është ligji për energjinë, për rregullatorin e energjisë, për energjinë elektrike, për ngrohjen dhe koncesionet, prandaj në këtë kontekst ju z. ministër e keni përkrahjen, por sa i përket asaj se a keni përkrahjen që e kërkuat për dokument tani për strategjinë është një çështje tjetër. Ne i kemi dhënë vërejtjet tona në komision tha edhe kolegu, disa u dhanë edhe këtu kur e kemi shqyrtuar e edhe tani u munduam që t'i japim disa segmente tash është çështje e juaj se a i merrni për bazë apo jo natyrisht, ne nuk mendojmë se kjo strategji mund të realizohet por si grup parlamentar i PDK-së nuk e kemi ndërmend që ta refuzojmë e as ta votojmë sepse nuk mendoj se duhet të votojmë pa ditur se a do të ndërroni diçka dhe sa do të ndryshoni nga vërejtjet të cilat i kemi dhënë jo vetëm nga ky Kuvend por edhe të ekspertëve tjerë jashtë Kuvendit, por edhe vërejtje shumë substanciale të partisë së të gjelbërve që mua më kanë bërë një përshtypje të mirë, tek pastaj ne do të gjykonim se a keni ndryshuar mënyrën, strategjinë apo jo dhe do të vendosim për të votuar këtu në Kuvend, në të kundërtën siç është sot në qoftë se votohet ne si grup parlamentar nuk do të votojmë, për ndryshe edhe kështu ju dëshirojmë suksese nëse arrini ne sigurisht që do t'ju gëzoheshim atyre sukseseve.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Fjalën e ka Gazmend Muhaxheri në emër të grupit parlamentar "Ora" , kurse le të përgatitet deputeti Mazllum Kumnova.

### **GAZMEND MUHAXHERI**

Ju faleminderit z. kryesues. Të nderuar z. ministra Çeku dhe Shatri, të nderuar deputet, Investimet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës në 3 vitet e fundit në KEK kapin shumë rreth 250 milion euro. Rezultatet e këtyre investimeve qytetarët e Kosovës nuk i gëzojnë ose lirisht mund të themi se janë zero. Humbjet e panevojshme buxhetore të cilat kanë mundur të përdoren në mënyrë më të mirë duke investuar në arsim do të zgjidhnin problemin e infrastrukturës ose do të bëhej ngritja e pagave të arsimtarëve. Duke investuar në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme këto mjete do të ishin ende në qarkullim, në këtë mënyrë si janë investuar këto mjete janë djegur që mundemi me thanë lirisht në furrëllartat e Kosovës "A" dhe Kosovës "B". Në strategjinë e energjisë së Kosovës parashihet se blloqet e Kosovës "A" do t'u shiten investitorëve privat deri në vitin 2006 duke marrë parasysh shkallën e inkasimit të energjisë elektrike të shpenzuar e cila momentalisht është në kufijtë 32 deri 35% shtrohet pyetja se cili investitor do të investoj në këto rrethana, mendja e shëndosh dhe logjika ekonomike e thotë se asnjë investitor, pos nëse donë të bëj shpëlarje të parave. A do të kushtëzohet investimin koncesional investitori i mundshëm me lejimin e eksportit të rrymës , çdo të ndodh atëherë me shërbimin publik të detyruar që kërkohet me ligj, po objektivi i furnizimit me energji elektrike ku do të mbetet, sepse strategjia e ka objektivi furnizimin e 24 orësh qytetarëve me energji elektrike. Me kapacitetet ekzistuese Kosova mbulon 80% të konsumit, por nëse i shesim blloqet e Termocentralit "A" a do të importojmë rrymë edhe nëse sa do ta paguajmë importin e kësaj rryme. Prej çfarë burimesh do të furnizohen këto blloqe me thëngjill, ose kush do ta paguaj dislokimin e Hadës, Sibovcit dhe ku do të gjinden burimet financiare për dislokimin e tyre, ndërsa ministri i financave z. Shatri do t'i siguroj këto mjete, por ky Kuvend duhet me ditë se ku do të sigurohen këto para dhe sa do t'i kushtoj buxhetit të ardhshëm të Kosovës ky dislokim i këtyre fshatrave dhe si do të kthehen mjetet e investuara buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Ky Kuvend do të duhej të dijë edhe të marrë përgjegjësinë që këto investime që do të bëhen mos të përfundojnë dhe

mos ta kenë fatin e 250 milionëve të investuara në 3 vitet e kaluara. Me strategji parashihet që menjëherë të krijohet operatori i sistemit të bartjes dhe tregut të energjisë, kush do të investoj në këtë, sa do t'i kushtoj Kosovës dhe cilat janë përfitimet e krijimit të menjëhershëm të këtij operatori. Strategjia parasheh formimin e kompanive të furnizimit private ose të ndara, d.m.th pilot siç i ka quajtur në vitin 2005-2006. Si mendohet të formohet një pilot kompani kur kemi shkallën e inkasimit 32 – 35%. A mos është kjo mundësi apo justifikim për legjitimimin e Elektrokosmetit në Mitrovic i cili momentalisht punon jashtë kontrollit të KEK-ut dhe është i pa penguar në funksionimin e tij. Ju faleminderit.

#### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputeti Mazllum Kumnova, kurse le të përgatitet deputeti Gani Koci

#### **MAZLLUM KUMNOVA**

Grupi i AAK-së e ka pasur në dorë strategjinë e propozuar nga kjo Ministri dhe e përgëzon këtë ministri për përpjekje të strukturimit dhe të qasjes për ecurinë më afatgjate të planifikuar dhe për këtë sektor të ekonomisë me rëndësi të veçantë. Strategjia e ofruar në mbështetje të strukturës ligjore ekzistuese, studimeve dhe dokumenteve që i referohen kësaj veprimtarie. Gjatë zbatimit të kësaj strategjie mund të bëhen përmirësime, ndryshime dhe prioritete sipas zhvillimeve ekonomike në Kosovë, si grup e përkrahim në tërësi këtë strategji duke e klasifikuar si synim për një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomike të Kosovës dhe presim nga kjo ministri së shpejti dhe planin e veprimit konkret që Kosova të bëhet faktor i rëndësishëm dhe të jetë në tregun rajonal të energjisë. Ju faleminderit.

#### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Gani Koci, kurse le të përgatitet deputeti Bexhet Brajshori.

#### **GANI KOCI**

Të nderuar deputet, i nderuari ministër Çeku, ne para vetes kemi një projekt dokument rreth strategjisë për zhvillimin energjetik të Kosovës dhe kemi edhe faktin tjetër se tash e 6 vite Kosova përjeton krizë energjetike dhe për kundër fjalëve të mëdhaja nuk është bërë asgjë në zbutjen e kësaj krize, ka pasur disa konstatime se pasojë e çkafit është kjo krizë, por kurrë nuk ka pasur veprime konkrete për eliminimin e kësaj krize, prandaj mund të them se kriza energjetike në Kosovë ka qen dhe është pasojë dhe është krizë menagjuese e tër sistemit dhe resurseve energjetike në Kosovë. Kriza energjetike në Kosovë ka shkaktuar një zhvillim të dobët dhe ngecje në ekonomi, ka sjellur shqetësime në prodhim, në biznes në shoqërinë civile dhe këto pasoja dhe këto shqetësime janë rezultat i politikave energjetike ose i pa politikave energjetike që nuk i ka pasur Kosova dhe i një veprimi të pakontrolluar të dobët, janë rezultat i një qeverisje të korruptuar të burimeve tona energjetike, i menagjimeve të dobëta shpeshherë edhe të ekipeve vendore por më shumë ndërkombëtare dhe të tillët më shumë kanë menagjuar paranë që ka ardhur në emër të projekteve energjetike se sa projektet, andaj rezultati është zero edhe për kundër konstatimeve se deri më tani janë investuar 400 – 500 milion euro nga donacione të huaja dhe 240 milion euro nga buxheti edhe ashtu i varfër i Kosovës dhe për këtë dobësi, për këtë mospasë deri më sot nuk ka dhënë askush

përgjegjësi dhe në këtë drejtim institucioni i përgjegjësishë në asnjë segment të jetës tonë shoqërore nuk vepron. Është thënë se në KEK dhe në përgjithësi në këtë sektor të energjetikës ka menagjim korruptiv, kush deri më sot u përgjigj për këtë, kush dha llogari për këtë, po që është më e keqja në shumë raste njerëzit e këtillë në një mënyrë ose në një tjetër kanë qenë të implikuar në veprime të tilla akoma avancohen prej një përjashtimi të përkohshëm ndoshta tash edhe menaxher të rendit të parë atje dhe Qeveria dhe ministri me këtë projekt të strategjisë mendon që të na ofroj neve një rrugë për të ndalur nga kjo gjendje duke përcaktuar afatin prej 10 vitesh deri në vitin 2015 dhe unë mendoj se ne akoma nuk e kemi idenë se si do të jetë gjendja energjetike në këtë fazë dimërore që po hyjmë tani e lëre ma deri në vitin 2015 pa dashur të hyjmë në te sepse nuk është objekt që sot ne mund ta diskutojmë. Projekti që është ofruar këtu është një dokument siç e thanë edhe parafolësit e mi i punuar eks-katedra d.m.th pa bërë analiza paraprake dhe se nuk janë marrë për bazë kriteret as ekonomike as sociale, as ambiente po të themi shkurt as politike, sepse resurset energjetike që ka Kosova kanë edhe interesin e vetë politik dhe në këtë drejtim duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

U tha nga ministri se ky projekt është bërë mbi bazë të disa dokumenteve të mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtar, u përmend fleta e bardhë, memorandum i Athinës, Kosova si nënshkruese e këtyre memorandumëve, në të vërtetë në emër të Kosovës kanë nënshkruar memorandumin, për sa ata që i kanë nënshkruar këto memorandume për këtë çështje kanë mbrojtur interesin e Kosovës dhe të qytetarëve të Kosovës rreth kësaj çështje. Sipas projekt-strategjisë krejt orientimi është që Kosova të eksportoj mbi 50% të prodhimit të gjithmbarshëm të energjisë elektrike, nuk dijë ndonjë vend në botë që për eksport të energjisë elektrike dedikohen 50% të prodhimit të vetë. Në radhë të parë Kosova edhe ashtu një vend i vogël do të qëndroj në një kantier të prodhimit të energjisë elektrike, do të prishet balanca ekologjike e po ashtu edhe ajo sociale dhe a na konvenon dhe a është interes i yni një gjë e tillë, prandaj ministri dhe Qeveria në përgjithësi duhet të mendojë qartë dhe duhet të mendojë drejt. Nuk është paraparë se cili është vendi i energjetikës në zhvillimin e gjithmbarshëm të ekonomisë, kjo degë a do të jetë degë e parë të zhvillimit të Kosovës a do të jetë degë ndihmëse e degëve tjera të ekonomisë dhe a do të jetë krejt e ndarë, a do të bazohet zhvillimi ekonomik i Kosovës në këtë degë kur dihet se nga pikëpamja e përfshirjes së të punësuarve është një degë që nuk do të jep shumë vende të punës dhe e dimë që Kosova është vend agrar bujqësor dhe orientimi i strategjisë të zhvillimit ekonomik do të duhej ditë dhe kjo duhet të jetë vetëm si degë ndihmëse e degëve tjera të ekonomisë, pa dashur të zgjati në këtë çështje u përmend atje rreth kuadrit ligjor si mjet për realizimin e kësaj strategjie, merreni vetëm shembullin e Hadës dhe që është bërë me Haden, pa studime paraprake, pa analiza paraprake, me urdhëresa administrative është bërë zhvendosja e atyre njerëzve dhe sot askush nuk e din se ku janë ata njerëz me se merren ata njerëz dhe a ka qenë e nevojshme të bëhet një veprim i tillë pa një analizë të veçantë dhe të mirëfilltë. Nëse do të ndodhi e njëjta gjë edhe me Sibovcin, prandaj është detyrë e Qeverisë dhe ministrisë përkatëse dhe e këtij Kuvendi që këtë çështje në radhë të parë të bijën ligjin mbi shpalljen e zonave të interesit nacional dhe të dimë se ku i kemi ato zona të interesit nacional dhe cili është interesi nacional dhe tek pastaj ligji mbi eksproprijimin, ata që kanë njohuri rreth kësaj çështje e dinë shumë mirë se zbatimi i atij ligji kërkon mjete shumë të mëdhaja, kërkon krijimin e një fondi, unë po them sipas disa analizave të ekspertëve të ndryshëm që për hapjen e Sibovcit për eksproprijim do të duhej një fond paraprak prej dikund 60 milion eurove, nuk e kamë pa diku në strategji një diçka të tillë se si do të realizohet kjo dhe në fund dua të them se është një dëshirë e mirë që ne të zhvillojmë këtë degë të ekonomisë sonë dhe të jetë bazë e zhvillimit të degëve tjera, por jo që Kosova të jetë eksportues dhe furnizues i regjionit ashtu siç mendohet me këtë projekt dhe siç mendojnë edhe ato memorandume, edhe ato marrëveshje që i kanë nënshkruar të tjerët në emër të Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputeti Bexhet Brajshori, kurse le të përgatitet Ibush Jonuzi.

## **BEXHET BRAJSHORI**

Z. kryesues, z. ministër, të nderuar deputet. Unë e çmoj shumë përpjekjen e Ministrisë për të na sjellur një dokument lidhur me zhvillimin e strategjisë ose strategjinë e zhvillimit të Energjetikës, dokument të cilin e kemi kërkuar kaheerë dhe shumë gjatë edhe po ashtu gatishmëria e Ministrisë që të na vijë në Kuvend dhe në mënyrë që secili brenda mundësive të veta të ofroj kontributin e vetë. Unë kërkoj falje nga kolegët e mijë që në ndonjë aspekt do të përsëriten por kemi të bëjmë me një dokument të përbashkët dhe duke e pasur parasysh këtë unë do të jem më i shkurtër se kolegët tjerë.

Në faqen 20 të strategjisë ku kemi të bëjmë me prodhimin e energjisë elektrike ose me objektivat strategjike në pikën 5.1 decidivisht thuhet: “Brenda kësaj periudhe të disponohet me kapacitetet e prodhimit të energjisë elektrike prej së paku 1800 megavat për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm të konsumatorit në Kosovë dhe për të eksportuar 30 – 50%”. Unë mendoj se pjesa e eksportit duhet të hiqet. Kosova duhet të prodhojë energji elektrike aq sa normalisht do të zhvillojë ekonominë e vetë, do të furnizoj në mënyrë të rregullt të gjithë konsumatorët dhe natyrisht në kuadër të këmbimit reciprok të energjisë elektrike në kuadër të sistemit energjetik të rajonit dhe më gjerë të kryej obligimet e veta. Një çështje tjetër që ka të bëjë me financimin e strategjisë. Kah duhet të financohet zhvillimi i energjetikës në Kosovë, e keni të dhënë në pikën 6.5.2 Politika dhe Strategjia e financimit dhe natyrisht që strategjia parasheh forma të ndryshme ose kombinime të ndryshme të financimit. Mirëpo është pak a shumë paradoksale se e para është shtruar financimi i energjetikës nga mjetet e buxhetit. Unë mendoj se absolutisht duhet harruar nga agjenti i KEK-ut se zhvillimi i energjetikës në Kosovë duhet të varet ose të bëhet nga mjetet e buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Nëse kjo duhet të vijë dikund kah fundi dhe ajo që duhet të vihet e para duhet të gjenden forma tjera të financimit dhe unë do të forcoja në masë të konsiderueshme vetëfinancimin e energjisë elektrike, përkatësisht KEK-u. Kjo duke e vështirë por më së miri do t’i vinte menagjmentit të KEK-ut sikur të merrte të holla të gatshme dhe të bënte financimin e projekteve të caktuara dhe pastaj përveç vetëfinancimit natyrisht se privatizimi duhet të ketë segmente të caktuara të sistemit energjetik sikur edhe format e tjera të financimit siç janë koncesionet dhe pastaj edhe forma të ndryshme të aranzhimit të financimeve, prandaj KEK-u nuk mund ta mbështet zhvillimin e strategjisë ose edhe Qeveria në shfrytëzim të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, sepse ato mjete shihet se nuk janë dhe e treta, “Menagjmenti i KEK-ut” mjaft u fol, mjaft u tha, u dhanë edhe parametrat se në të vërtetë cili ka qenë sukcesi i menagjmentit të KEK-ut në periudhën e pas luftës dhe mendoj se vazhdimisht është bërë një eksperiment me KEK-un, një eksperiment deri në keqpërdorime të haptë, KEK-un kolegë të nderuar mund ta menagojnë ata të cilët dinë dhe ata të cilët duan ta bëjnë mirë menagjimin e KEK-ut, as njëra dhe as tjetra komponent deri më tani nuk janë konfirmuar në KEK, prandaj unë mendoj se është tepër paradoksale dhe vazhdimi i kontratës së tadh dhe deri në fund të vitit 2006 dhe më është dukur tepër e rënd një deklaram para disa ditësh në media njëri prej zyrtarëve të shtyllës së katërt që menagjmenti i KEK-ut lidhet me investimet që duhet bërë donatorët e jashtëm në KEK. Kjo të përkujton teori të së kaluarës dhe me fjalë tjera unë mendoj se menagjmentin e KEK-ut e bëjnë mirë ata që dinë dhe ata që duan dhe kjo mund të bëhet prej faktorit vendor e jo prej faktorëve ndërkombëtar dhe krejt në fund Çështja e ruajtjes së ambientit jetësor që lidhet me financimin e investimeve dhe me krejt zhvillimin e energjetikës në Kosovë, një strategji që do të jetë shumë e kushtueshme nëse në vetvete nuk përfshin ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit jetësor me të gjithë parametrat tjerë që sigurisht që do të na del shumë e shtrenjtë nëse diçka e tillë nuk do ta kemi parasysh dhe nuk merren masa për të ndërtuar aq kapacitete dhe për të mbrojtur ambientin në kuadër të mundësive dhe të investimeve që duhet bërë në fushën e energjetikës. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, deputeti i fundit Ibush Jonuzi.

**IBUSH JONUZI**

Do të jem shumë i shkurtër me që e tha në ekspozen e vetë ministri Çeku pastaj në fjalën e vetë kryetari i Komisionit parlamentar z. Rexhepi dhe një gjë tjetër që ne në Komision parlamentar detajisht e kemi shqyrtuar këtë Projekt të strategjisë së Kosovës për periudhën 2005-2015 pasi që kanë qenë prezent edhe ekspertët e lëmisë përkatëse, por strategjia e Energjisë së Kosovës për periudhën 10 vjeçare bazohet në termoenergji, që do të thotë nga qymyri. Hartimi i strategjisë zhvillimore të energjetikës është parakusht për organizimin më të mirë të shoqërisë në Kosovë, sidoqoftë edhe prej fjalëve që u dëgjuan tani edhe prej diskutimeve që ne i kemi pasur në Komision parlamentar dhe ekspertët e Ministrisë kanë marr obligime që ato të inkorporohen në strategji mendoj se e vlen por edhe e meriton ky shqyrtim i strategjisë që të përkrahet dhe të miratohet nga Parlamenti se është më mirë të kemi një strategji të tillë se mos të kemi asnjë strategji për energjetikën e Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit, lutem deputetët që të kthehen në sallë, ofrohet koha e vendimmarrjes për fjalë është paraqitur ministri Ethem Çeku.

**ETHEM ÇEKU**

Në radhë të parë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata të cilët e përkrahin këtë strategji, poshtua u jam mirënjohës për të gjitha kritikën, vërejtjet që janë dhënë, kemi biseduar edhe me Komisionin parlamentar që i kanë dhënë vërejtjet që mendoj që grupet e ekspertëve të Ministrisë dhe ministrive i kanë pranuar dhe janë inkorporuar në këtë strategji, kanë mbetur disa probleme që me të drejtë u shtruan çështja e statistikave dhe a janë statistikën e qëndrueshme në raportin e hartimit të kësaj strategjie, është një vërejtje me vend edhe pse e dini që regjistrimi i popullatës dhe shumë pjesë të tjera nuk janë kryer dhe ka qenë ideja a t'i hyhet kësaj strategjie apo të zhvillohen të gjitha ato procese dhe humbshim shumë hapa dhe prandaj është vendosur që t'i hyjmë edhe në mungesë të këtyre të hyjmë në hartimin e strategjisë edhe në mungesë të disa të dhënave, prandaj në fillim mund të ketë lëshime dhe ka lëshime, prandaj e kemi planin implementues strategjik dhe planin implementues dhe mendoj se janë dy dokumente të cilat janë të kundërta dhe në konceptin e implementimit që po ashtu duhet të sillen në Komisionin parlamentar dhe struktura tjera që është biseduar mund të implementohen ato lëshime që janë bërë në strategji, planin implementues në disa sektorë të caktuar.

Sa i përket çështjeve të rezervave, unë dua të them që janë kryer shumë studime të cilat i kemi para veti nga viti 2000 e këndej, prej vitit 2000 e andej nuk i kemi referuar studimet e më së paku në këtë rast i referohem CZS-së së Beogradit. Sa i përket minierës së Sibovcit me që se është shpallur si zonë me interes të veçantë është në përputhshmëri me ligjin për planifikim hapësinor dhe sa i përket çështjeve mjedisore edhe po të dojmë ne të bëjmë lëshime në aspektin mjedisor jemi të monitoruar me konventat ndërkombëtare që i përket çështjes mjedisore dhe po ashtu ligjit për mjedis. Ne i kemi paraparë edhe në ligjin e minierave po ashtu edhe në strategji, çdo veprim është vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe nuk mund të bëhet asnjë veprim pa vlerësimin e ndikimit në mjedis, ne kemi këtu mungesë dhe nuk kemi arritur që të kemi kapacitete të qëndrueshme, prandaj e kemi projektin e fuqishëm të Bankës botërore të USAID-it dhe Agjencionit Evropian, janë tre donatorët që e mbikëqyrin tërësisht projektin dhe jemi në

përputhshmëri sa i përket planit të veprimit. Kurse sa i përket planit të ndërtimit të kapaciteteve që i nevojiten Kosovës ato do të jenë planet që do të aprovohen në këtë Kuvend. A do të shkojmë me një politikë ekspansioniste mirëpo gjithçka do të jetë në koston financiare dhe përpos koston financiare edhe përpos koston financiare do të jetë edhe kostoja sociale dhe kostoja ekologjike që duhet të japin përgjigjen definitive dhe jashtë këtyre tri përgjigjeve nuk mund të kalojmë, pa na financuar ana ekonomike dhe ana sociale. Sa i përket menagjmentit, nuk dua të ndalem me ndonjë koment sepse jemi duke biseduar për strategji e përkrahi dhe e kemi kërkuar mbështetjen e komisionit parlamentar, jemi konsultuar, kemi dhënë qëndrimet tona, rezultatet që i kemi dhe që janë evidente janë në sipërfaqe, nuk mund të them as ashtu e as kështu, kemi thënë që në fillim, nuk jemi të kënaqur me menagjmentin ndërkombëtar që është në Kosovë, ka një kontratë dy vjeçare e kanë të lidhur nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, është i sponzoruar nga buxheti i Qeverisë së Kosovës, nuk e mbështesim dhe kemi kërkuar që me 31 dhjetor të bëhet evakuimi i parë i aneksit apo i kontratës mundësisht në aspektin e rezultateve, kjo është në aspektin e ngushtë të ministrisë dhe përgjegjësive që ne i kemi.

Sa i përket çështjeve të financimit mendoj se atje është dhënë një plan shumë detaj i financimit, kanë punuar një grup i mirë i ekspertëve me këtë rast ne e shohim si mundësi të madhe zhvillimore involvimi e kapitalit privat në sektorin e energjisë elektrike edhe kostoja e zhvendosjes, hapja e minierës së re të Sibovcit, plani dhe rivitalizimi i blloqeve të Kosovës "A" duhet të kalojnë përmes sektorit privat dhe involvimit të sektorit privat në fushën e energjisë elektrike. Këto janë disa zhvillime tona unë do ta lus edhe njëherë grupin parlamentar të PDK-së që të jenë bashkëpjesëmarrës në këtë strategji se i kemi biseduar dhe punuar bashkërisht dhe unë nuk dua të ndalem në ligje të aprovuar dhe strategjia nuk është e hartuar nga një dokument tjetër, por është e hartuar në princip të ligjeve të hartuara dhe shfrytëzohet rastin ta falënderoj Komisionin parlamentar që ka bërë hartimin e ligjeve dhe në princip të atyre ligjeve është hartuar edhe kjo. Ju faleminderit për mirëkuptim.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti

## **SABRI HAMITI**

Të flitet për KEK-un është bërë popullore dhe nuk jam njëri prej tyre që e kamë zanat elektron por kamë biseduar me njerëz që e njohin mirë këtë problematik, në anën tjetër ju e dini që është bërë tema nr. 1 qe 6 vite televizioni na bombardon me ato informata për KEK-un kështu që të gjithë janë ekspert dhe të gjithë nuk din asgjë në të njëjtën kohë rreth KEK-ut. Me gjithë atë janë disa probleme që duken në fillim, problemi strategjik është që të caktohet se çka është KEK-u a është pasuri nacionale e Kosovës, a duhet ajo pasuri nacionale të ruhet si e tillë apo të kalojë nëpër faza tjera të transformimit, nën dy kush e udhëheqë KEK-un, cilat janë përgjegjësitet e Ministrisë konkrete në KEK. Unë e çmoj shumë insistimin e ministrit aktual që të merë përgjegjësi dhe vullnetin e tij, por realisht nuk e ka atë mundësi të ndikimit, kush e udhëheqë tash KEK-un, momentalisht e udhëheqë apo e menagjon si të doni një grup të cilit vullnetarisht Qeveria e Kosovës ia ka dhënë 7 milion e gjysmë me qeveris për 2 vjet me pare të Kosovës që për mua është absurdi i madh i Qeverisë së Kosovës sepse në Kuvend kur është biseduar për këto probleme kemi ndërtuar rekomandime dhe e kemi lutur Qeverinë merre udhëheqë KEK-un, po flas kështu sepse jam në Kuvend të Kosovës, nëse vullnetarisht licencohet një ekip e huaj ta udhëheq KEK-un për 2 vjet dhe thuhet botërisht nga ana e Qeverisë, konkretisht e Ministrisë, që ai grup nuk e udhëheq mirë KEK-un në të njëjtën kohë del e dhëna se do t'i ipen edhe 6 muaj shtesë dhe këtu është një konfuzion total rreth këtij menagjimi, kur i thua ekipit që t'i nuk po din me udhëheqë dhe është mirë që të ndjekim



nesër në të njëjtën kohë i thua rri edhe 6 muaj kjo është një mosmarrëveshje totale me komunikim, këtu duhet të sqarohen këto probleme, a ka llogari kjo unë mendoj se jo dhe kamë menduar edhe atëherë, mendoj se asnjë ditë nuk duhet t'i vazhdohet ajo kontratë atij ekipi që bën hajgare, hap konkurse për menagjues të sektorëve të ndryshëm të KEK-ut dhe thotë ejani ju mësojmë ne, ju ushtrojmë 6 muaj se nuk dini me udhëheqë, të gjithë ata njerëz që i njoh unë janë ma profesionist në udhëheqjen e KEK-ut se krejt këta punëdhënësit e huaj që ne i kemi paguar që të na bëjnë trajnim neve që i dimë punët, kjo është problemi në KEK dhe kjo është e vërteta. Në anën tjetër nëse është pasuri nacionale KEK-u me krejt rrjetin evetë është edhe traseja e tij, zotëri ne lexojmë se me leje të kujt i ipet leje firmës private krejt traseja në shfrytëzim dhe bëhet monopolist një tip privat me pasuri nacionale, a e dini ju lutem Qeveria se çka ka ndodhur kjo, a e dini ju z. ministër, a e ka bekimin tuaj, a ju ka pyetur kush, d.m.th unë e çmoj vullnetin tuaj dhe tonin që të bisedojmë por atë vend, atë ndërmarrje, atë kompleks janë duke e udhëhequr njerëzit që bëjnë pazare me te si të donë dhe unë mendoj që Kuvendi i Kosovës duhet të gjejë mënyrën e artikulimit që të jap krahë Qeverisë që të marrë përgjegjësi atje, për ndryshe kot ne flasim për disa shifra të mangshme se jo po na i marrin paret, jo po i menagjojnë keq edhe këtu është një problem që duhet të theksohet. Paratë e Qeverisë që janë shkuar në KEK janë sociale nuk janë dhënë te njerëzit që e hargjojn rrymën e nuk e paguajnë fare dhe kjo duhet të thuhet haptas, nëse hargjojn 100% dhe paguajnë 30% kush e mbulon atë se prodhimi i rrymës e ka koston e vetë, Qeveria në mënyrë të padukshme përmes fondit fiskal i ndanë vjet për vjet KEK-ut para të cilat shkojnë në gjepin e atyre që hargjojnë s kurrfarë investimi nuk është bërë edhe Qeveria e dinë e besoj se edhe Ministria e din d.m.th problemet janë edhe akute edhe strategjike në KEK, por sido që të jetë unë mendoj se as që duhet të merë status tjetër ajo pasuri nacionale pa marrëveshje në Kuvend dhe në Qeveri dhe e dyta nuk guxon të tjetërsohet në tipin e marrëveshjes dhe tinëz me IPK-on dhe kjo duhet të bëhet publike dhe të diskutohet dhe e treta që definitivisht edhe nëse atë grup e ndjek edhe 6 muaj duhet me ja paguar paret le të përgatitet udhëheqja që verën e ardhshme ta marrë dhe ta menagjoj KEK-un. Ju faleminderit.

#### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Faleminderit z. deputet, pamvarsisht se ne erdhëm në fund të debatit, ka të lajmëruar ende dhe unë i lus deputetët që të paraqiten me kohë për fjalë, fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

#### **JAKUP KRASNIQI**

Z. kryesues, Unë desha të lajmërohem për fjalë, por kërkesën që e bëri ministri i energjetikës më shtyri ta marrë fjalën. Mendoj që shumë problemeve si parlament po ju qasemi me vonesë tepër të gjatë dhe nganjëherë po futemi në disa debate të paarsyeshme. Qeveria e Kosovës dhe Kosova është dashur moti kohë ta ketë një strategji zhvillimore të Kosovës që nuk e ka dhe mendoj se miratimi apo aprovimi strategjive të veçanta në Parlament pa strategjinë e zhvillimit të Kosovës nuk është në rregull, nën një. Nën dy, këtu u tha disa herë se KEK-u dhe pasuria e thëngjillit në Kosovë është interes nacional. Nëse KEK-u e sidomos minierat janë pasuri nacionale a mund të privatizohet një pasuri nacionale, kush ka të drejtë ta privatizoj një pasuri nacionale e keqja është se ne në Kosovë nuk e kemi shpallur asnjë pasuri nacionale në kuptimin më të mirë të fjalës, sepse kjo të ishte bërë me strategjinë zhvillimore të Kosovës dhe unë jam i bindur se ka edhe pasuri tjera nacionale në Kosovë që po privatizohen dhe nuk do të duhej që të privatizohen se ato janë interes nacional i Kosovës dhe i qytetarëve të saj, prandaj e tha deputeti i PDK-së ne nuk do të jem kundër kësaj strategjie por si subjekt politik nuk jemi për, ne do të abstenojmë, por po kërkoj nga Parlamenti që vërtetë ta kryejmë detyrën tonë, ta kërkojmë nga Qeveria strategjinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe të kërkojmë për të gjitha pasuritë dhe ndërmarrjet publike te debatohet me Parlament se konsideroj ne te gjitha këto sfera ka keqpërdorime, keqmenaxhime dhe po dëmtohet interesi nacional i qytetarëve te Kosovës. Ju faleminderit!

## KRYESUESI, NAIM MALOKU

Unë lus deputetet që të deklarohe mi për miratimin e këti dokumenti me vërejtjet, pra është e obliguar Qeveria që t'i inkorporon vërejtjet që janë thënë këtu gjatë këti debati. Lus regjin që të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Per :50  
Kunder: 4  
Të abstenuar: 17

Ju faleminderit! Konstatoj që dokumenti është i miratuar por duke e obliguar Qeverinë që të inkorporon të gjitha vërejtjet që i thamë në këtë debat.  
Kalojmë në pikën e 14. të rendit të ditës.

### 14. Shqyrtimi i raportit të buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005

Raporti për buxhetin e Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005. I përgatitur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa e shqyrtuar dhe e analizuar nga komisioni për buxhet dhe financa të Kuvendit të Kosovës i cili ka bërë dhe rekomandime për Kuvendin. Materiali u është shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve. Lus ministrin e ekonomisë dhe financave Haki Shatrin ta merr fjalën .

#### HAKI SHATRI

Te nderuar deputet, siç u tha dhe në fjalën e kryesuesit raporti gjashtëmujor i aktiviteteve fiskale u është dërguar Kuvendit dhe institucioneve tjera në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neni 40. i cili obligon Ministrin e Financave që të përgatis dhe të dorëzojë raporte të përkohshme buxhetore që mbulojnë periudhat tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vitin fiskal buxhetor. Pavarësisht nga kjo Ministria e Ekonomisë dhe Financave përgatit dhe raportet mujore të të njëjtës natyrë dhe duke pasur parasysh se raporti 6 mujor është dorëzuar në fund të muajit korrik, pra kur edhe lejon ligji për arsye se kërkohet një kohë deri të përgatitja e përfundimit të periudhës, mendoj që duke pasur parasysh edhe faktin se e kemi raportin para vetit të shpërndarë, unë kam menduar që sot para jush të prezantoj të dhënat për ecuritë fiskale për 8 muaj të këtij viti sepse është përgatitur sipas dinamikës normale të përgatitjes raporti për 8 muaj dhe sot mund t'u jap të dhënat për të njëjtat kategori që i kemi në raportin 6 mujor, mund t'ua komunikoj të dhënat për 8 muaj të këtij viti dhe në këtë mënyrë do të kemi më të freskët raportin për ecuritë fiskale në këtë periudhë.

Siç jeni të informuar buxheti i vitit 2005 kap shumën 739.3 milion euro shpenzime ndër të cilat të hyrat e këtij viti do të jenë 641.9 milion euro, ndryshimi prej 94.7 milion euro është paraparë që të mbulohet nga rezervat që kemi trashëguar nga vitet e mëparshme në buxhet. Të hyrat janë paraparë kryesisht të jenë të hyra nga tatimet dhe doganat në shumë prej 544 milion euro dhe të hyrat komunale 34.80 milion euro, kurse të shpenzimet të cilat do të jenë 739.3 milion euro, 22 milion euro do të jenë huazim dhe ndryshime, kurse 714 milion euro do të jenë shpenzime vijuese për institucionet qendrore dhe komunale, Në të dala pagat do të jenë 195 milion, mallra dhe shërbime 142 milion, subvencione dhe transfero, pensione dhe forma tjera të ofrimit të ndihmave 217 milion dhe rezervat 15 milion dhe shpenzimet kapitale 168.83 milion. Në periudhën prej 8 muajsh të cilin e kemi kaluar dhe për të cilën po përpiqemi të jap informata të hyrat e gjithmbarshme janë realizuar 95.7%, pra unë po jap disa informata të cilat

ndryshojnë pak nga natyra e raportit të cilin ua kemi shpërnda, ndryshimi në mes të kësaj që do të prezantohet unë dhe të dhënave që keni ju është në modelin e informimit, atje janë të paraqitura të hyrat në periudhë krahasuar me buxhetin 1 vjetor, kurse për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth dinamikës së realizimit edhe të të hyrave dhe shpenzimeve unë kamë ndarë proporcionalisht periudhën prej 8 muajsh sa do të ishte dashur të jenë të hyrat dhe shpenzimet dhe ajo që në realitet ka ndodhur këtë muaj edhe te të hyrat dhe te shpenzimet. Pra 95% e të hyrave proporcionalisht në 8 muajt e vitit buxhetor janë realizuar në këta 8 muaj. Më mirë qëndrojnë të hyrat e buxhetit qendror të cilat janë realizuar 97.3 %, nga atë cilat nga të hyrat tatimore, doganat dhe TVSH në kufi 100% janë realizuar, të hyrat në kufi, doganat 98, kurse të hyrat nga tatimi vendor të cilat i inkason ose i mbledh administrata tatimore janë realizuar 105.1%. Në këtë kuptim kemi rastet edhe një veprim i cili është normal i paraparë me ligjin mbi administratën tatimore janë edhe kthimi i disa pjesëve të tatimeve të cilat merren por me ligj është e paraparë që t'u kthehen tatimpaguesve. Kjo pikë është realizuar 90% brenda 14 milion që është paraparë brenda vitit t'u kthehen tatimpaguesve janë realizuar 8.76 milion, pra u janë kthyer tatimpaguesve në bazë të drejtës që ata e kanë.

Të hyrat jo tatimore janë realizuar 80,7%, kurse më së dobëti në realizimin e të hyrave në këtë periudhë kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë sikurse në vitin e mëparshëm realizimi i të hyrave komunale të cilat në këtë periudhë janë realizuar vetëm 67.2%. Duke pasur parasysh këtë çështje si problem të vazhdueshëm. Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka filluar një aktivitet dhe po përgatit një dokument me të cilin do të bëjë një lloj reforme dhe do të propozoj masa për përmirësimin e rritjes së të hyrave në nivel të komunave të të hyrave vetanake, duke përfshirë edhe të hyrat tjera nga taksat nga disa obligime që u vihen qytetarëve në nivel komunal.

Shpenzimet e gjithmbarshme në periudhën 8 mujore janë realizuar 81.7% këto shpenzime paraqesin 3.1% më shumë shpenzime se sa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në strukturën e shpenzimeve pagat dhe mëditjet janë paguar 98.5% që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar paraqesin 4.1% rritje të pagesës së pagave dhe mëditjeve. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është realizuar 87.2% dhe është 22.4% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Te kategoria e subvencioneve dhe transfero janë realizuar 84.6% dhe paraqesin 10.7% rritje në krahasim me të njëjtën periudhë. Shpenzimet kapitale janë realizuar 61.6% dhe krahasuar me të njëjtën periudhë 11.7% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dinamika e ulët e shpenzimeve kapitale është një dukuri negative nuk është dukuri pozitive, shpenzimi më i ngadalshëm se sa dinamika e paraparë por ka një arse e cila në një formë pjesërisht mund të arsyetohet sepse buxheti i këtij viti siç e dini është aprovuar dhe është miratuar me 2 muaj vonesë dhe vetë procedura e fillimeve të shpenzimeve kapitale është mjaft e komplikuar dhe e gjatë dhe ka një periudhë deri sa organizata buxhetore të cilës i janë flokuar mjetet për investime kapitale i duhet një periudhë prej minimum 2 muaj prej datës kur e dinë që i ka ato mjete deri në ditën që kur fillon t'i shpenzoj ato mjete dhe është krejt normale që deri në gjysmën e parë të vitit kjo dinamikë është shumë më e ngadalshme se sa ajo që është në gjysmën e dytë të vitit dhe organizatat buxhetore i kryejnë procedurat e nevojshme dhe mund të fillojnë shpenzimin e atyre parave dhe fillojnë me investime kapitale.

Të nderuar deputet unë nuk do t'u kisha mërzitur më shumë me shifra, raporti 8 mujorë edhe 6 mujor në përmbajtje në pjesën e pasme ka të dhëna më të detajuara lidhur me shpenzimet çoftë sipas organizatave buxhetore çoftë sipas linjave buxhetore. Por në qoftë se dikush nga deputetët është i interesuar në pika të veçanta të kërkojë informata të veçanta çoftë te ato që lidhen me ndonjë organizatë buxhetore çoftë me ato që lidhen me ndonjë projekt të veçantë unë ju premtoj që Ministria e Ekonomisë dhe Financave është në gjendje që në afatin sa më të shkurtër t'u ofroj të dhënat lidhur me ato shpenzime duke pasur parasysh dhe duke ju falënderuar për vëmendje, ju them që për kërkesa të veçanta të bashkëpunojmë sepse jemi të gatshëm që të raportojmë dhe informojmë me kohë.

## KRYESUESI, NAIM MALOKU

Ju faleminderit z. ministër, fjalën e ka deputeti Naser Osmani kryetar i Komisionit për buxhet dhe financa.

### NASER OSMANI

Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra. Falënderoj z. Shatrin për të dhënat e periodës së tretë të vitit fiskal. Ne kemi pasur në rend dite shqyrtimin e raportit 6 mujor dhe do të ishte shumë në rregull sikur ta kishim trajtuar së pari raportin 6 mujor e pastaj ministri të na plotësonte me të dhëna plotësuese dhe shpresoj që herëve tjera do të ndodh kështu. Raportin 6 mujor Ministria e Ekonomisë dhe Financave e ka prurë me kohë te Komisioni për buxhet dhe financa të cilin ne e kemi analizuar dhe i kemi parashtruar kërkesë Kryesisë së Kuvendit që ta fut në rendin e ditës të seancës së radhës. Analiza në fakt është bërë me metodën kooperative dhe me metodën e krahasimit që është njëra prej metodave më të mira për të kuptuar të dhënat dhe shifrat e prezantuara. Ndërsa analiza është ndarë në dy pjesë në të hyra dhe në të daluara. Andaj unë do të mundohem që ta jap analizën që e ka bërë Komisioni për buxhet dhe financa për raportin 6 mujor.

Të hyrat e planifikuara për vitin buxhetor 2005 janë 641.9 milion euro, ndërsa shpenzimet e planifikuara për vitin 2005 janë 714 milion euro si dhe 22 milion euro huazime për KEK-un dhe për Aeroportin, keni parasysh se 22 milion euro Komisioni për buxhet dhe financa si dhe Parlamenti nuk e ka aprovuar dhe nuk e ka rekomanduar që të jetë pjesë e buxhetit, mirë po këshilli ekonomik fiskal i ka propozuar z. Petersenit i cili është i fundit që e nënshkruan ligjin për buxhet në bazë të autorizimeve të deleguara të cilat i ka dhe kjo ka hyrë si pjesë e buxhetit që do të thotë se buxheti për vitin 2005 kap shumën 736.8 milion euro dhe qysh në start na është paraqitur një deficit prej 94.9 milion euro i cili është mbuluar kryesisht nga mjetet rezervë që kanë qenë prej viteve të mëparshme të cilat nuk janë shpenzuar. Në 6 mujorin e parë të hyrat janë 294.57 milion euro ose 45.9% nga të hyrat e planifikuara vjetore në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë më të mëdha për 16.05 milion euro ose 5.8%. Duke marrë parasysh faktin se në gjysmëvjetorin e dytë për aktivitetet e mëdha ekonomike se në të parin mund të jemi të kënaqur me vjeljen e të hyrave që janë edhe rezultat i ndryshimeve dhe në legjislacionin tatimor. Të hyrat kryesore vijnë nga vijat kufitare, keni parasysh tatimet kufitare janë TVSH-ja në kufi akcizat, taksat doganore etj. që paraqesin vlerën prej 205.24 milion ose 69.68% nga vlera e përgjithshme e të hyrave 6 mujore. Të hyrat tatimore të mbledhura në kufi janë rezultat i importeve komerciale që kanë paguar TVSH-në po janë edhe masat që janë marrë në muajin prill lidhur me ngritjen e akcizës për prodhimet e duhanit. Të hyrat nga tatimet vendore që përbëhen nga tatimet në të ardhura TVSH-ja e brendshme dhe të tjera janë 63.07 milion euro ose 21.41% të hyrave 6 mujore. Taksat vendore janë rezultat i prodhimit të tatimit në fitim, tatimit në paga, TVSH-së, dhe tatimeve të tjera të pa specifikuara. Të hyrat jo tatimore janë kontributet dhe ngarkesat dhe interesat e tjera janë 22.26 milion euro ose 27.56% të të hyrave gjithsej. Këto të hyra pasqyrohen nga pagesat e llojllojshme që grumbullohen nga administratat e zgjeruara shtetërore dhe funksionet e shtuara të Qeverisë, të hyrat kryesore nga kjo kategori janë kontributet dhe ngarkesat. Të hyrat e komunave janë 11.65 milion euro ose 3.95% të të hyrave gjithsej 6 mujore që janë për 530.000 euro ose 4.4% më pak se të hyrat e njëjta në periudhën e vitit të kaluar. Realizimi 83.5% nga planifikimi është mjaft i ulët dhe nëse nuk do të ketë trendë pozitive në gjysmëvjetorin e dytë kjo do të paraqet një shqetësim të madh për qeveritë komunale në ushtrimin e funksionit të tyre, si pasojë e kësaj mund të jetë edhe centralizimi i madh që është bërë, që ka heq shumëtribute, të drejta komunave që të kanë

burime më të mëdha në inkasimin e mjeteve dhe i vetmi burim në kuvendet komunale ka mbetur tatimi në pronë.

Shpenzimet e realizuara gjatë këtij 6 mujor kanë arritur shumën prej 274.57 milion euro që paraqet 39.4% të ndarjeve të tërësishme 6 mujore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar shpenzimet janë më të mëdha për 2.15 milion ose 0.6%. Pagat dhe mëditjet për 74.882 të punësuar aktual edhe më tutje paraqesin pozicionin kryesor për shpenzimet buxhetore që marrin pjesë me 95.99 milion euro ose 49.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë vërejtje për 18.38 milion euro ose 23.6%. Nëse e keni shfletuar raportin 6 mujor e keni vërejtur se muaji i prillit paraqet muajin në të cilin janë ngritur shpenzimet arsyeja është se në muajin janar nuk janë paguar pagat, buxheti është aprovuar me 2 muaj vonesë, ndërsa regjistrimi në kontabilitet dhe zyra e thesarit është bërë në këtë muaj.

Subvencionet dhe transferet, janë transferet sociale, subvencionet për ndërmarrjet publike, KEK-un, Aeroportin dhe ndërmarrjet tjera që menaxhohen nga AKM-ja dhe subvencionet e tjera paraqesin kategorinë e dytë të shpenzimeve në shumë prej 77.29 milion euro ose 40.02% që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë rritje për 1.85 milion euro ose 2.5%.

Mallra dhe shërbime, për këtë 6 mujor kapin shumën prej 58.55 milion euro ose 40% këto shpenzime janë dukshëm më të vogla se në vitin e kaluar dhe atë për 21.38 milion euro ose 26.7%. Investimet kapitale marrin pjesë me 42.74 milion euro ose 28.4% që janë për 6.35 milion euro ose 17.4% më të mëdha se në vitin e kaluar. Nga raporti i të hyrave dhe shpenzimeve rrjedh se bilanci bankar ka shënuar një rritje prej 20 milion euro. Kjo do të thotë se në 6 mujorin e parë kemi pasur një mbetje të mjeteve prej 20 milion eurove dhe kjo është si pasojë që disa organizata buxhetore nuk i kanë shpenzuar mjetet e tyre sipas planit të parave të gatshme. Vlen të theksohet se kur është bërë rebalanci buxhetor që ka ndodhur normalisht pas muajit qershor nga këto mjete të mbetura janë rishpërndarë vetëm 5 milion euro. Faktorët e rëndësishëm në këtë rritje të bilancit bankar dhe mos shfrytëzimit me kohë të mjeteve ka qenë si buxhet i vitit 2005 dhe është aprovuar në mars të vitit 2005 dhe planet e rrjedhjes së parasë janë dorëzuar në fillim të muajit prill të vitit 2005. Shtatë organizata buxhetore i kanë shpenzuar mjetet e tyre buxhetore më pak se 40%, 8 organizata buxhetore buxhetin e kanë shpenzuar më pak se 30% të mjeteve të tyre të parapara dhe 7 organizata të tjera buxhetore kanë shpenzuar më pak se 20% të mjeteve të tyre buxhetore, kjo është arsyeja edhe pse kemi pasur një mbetje prej 20 milion euro në 6 mujorin e parë. Ne si komision për buxhet dhe financa falënderojmë vazhdimisht Ministrinë e Financave që me kohë i bien raportet të cilat ne i analizojmë dhe falënderojmë Kryesinë e Kuvendit që e ka mundësuar shtruarjen e kësaj pike në këtë seancë dhe ministrin e financave për plotësimin që ka bërë lidhur me shpenzimet 9 mujore. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Bexhet Brajshori, kurse le të bëhet gati Jakup Krasniqi.

## **BEHXHET BRAJSHORI**

Z. kryesues, z. ministër, të nderuar kolegë deputet. Tani patëm një prezantim nga ana e ministrit për një periudhë tjetër dhe po ashtu nga ana e Komisionit për një periudhë tjetër të cilën komisioni për buxhet e ka analizuar në detaje dhe kemi ardhur deri te përfundimi natyrisht si komision për t'i rekomanduar Kuvendit edhe këtë 6 mujor dhe buxhetin në përgjithësi. Unë fillimisht e kam një propozim nëse pajtohen të gjithë deputetët. Natyrisht që është e drejtë e çdokujt, por unë po e bëj si propozim, ministri e tha një periudhë që e përfshijnë harxhimet buxhetore dhe jemi në fund të periudhës së tretë të na përgatis raportin

tjetër dhe ta analizojmë së shpejti në Kuvend që do të ishte ndoshta me të dhëna të reja dhe do të ishim afër vitit buxhetor edhe për të parë se ku jemi më saktë dhe pastaj komisioni për buxhet do ta procedonte shpejt në Kryesinë e Kuvendit, për ndryshe unë e kam vetëm një propozim. Ministria për Financa së bashku me të gjitha trupat e veta dhe pastaj përmes trupave Qeveritare dhe të Kuvendit duhet të nisë nismën për ndryshimin e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të ligjit për prokurimin publik për të lehtësuar procedurat lidhur me shfrytëzimin e konsoliduar të Kosovës, kemi ngecje në transfero te agjencioni shpenzues dhe kjo ndikon në shkallën e ulët të shfrytëzimit të buxhetit, përkatësisht shfrytëzimit të buxhetit te investimet kapitale ajo është tepër me rëndësi sepse projektet janë dhe po përfundon viti kalendarik. Këto do të ishin propozimet do të thoja edhe në emër të grupit parlamentar të LDK-së mendoj që Ministria të na sjellë me një urgjencë më të madhe dhe Kuvendi ta shqyrtoj përsëri. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Shefi i grupit parlamentar të PDK-së deputeti Jakup Krasniqi të bëhet gati në emër të partisë "Ora" deputeti Nazim Jashari.

## **JAKUP KRASNIQI**

I nderuari kryesues, zonja dhe zotërinj deputet.

Për Kuvendin e Kosovës për çdo grup parlamentar dhe çdo deputet dhe çdo qytetar të Kosovës që kanë dhe s'kanë votuar përveç statusit politik nuk ka çështje më të rëndësishme se debati për buxhetin, planifikimin e tij, për menaxhimin e tij dhe shfrytëzimin e tij. Nga mënyra se si i qasemi buxhetit nga serioziteti i përgjegjësisë, si e projektojmë atë dhe mbi të gjitha si e shfrytëzojmë buxhetin varet zhvillimi i Kosovës dhe perspektiva e qytetarëve të Kosovës, as nga ministri dhe as nga kryetari i Komisionit për buxhet dhe financa nuk u tha asnjë fjalë se a është shfrytëzuar buxheti i konsoliduar i Kosovës ajo buxhet që është miratuar kohë më parë në Parlamentin e Kosovës, a është shfrytëzuar në sektorët që ka qenë i planifikuar apo është shfrytëzuar në drejtime tjera që nuk kanë qenë të planifikuar dhe nuk janë miratuar nga ky Kuvend dhe nëse Qeveria është dashur t'i ndryshoj projektet dhe ta ndryshoj menaxhimin dhe shfrytëzimin e buxhetit është dashur ta njoftoj Parlamentin dhe në Parlament ta merë pëlqimin dhe miratimin dhe jo t'i shfrytëzoj si tu teket njërive buxhetore që e shfrytëzojnë buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Vetëm me informacionet që i marrim nga mjetet e informimit pa informacione tjera, deputetët duhet të jenë të shqetësuar dhe të obligohen që ta orientojnë të vërtetën rreth asaj që thuhet për keqmenaxhimin, keqshfrytëzimin me dije apo pa dije për vjedhjet dhe humbjet e keqpërdorimet tjera që i bëhen buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Kuvendi i Kosovës nuk e ka për detyrë që vetëm ta miratoj buxhetin e Kosovës, por e ka edhe obligim parësor ta përcjell, kontrolloj përmes trupave të rregullt apo ad-hoc shfrytëzimin apo keqshfrytëzimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe kjo nuk i është mundësuar Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka obligim që të marrë raporte të rregullta jo vetëm për pagat individuale që i marrim por para së gjithash edhe për buxhetin e Kuvendit si planifikohet, si menaxhohet dhe a shfrytëzohet ashtu siç planifikohet, ne deri më sot përveç pagave tona nuk kemi asnjë informacion se si Kuvendi i Kosovës, administrata e Kuvendit të Kosovës e shfrytëzon buxhetin e vetë. Duke penguar formimin e komisionit parlamentar hetimor Kuvendi i Kosovës po lejon jo vetëm vjedhjet në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, por po lejon zvogëlimin e vazhdueshëm të buxhetit p.sh nuk e di pse ministri nuk e tha a thua të gjitha bizneset që bëjnë tregti në Kosovë i nënshtrohen tatimit dhe cilat janë ato biznese dhe biznesmen që nuk paguajnë obligimet që i kanë me ligj, mendoj që këtë do të duhej ta thoshte ministri. Nëse ministri nuk mund ta thotë, këtë duhej ta thoshte kryetari i komisionit për buxhet dhe financa dhe ai tha vetëm çështje

miradije e përsëriti ministrin, por nuk e tha asnjë vërejtje për keqpërdorimin dhe keqmenagjimin dhe keqshfrytëzimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Vetëm në mjete të informimit kemi dëgjuar që shpenzimet e panevojshme dhe shuma të mëdha vetëm për shfrytëzimet në telefona, pastaj ju e dini që në këtë mandat ka pasur shpenzime të panevojshme për meremetimin dhe mobilimin e zyrave të ministrave, ka pasur dhe ka shfrytëzime marramendëse dhe shpenzime të mëdha në shfrytëzimin e derivateve, naftës dhe benzinës dhe këtë askush nuk e thotë dhe materiale tjera shpenzuese, prandaj për të vërtetuar këtë që e them unë është apo nuk është kështu, Parlamenti i Kosovës duhet ta formoj në Komision hetimor dhe ai vërtetë t'i verifikonte këto shpenzime, a janë bërë apo nuk janë bërë, me gjithë ate thuhet që vetëm në kryeministri ka pasur 60 mijë euro vetëm për telefona, ju lutem nëse është kryeministria, unë besoj dhe kjo duhet të vërtetohet nga një komision hetimor shpenzime marramendëse për telefoni ka në të gjitha institucionet e Kosovës dhe me këto shpenzime të pakontrolluara të paplanifikuara ne natyrisht që nuk mund ta kryejmë obligimin tonë as për arsimin, as për shëndetësinë dhe as për sektorët tjerë që kemi për obligim t'i mbikëqyrim dhe t'i financojmë.

Unë dua ta ceku vetëm edhe një dëshmi që edhe kjo meriton të vërtetohet. Thëngjilli që blihet për ngrohje të shkollave fillore dhe të mesme. Qeveria e Kosovës përmes një tenderi ose komunat përmes një tenderi blejnë thëngjill nga unioni Serbi Mali i Zi dhe pos ministrisë së arsimit janë shkarkuar nga tertorja e Kastriotit që thëngjillin ta marrin nga ta me një çmim 4 milion euro më lirë se që është marrë nga unioni Serbi Mali i Zi. Unë mendoj që ky Parlament ka obligim të verifikoj këtë të dhënë dhe nëse është e qëndrueshme kjo e dhënë Qeveria e Kosovës dhe ata që e kanë bërë këtë duhet të japin përgjegjësi para këtij parlamenti para së gjithash të nderuar deputet ata duhet të japin përgjegjësi para koalicionit qeverisës.

Kohë më parë kryetari i Komisionit e ka thënë një të pavërtetë se në Prishtinë qenkan 10 Jakup Krasniqa dhe asnjëri nga ta nuk e ka kryer obligimin, unë e ndjej për obligim sot se nuk e di a i ka 10 apo 100 Jakup Krasniqa komuna e Prishtinës por e di që shtëpia ime është e regjistruar në rrugën Vreshtra, Rr. Hasim Kiçina është regjistruar nga Kuvendi Komunal në fund të vitit 2004 nuk e di se kur është tatimuar por me 3 shkurt të vitit 2005 unë i kam kryer të gjitha obligimet që i kam dhe jo vetëm për tatim në pasuri por të gjitha obligimet që i kam për shpenzimet publike në qytetin e Prishtinës, prandaj do të kisha dëshiruar që edhe deputetët e tjerë edhe udhëheqësit e institucioneve tjerë t'i kryejnë obligimet siç i kam kryer unë, por mendoj se detyrë e kryetarit të Komisionit është për të shikuar se sa biznese i ikin tatimeve dhe obligimeve tjera një biznes i përafërt informativ me kryetarin e komisionit në kohën kur unë kam qenë ministër është liruar nga ministri i financave dhe ekonomisë dikund i ka pasur rreth 300 milion euro. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, për replikë është lajmëruar deputeti Naser Osmania

## **NASER OSMANI**

Sa i përket asaj që e kam paraqitur në seancën e mëhershme se asnjë Jakup Krasniq si ka paguar tatimet në Komunën e Prishtinës dokumentet i kam deponuar në Kuvend dhe ato mund të shikohen në çdo moment dhe ajo qëndron ashtu dhe tjetra unë nuk jam inspektor me i ndjek firmat se kush paguan tatim e kush jo pse jam kryetar i Komisionit për buxhet dhe financa dhe fjala ime bazohet gjithmonë në bazë të raporteve që na vijnë në Kuvend.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit, një minut z. Jakup Krasniqi

### **JAKUP KRASNIQI**

Nëse nuk është inspektor me shikuar se cili biznes nuk i kryen obligimet atëherë pse bëhet inspektor për të shikuar se a i kamë kryer apo si kam kryer unë obligimet, unë e dorëzoja materialin zyrtar që i kamë paguar obligimet që janë nënshkruar edhe nga administrata e Komunës së Prishtinës që udhëhiqet nga partia që vjen deputeti dhe mendoj se është një papërgjegjësi e asaj administrate dhe unë administratës së Kuvendit ia ofrova dokumentin përkatës.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit vazhdojmë debatin, fjalën e ka deputeti Nazim Jashari le të përgatitet deputetja Safete Hadërgjonaj.

### **NAZIM JASHARI**

I nderuari z. kryesues, i nderuari z. ministër, të nderuar kolegë deputet.

Është mirë që sot diku pas 9 – 10 muajsh që kemi filluar punën në seancë plenare ka ardhur një rekomandim i komisionit për të shqyrtuar një raport të zhvillimeve buxhetore në Kosovë. Mënyra se si menaxhohet paraja publike dhe se si kontrollohet menaxhimi i asaj paraje flet më së miri për vetë atë identitet politik ku bëhet ai kontroll dhe ai menaxhim dhe perspektivën e atij vendi. Më duhet të them se qysh në startin e këtij Parlamenti të kësaj përbërje ne patëm një afer medijale lidhur me keqëmenaxhimin e një fondi prej 160 milion eurove në muajin dhjetor të buxhetit të Kosovës, të brengosur sigurisht nga kjo e dhënë kjo ishte për 80 milion se dhjetorët tjerë të mëhershëm. Grupi parlamentar Ora inicioi një procedurë për të ngritur një komision hetimor i cili do të merrte dhe do të analizonte se si ka ndodhur që gjatë muajit dhjetor të vitit 2004 ka ndodhur një harxhim aq i madh i buxhetit të Kosovës. Aso kohe u votua kundër propozimit tonë siç ndodh zakonisht nën ndikimin e kryetarit të Kuvendit z. Nexhat Daci dhe votohet kundër grupit Ora, siç ndodhi të hënën e kaluar, por me gjithë atë ai dha disa rekomandime për komisionin e buxhetit dhe për Kuvendin përgjithësisht dhe tha se procedura nuk mund të bëhet se duhet të pritët raporti nga Qeveria dhe pastaj Komisioni i buxhetit ta analizoj atë raport dhe që tek më pastaj ai raport të vijë në Kuvendin e Kosovës, as nuk erdhi ai raport në komisionin për buxhet në të cilin jam edhe unë dhe as nuk erdhi analiza e atij raporti në këtë seancë, pra 160 milion euro të muajit dhjetor nuk dihet as sot e kësaj dite se ku kanë shkuar dhe si janë harxhuar dhe për çfarë qëllimesh janë përdorur.

Nga Qeveria na kanë ardhur raporte në Komisionin për buxhet dhe jo juve deputet se ne në komisionin për buxhet kemi shansin të marrim raporte që ju të tjerët nuk i keni që është non-sens edhe për 3 mujorëshin edhe për çdo muaj më pastaj, mirëpo deri te raporti 6 mujor nuk ka ndodhur që ky raport të vijë në Kuvend, nuk ka ndodhur as të analizohen në komisionin për buxhet që kryetari më herët ju falënderua ministrit që po na informon rregullisht dhe po na jep mundësi rregullisht të analizojmë raportin, kjo është hera e parë që edhe komisioni për buxhet e analizon një raport të Qeverisë për harxhime buxhetore, është hera e parë që edhe ky Kuvend vet po e analizon një rekomandim të komisionit. Sa i përket rekomandimit dua të them se këtu askund nuk thotë që ky rekomandim e thërret Kuvendin që ta miratoj se keni lexuar me kujdes, askund aty nuk përmendet. Në komision është diskutuar me seriozitet me kujdesinë më të madhe nga të gjithë dhe nga grupet parlamentare dhe janë bërë disa vërejtje shumë përmbajtjesore të cilat



i keni të theksuara me të zezë në fund të raportit thotë: Raporti i prezantuar nuk jep përshkrime të mjaftueshme për aktivitetet financiare, kjo është vërejtja e parë, vërejtja e dytë thotë: Shpenzimet e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore nuk përputhen me shënimet e ligjit për buxhetin për vitin 2005 në nene të caktuara. Në raport nuk janë pasqyruar detajisht pozicionet e të hyrave, kjo është pika e tretë e vërejtjeve, këto janë tri vërejtje shumë serioze të cilat në një farë mënyre këtë raport e bëjnë të deklasuar, në qoftë se nuk janë dhënë përshkrime të mjaftueshme për aktivitetet financiare nuk është i plotë, në qoftë se shënimet e të hyrave dhe harxhimeve buxhetore nuk përputhen me shënimet e ligjit për buxhet atëherë ky raport nuk e respekton ligjin zonja dhe zotërinj, ky raport bie ndesh me ligjin, pasi që është ndesh me ligjin unë nuk di se si do të procedohet më tutje se nuk ke di që në mandatin e kaluar si jeni marrë me këtë problematik duke e pasur parasysh se kjo është hera e parë që e kemi në këtë mandat këtë problematik realisht nuk e di se cili është edhe kuptimi i kësaj pune që o e bëjmë sot, cili është shkaku i kësaj analize, çfarë do të vendoset në Kuvend lidhur me këtë raport dhe çfarë mund të bëj në raport me faktin se si ta përmirësoj punën e Qeverisë ose si ky përfundim i këtij Kuvendi si do të ndikoj në rrjedhën e punës së Qeverisë.

Në këtë kuptim dua t'ua tërheq vërejtjen edhe në një detaj që mua më ka bërë përshtypje shumë dhe të cilin ju nuk keni mundësi ta analizoni për shkak se nuk i keni informacionet fatkeqësisht në raportin e 3 mujorit të parë i cili është i ngjashëm me këtë nuk ndryshojnë shifrat, por ndryshojnë shumat që është shumë normale, ndryshojnë shumat vetëm në kolonën e të hyrave, ndryshojnë shumat edhe në kolonat e atyre të cilat do të duheshin të ishin të pandryshueshme, ndryshojnë shumat në kolonat e pozicioneve të paparashikuara që për mua është një pakuptimësi totale se në rast se ligji është miratuar me disa shuma si mund të ndodh që në 3 mujor janë tjera shifra, kurse në 6 mujor janë tjera shifra, ligji për buxhet nëse është ligj atëherë duhet t'i përmbahemi atij ligji dhe ato shifra t'i trajtojmë si pozicione të ligjit dhe procedurat për ndryshimin e atyre pozicioneve duhet të jenë procedura ligjore e jo në mënyrë vullnetare dhe ndonjë analizë në thesar duke mos qenë i kujdesshëm dhe na vijne shifra të ndryshme në raportin e 3 mujorshit në pozicione të rezervuara dhe po ashtu vijne shifra në raportin e 6 mujorshit. Në këtë qasje jo serioze të punës unë mund të them vetëm një gjë që zoti na bëftë çarën se nuk kemi perspektivë për të ec përpara. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, ka kërkesa për pauzë, për fjalë janë paraqitur edhe 6 deputet, disa po paraqiten dhe po tërhiqen pastaj, 7 janë tani. Fjalën e ka Safete Hadërxhonaj, kurse le të përgatitet Xhevdet Neziraj.

### **SAFETE HADËRXHONAJ**

Faleminderit z. kryesues, të nderuar deputet.

Në analizën e raporteve buxhetore vëreja se është bërë shkelje të neni 3.2 dhe 3.3 të ligjit të buxhetit të konsoliduar pasi në të tri raportet financiare me të cilat disponojmë, kurse nuk disponojmë me raportin 8 mujor, plani i shpenzimeve të miratuara në Kuvend ndryshon, atëherë sa mund t'u besohet shifrave në kolonën të realizuara. Bazuar në këto të dhëna asnjë shifër e shprehur në përqindje në kolonën progresi ndaj buxhetit nuk është e saktë. Komisioni për buxhet e financa ka ftuar ministrin e financave dhe ekonomisë për të dhënë sqarime për këtë çështje me 1 qershor 2005, ministri nuk i është përgjigjur ftesës së komisionit. Raporti 6 mujor i buxhetit ka gabime të shumta, mospërputhje shifrash, lëshime të pa arsyeshme nuk ka pasqyrë të alokimeve dhe të shpenzimeve për periudhën janar – qershor, nuk ka një pasqyrë reale të të hyrave. Vërehet keq menaxhimi i financave publike po thuaj se në të gjitha organizatat asnjëra nga ato nuk i kanë shpenzuar mjetet sipas planit të cilin e ka bërë për shpenzime. Planifikimi jo i mirë i buxhetit, ndarja e mjeteve pa kriter dhe pa projekte konkrete ka bërë që në 15 organizata buxhetore

të shpenzohet buxheti nën 30% kurse në 7 të tjera nën 40%. Arkëtimi i të hyrave të buxhetit qendror sipas tabelës 1 është nën mesataren e planifikuar, vërehet paaftësia për menaxhimin e taksave dhe tatimeve komunale kur janë realizuar vetëm 11.65 milion nga 34.80 milion të planifikuara, nëse vazhdohet kështu ato edhe më tutje do të mbeten barrë e buxhetit qendror. Rrjedha e shpenzimeve sipas muajve le hapësirë për dyshime edhe në këtë raport të përgjithësuar e shumë pak të detajizuar vërehet tendenca e mosrespektimit të ligjit në fuqi dhe orientimin e institucioneve për të abuzuar dhe keqpërdorur paranë publike. Më tepër është personifikuar buxheti për interesat individuale duke mos i kushtuar kujdes mirëqenies gjë që ka vënë në provë durueshmërinë e qytetarëve, prandaj është krejt logjike të protestohet sidomos nga punëtorët shëndetësor dhe të arsimit me të cilët edhe solidarizohemi sot. Po të punohej më shumë në zvogëlimin e invazionit fiskal, mbylljes së rrugës së korrupsionit dhe kontrabandës në kufi, shpenzimet më të mira të buxhetit, rritjes së shkallës së arkëtimeve në vend, krijimit të kulturës fiskale do të krijohej një bazë e mirë për implementimin e kontratës kolektive. Në institucionet demokratike çështja kryesore është transparencja buxhetore a ekziston kjo tek institucionet tona, sigurisht se jo po filloj nga kryetari i Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ka bërë shkelje të nenit 4, nenit 5.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil si dhe nenit 28.3 dhe 28.4 të Urdhërësës administrative nr. 2003/2 duke i marrë 3 paga mujore nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, shkelje të kësaj rregulloreje bëjnë edhe shumë ministra dhe disa deputet. Kryetari i Kuvendit po ashtu ka bërë shkelje të Kornizës kushtetuese sepse kapitulli 9.1.7 definon kryesinë si organ më të lartë të përbërë prej 8 anëtarëve e jo kryetarit, i njëjti nen përcakton edhe përgjegjësinë e Kryesisë. Kryetari i Kuvendit në mënyrë arbitrare ushtron diktatin e vetë duke abuzuar me buxhetin e Kuvendit dhe nuk është transparent as ndaj Kryesisë së Kuvendit, pyes kryetarit e Kuvendit a janë respektuar procedurat për harxhimin e mjeteve në vlerë prej 5400.749 në emër të shpenzimeve kapitale, sa është transparent ndaj Kryesisë së Kuvendit për 2.908.929 euro të shpenzuara, a ka Kuvendi plan të shpenzimeve sipas periudhave kohore dhe sa janë realizuar objektivat programore, kur kryetari i Kuvendit e shkel ligjin dhe rregulloret në fuqi dhe abuzon me letër, atëherë çka pritët prej institucioneve tjera që janë zgjedhur pikërisht nga ky Kuvend. Në ligjin për buxhet Presidencës i janë ndarë 2.274.844 euro, në raportin 4 mujor shihet se i janë shtuar buxhetit për 1 milion euro në saje të transferim të kundërligjshëm nga Ministria e Shërbimeve Publike.

Në raportin 6 mujor shihet se buxheti i shtuar kundër ligjit në vlerë prej 3.254.724 euro është shpenzuar nga presidenca 91.1%. Në raportin 4 mujor Ministria e Shërbimeve Publike kishte buxhetin e zvogëluar për 1 milion euro. Në raportin 6 mujor është shtuar për 1 milion euro vetëm në Qeverinë e Kosovës bëhen transferet e kundërligjshme qofshin këto nga mosdija apo me shtyrje partiake nuk pasojnë sanksione, bëhen lojëra me miliona euro dhe askush nuk ngarkohet me përgjegjësi. Duke shikuar faqen 22 të raportit 6 mujor tabela 3.2 shfrytëzimin e rezervave dhe avanseve shihet një shumë prej 1 milion euro në kolonën e zyrës së kryetarit, nëse nga rezerva e ministrit të Ministrisë së financave është transferuar kjo shumë atëherë është shkelur ligji për menaxhimin e financave publike si dhe ligji për buxhet neni 8 pika (b) sepse në raportin 100 ditësh të Qeverisë aneksi 2 nuk vërehet se është marrë ndonjë vendim për transfero të mjeteve në zyrën e kryetarit.

Të nderuar deputet ne nuk e dimë se si i ka kompensuar Presidenca obligimet gjatë muajit korrik, gusht, shtator nga se nuk ka buxhet, anëtarët e Komisionit për buxhet dhe financa po as ju si deputet nuk jeni në dijeni për vlerësimin e buxhetit, atëherë ku është transparencja buxhetore. Zyra e kryeministrit në ligjin për buxhet ka në dispozicion 2.470.718 euro. Në raportin 6 mujor ka 2.888.786 euro, nuk ka kurrfarë arsytimi të paktën në raportet periodike buxhetore për këtë shtim prej 417.968 euro gjë që është bërë shkelje e ligjit për buxhet neni 3 pika 3. Nënshkrimi i kundërligjshëm nga ana e kryeministrit për ndarjen e mjeteve për përfundimin e punimeve në ish Bankos, buxhetit të Kosovës i kushtoi 1.163.000 euro, pyes kryeministrin ku është arsyeshmëria e shpenzimeve të 2.460.249 euro në emër të mallrave dhe shpenzimeve. Nëse i ndajmë për numrin e të punësuarve i bie mbi 900 euro shpenzime për një punëtor. Ku

është arsyeshmëria e nënshkrimit të marrëveshjes midis Qeverisë dhe Presidencës dhe shoqërisë "Albani" e njohur si marrëveshje me Hazerlokun për pagesë mujore prej 60.800 funta britanike si dhe marrëveshjes në Jundipendent diplomat në vlerë prej 50.000 funtave britanike dhe shpenzimet e tjera që ne nuk i dimë dhe nuk dihet se sa janë.

Shpërdorim të mjeteve të taksapaguesve Kosovar ka në të gjitha institucionet, por shpërdorimi në tri institucionet më të larta është i rëndë kur të tre krerët e këtyre institucioneve janë të propozuarit për grupin negociator e ndoshta asnjëri prej tyre dhe as Qeveria në përgjithësi nuk është e vetëdijshme se është miratuar në minus 94.9 milion euro pra me një deficit prej 4.8% të bruto produktit vendor, në vend se të demonstroj teprica fiskale ata përkundrazi vazhdojnë me shpenzime pa kriter që rrezikojnë në rritjen e deficitit për vitin 2006 e kështu e ngarkojnë Kosovën me problemet financiare buxhetore duke i ditur se ka mjaft probleme tjera.

Kjo Qeveri që ka instaluar korrupsionin në institucionet më të larta nuk e ka të qartë se sa i kushton Kosovës shfrytëzimi joefektiv dhe jo oficient i buxhetit. Dëshmia më e mirë e kësaj është vetëm 15% e mjeteve në shfrytëzime kapitale dhe atë duke mos qenë në gjendje që t'i përcaktoj objektivat zhvillimore dhe të orientohet në projekte afatgjate investive ka hargjuar këto mjete në blerjen e veturave apo luksin e tepruar pa nivelin e duhur të transparencës e në fund e citoj protestën e grupit parlamentar të PDK-së që në mënyrë që të mos keni bankrotim financiar për vitin 2006 propozoj të formohet një komision hetimor parlamentar i cili do të vejë kontrollin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

1. Të verifikoj se sa është duke u respektuar ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, ligji i prokurorit publik dhe ligji për miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës.
2. Sa është respektuar neni 5 i ligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, të përfshihen të hyrat vetanake dhe të organizatave buxhetore, a janë nënshkruar memorandumet e mirëkuptimit në të gjitha organizatat buxhetore të cilat gjenerojnë të hyra apo këto kanë gjyrollogari të veta.
3. Pse nuk është respektuar neni 7 i ligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës ku përfshihen përkufizimet mbi detyrimet dhe shpenzimet i cili nen bën që të respektohen edhe rekomandimet e Fondit monetar ndërkombëtar.
4. Çfarë shpenzimesh kanë hyrë në mallra dhe shërbime dhe a janë ato në harmoni me qarkoren buxhetore.
5. A janë respektur udhëzimet e nxjerra nga

### **Mungon incizimi**

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputete, Fjalën e ka Xhevdet Neziraj, kurse le të prëgaditete Teuta Hadri.

### **XHEVDET NEZIRAJ**

I nderuari z. kryesues, i respektuari z. ministër.

Grupi i aleancës përgëzon Ministrinë për raportin 6 mujor financiar, mirëpo mund të themi se edhe ne kemi disa vërejtje tona të cilat vërejtje mund të kalohen në raportin 9 mujor ose vjetor, mund të them se në raportin 6 mujor ka mangësi në të dhëna të sakta për inkasimin e të hyrave, duhet një pasqyrë më detaje e pozicionit të të hyrave që ky pozicion mund të rregullohet me raportin 9 mujor ose vjetor. Gjithashtu mungojnë të dhënat për vlerën investive dhe kapitale të vitit 2005 të cilat janë bartë prej vitit 2004, ka

mungesë të saktë edhe për shpenzimet dhe llojet e tyre dhe për këtë Ministria mund të jap një raport më detaj në raportin vjetor dhe me siguri edhe deputetët po edhe të gjithë të tjerët të interesuar do të keni pasqyrën më detaje edhe të hyrave dhe të dalurave buxhetore.

Unë si deputet dhe në emër të Aleancës do ta përkrahi një vendim të kolegut Brajshori i cili në ligjin për menaxhimin publik të financave kemi bërë një ndryshim në Kuvend, kishte me qenë mirë që shumëçka të ndryshohet se ai ligj është jo i mirë dhe disa njësi buxhetore nuk kanë mundësi t'i shfrytëzojnë mjetet dhe në këtë raport del që shumë njësi buxhetore nuk kanë shfrytëzuar mjetet e planifikuara, prandaj është mungesa dhe është një ligj i cili duhet të tejkalohet dhe t'i përshtatet ekonomisë Kosovare. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, kurse le të përgatitet deputeti Shaban Halimi.

## **TEUTA HADRI**

Të nderuar deputet, i nderuar z. kryesues.

Një fjalë e urtë popullore thotë: Fol sa të duash se në fund bëj atë që di vetë. Fatkeqësisht edhe për deputetët është bërë praktikë që flasin e flasin dhe askush nuk i dëgjon vërejtjet dhe kërkesat e tyre nuk pranohen. Ky është pozicioni i deputetit tonë, ku do të na sjell kjo, si po na humb kjo Qeveri kështu, dikush duhet të përgjigjet. Për të mos shkaktuar konfuzion nga fjalët e mia që po them do të mbështetem në paraqitjen e raportit të prezantuar të vitit 2005 të 6 mujorit të parë i cili që në faqet e para është nënvizuar nga kryetari i komisionit e tha edhe më parë parafolësi i grupit tjetër për 3 pikat që janë nënvizuar me vija të zeza dhe janë tri vërejtje që nuk dua t'i përsëris me fjalë se janë shumë të rëndësishme që ky komision dhe kryetari i Komisionit nuk është dashur t'i nënvizohet, por është dashur që të refuzohet ky raport, prandaj lind pyetja nga këto tri pika dhe tri vërejtje që janë bërë me shkronja të zeza, kush po e vjel buxhetin e Kosovës, buxhetin e punëtorëve tanë dhe qytetarëve tanë, ju lutem deputet, sa krenar ishim për të marrë emrin e deputetit, sa krenar ishte edhe ky popull që na zgjodhi dhe na dha votën, sot jemi bërë si kuklla druri dhe vetëm ngrisim dorë pa pas qëllime. Ne që kemi ardhur këtu nga vota e qytetarëve tanë për ta ngritur zërin në Parlament dhe kërkesat e tyre njëzërit t'i ngrisim që të gjithë për t'i mbrojtur ato. Buxheti për shëndetësi që është ndarë nga Qeveri gjatë këtij 6 mujori është 8.7 që është një buxhet i vogël dhe qesharak, të mbulohet shëndetësia e Kosovës me të gjitha këto probleme që i ka me 8.7 me këtë vlerë është për të qeshur, nuk dua ta krahasoj me buxhetin e vendeve fqinje, mos pyet për shtetet e Evropës qendrore sa ndajnë për shëndetësinë e tyre se po të dëgjojnë punëtorët tanë do të krijohet një gjendje kaosi dhe njerëzit profesional do të largohen nga Kosova ashtu siç është bërë pikë e dobët e shtetit të Kosovës sot që rinia jonë po ik në emigrim dhe kjo është një plagë e rëndë e secilës ekonomi. Ky buxhet i ndarë për shëndetësi e ka shndërruar shëndetësinë Kosovare në një shoqatë humanitare "Nën Tereza" sikur në sistemin paralel të Kosovës në kolonizimin serb po ai buxhet i marruar atëherë në atë kohë ilegalisht nga pagat e arsimtarëve dhe firmat private e ka pasur vlerën 10% e sot nga institucionet tona ta ketë një vlerë kaq të dobët 8.7%, a nuk është dobësi sot për institucionet tona ku nga ky raport në 6 mujor vetëm të realizuara i kemi pasur 294.57 milion euro apo nga një njohje e buxhetit 641.9 milion euro, shëndetësia ta ketë këtu vendin me 8.7%. Do të kënaqeshim dhe do të pajtoheshim sikur edhe këto 8.7% të buxhetit të shfrytëzoheshin vetëm për shëndetësi e të mos keqpërdoren, të ketë transparencë nga të hyrat dhe të dalurat që në këtë raport nuk janë paraqitur për shëndetësi.

Zotërinj deputet, punëtori shëndetësor sot nuk është vetëm i nënvlerësuar, por edhe i diskriminuar në shëndetësinë tonë. Pagat e punëtorëve shëndetësor janë shumë të ultë, një pagë e punëtorit apo specialistit një fëmijë i juaji i mban në gjepin e tij, kujdestaritë 24 orësh të punëtorëve nga mjekët specialist paguhen

12 euro më pak se një pagë e një punëtori fizik, a nuk është kjo një Qeveri primitive që e barazon intelektin dhe fuqinë e thjeshtë të punëtorëve, po ku po mbesin paret e kujdestarive të natës që nga muji shkurt që punëtorët shëndetësor ende nuk i kanë marrë, kush i keqpërdorë ato. Z. deputet, z. kryetar nuk më mbetet në fund asgjë tjetër vetëm t'ju ftoj dhe t'ju bëj një ftesë të vini dhe t'i hani darkat apo drekat e punëtorëve shëndetësor që ngjasin me drekat e ndonjë shtaze në ndonjë vend të Evropës perëndimore dhe besoj se puna e Parlamentit do të ishte ndërpre për 2 – 3 muaj nga problemet e barkut, prandaj kërkesat e punëtorëve shëndetësor që kanë duruar aq shumë për 6 vite e masin vlerën, nderin dhe shkallën e intelektit tuaj, këto duhet të plotësohen pa tjetër dhe njëherit propozoj që buxheti shëndetësor të ngritet në vlerën 18% aty ku ka shëndet ka punë ka shoqëri dhe aty ka shtet. Ju faleminderit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputeti Shaban Halimi, kurse le të bëhet gati deputeti Gani Koci

## **SHABAN HALIMI**

Të nderuar kolegë deputet,

Raportin të cilin sot e kemi para vetes është një raport i cili për mendimin tim është i përpiluar plotësisht në bazë të ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe ligjit mbi hartimin e buxhetit 2005 dhe si raport me anët profesionale të tij i përmban të gjitha ato elemente të cilat do të duhej ti ketë një raport lidhur me të hyrat dhe shpenzimet e një buxheti siç është buxheti jonë i konsoliduar i Kosovës. Lidhur me këtë që më shqetëson mua më së tepërmi si delegat i këtij Kuvendi dhe si qytetar i Kosovës janë të dhënat sepse neve po që se marrim në analizë dhe shikojmë shpenzimet në raport me të hyrat e këtij buxheti shohim se shpenzimet kanë tendencë rritjeje gjatë këtij viti dhe këto në asnjë mënyrë nuk mund të ndikojnë që deficitin që në fillim i paraparë në 94 milion që ky buxhet ose ky deficit në një farë forme të zbutet. Deficitin i cili është planifikuar të mbulohet nga rezerva ose nga mjete të cilat janë: Si tepërcë e mjeteve që kanë tepruar nga agjencitë buxhetore, në anën tjetër kemi shpenzimet që i kemi, shpenzimet për pagat dhe mëditjet, subvencionet në raport me pozicionin e mallrave dhe shërbimeve ku me këtë pozicion kemi d.m.th një ulje të shpenzimeve faktikisht del se nuk kemi shpenzime të mëdha ka ndikuar negativisht në punën e suksesshme të kuvendeve komunale, e sidomos të atyre kuvendeve komunale dhe të hyrat vetanake të tyre, sidomos tek të hyrat në tatimin në pronë dhe të gjitha ato kategori të të hyrave tjera të cilat përfshihen në bazë të vendimit mbi tarifatat dhe ngarkesat. Komunat të cilat p.sh. edhe ato pak të hyra prej njëqindpesëdhjetë mijë i kanë bashkuar me mjete të tjera të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, i kanë bashkuar me donacione të ndryshme të shoqatave qeveritare dhe joqeveritare dhe faktikisht në një farë mënyre e kanë sjellë bankën në një pozitë më të vështirë dhe kanë ndikuar negativisht.

Prandaj, unë mendoj se buxheti i konsoliduar i Kosovës, për të përmirësuar situatën e tij duhet që të gjitha agjencitë buxhetore, do të thotë shfrytëzuesit e këtij buxheti, pra edhe në parlamentarët këtu, pra të gjithë, të jemi të vetëdijshëm në mënyrën e shfrytëzimit të buxheteve në mënyrë sa më eficiente, sa më ekonomike që të jemi në drejtim të duhur, duke filluar p.sh. me reduktimet që duhet bërë në numër të tepruar që kemi të punëtorëve në të gjitha agjencitë buxhetore, duke filluar me reduktimin e të gjitha shpenzimeve, do të thotë secila agjenci buxhetore duhet të jetë nikoqir i mirë, secili në vendin ku punon dhe shpenzon. Gjithashtu, në këtë drejtim duhet të shtojnë edhe masat e tjera në inkasimin e tatimeve, pastaj të t.v.sh në dogana etj. Edhe tatimet e tjera duhet të inkasohen në mënyrë që të kemi një buxhet të qëndrueshëm, një buxhet që së paku në vitet e tjera mos të jetë buxhet i planifikuar me deficite, do të thotë buxhet pa mbulesë, sepse nuk i kemi ato të drejta ende që t'i shfrytëzojmë mekanizmat ndërkombëtarë, që t'i shfrytëzojmë donacionet ose t'i shfrytëzojmë privilegjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar të Bankës Botërore dhe të mekanizmave të tjerë që ndihmojnë dhe kontribuojnë në këtë

drejtim, prandaj është detyrë me përgjegjësi e të gjithë neve që të jemi të vëmendshëm në shfrytëzimin e buxhetit.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Fjalën e ka z. Gani Koci, le të përgatitet Selvie Halimi

### **GANI KOCI**

Në raportin buxhetor janar-prill që e kemi pasur më herët, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave vjen deri te një konstatim, se thotë që të hyrat buxhetore për vitin 2005 janar-prill janë më të vogla dhe kanë qenë në nivelin e asaj që është planifikuar, ndërsa rritja, kështu shkruan ministria, konsiston vetëm te bartja e mjeteve të suficitit nga viti 2004.

Unë do të shtroja pyetjen, po të marrim shifrat, kolonat e të hyrave dhe të dalave, na del përafërsisht ajo që është planifikuar si e hyrë, qoftë si e dalë, por unë do të shtroja pyetjen sa në këtë rritje të hyrave kanë ndikuar bartjet ose të hyrat që është dashur të hyjnë në vitin 2004 dhe janë realizuar në qershor 2005, sa për qind e shton këtë rritje ajo e planifikuara e 2004-shit dhe, çështja tjetër që dua të shtroj janë dy segmentet e shpenzimeve, ajo për pagat dhe mëditjet dhe ajo e mallrave dhe e shërbimeve, që përafërsisht po edhe këtu janë realizuar sipas planifikimit.

Te pagat dhe mëditjet nuk ka ndonjë mundësi të keq menaxhimit, të keqpërdorimit etj. Do të thotë mundësitë janë më të vogla, por te mallrat dhe shërbimet është mundësia më e madhe dhe është vendi ku më së shumti ka hapësirë për keqpërdorime të buxhetit të Kosovës dhe të parasë publike. Qeveria nuk na ka dhënë një material të specifikuar se kah kanë rrjedhur këto shpenzime. Unë po e përmendi vetëm një fakt të dëgjuar kështu prej gazetave. Një vozitës i një ministrie harxhon telefon 2100 € në vit. Do të ishte mirë që në mënyrë të specifikuar secila ministri të sjellë raportet për shpenzimet e veta në këtë drejtim qoftë për telefona, qoftë për shpenzimet tjera të karburantit, të veturave, të shpenzimeve të drekave, të darkave në reprezentacione të ndryshme dhe të shohim vërtet se si është bërë, dhe këtë mund të konstatojmë se po menaxhohet drejt ose jo.

Një çështje tjetër të cilën e shtroi edhe kolegja ime, Safetja, është çështja e ndryshimit të asaj që është fikse, e miratuar, dhe e asaj të harxhuar që në tri katër raporte që i kemi marrë prej jush shifrat nga ajo shtylla e parë ndryshojnë. Ekziston një vendim për të cilin është thënë edhe më herët këtu në këtë sallë, por unë do t'i shtroja drejtpërsëdrejti ministrit një pyetje lidhur me një transfer që është bërë diku në prill të këtij viti, ai milion euro që po qarkullon prej një ministrie në ministrinë tjetër, prej një agjencioni buxhetor në një agjencion tjetër buxhetor. Dihet që z. ministër se urdhri për këtë transfer ka ardhur pikërisht nga ju, dhe atë dokument e ka nënshkruar Agim Krasniqi drejtor i buxhetit dhe Lulzim Ismajli drejtor i Thesarit. Pra, është fjala për një milion euro. Dhe, ky milion euro tani na del në pjesën e tabela 3.2 si pjesë e shpenzimeve nga rezervat e ministrit. Unë shtroj pyetjen, a keni vepruar në përputhje me nenin 26 të Ligjit për menaxhimin e financave publike, dhe dua ta përkujtoj këtë nen, dua ta lexoj nëse keni durimin.

Varësisht nga neni 26, nëse ndodhë një rast urgjent, do të thotë se kemi të dhëna se ka pasur raste të tilla urgjente, i paparaparë, organizata buxhetore për të mbuluar shpenzimet e tilla mund të aplikojë pranë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për fonde shtesë. Pas pranimit të atij aplikacioni, Ministria për Ekonomi dhe Financa, pasi që organizata buxhetore të ketë dhënë arsyetimin e nevojshëm për veprim të

tillë, mund të heq një pjesë të fondeve të përvetësuara sipas Ligjit të përvetësimeve në fuqi për shpenzimet e rastit dhe atë pjesë të hequr t'ia shtojë përvetësimit përkatës të asaj organizate buxhetore.

Neni 2. i qartëson edhe shumat. Ministri për Ekonomi dhe Financa mund të autorizojë shpenzime nga këto përvetësime sipas këtij neni në shumën e përgjithshme deri në 250.000 €. Mbi 250.000 euro ministri këtë nuk mund ta bëjë pa një vendim të Qeverisë dhe pa pëlqim dhe autorizim të Përfaqësuesit special të Sekretarit të OKB-së. A është marrë ky vendim në Qeveri kur ka një vendim tjetër për transfer dhe a keni shkresë dhe dokument që këtë e ka lejuar Përfaqësuesi special, z. Petersen në këtë rast. Në qoftë se kjo është e vërtetë që keni një gjë të tillë, atëherë unë dyshoj për keq menaxhimin e buxhetit të Kosovës, sikur po i mbulon edhe veprimet e Përfaqësuesit special, ndryshe dikush do të duhej të shkonte deri më tash në përgjegjësi.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Fjalën e ka deputetja Selvie Halimi dhe e fundit është paraqitur deputetja Zahrije Jusufi

### **SELVIE HALIMI**

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit.

Duke parë një keq menaxhim kaq të thellë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, unë kisha për thënë, lum Qeveria që populli nuk është kah bindet se çfarë keq- menaxhimi, çfarë keqpërdorimi të këtij buxheti të varfër po bën vetë Qeveria, apo udhëheqja e këtij populli, dhe mjerë populli për Qeverinë që është duke e udhëhequr.

Z. Ministër, unë kisha për t'ju bërë një pyetje: Çfarë është duke ndodhur dhe a ekzistojnë ato 7.5 milion € të ndara për nivelizimin e pagave, kurse nivelizimi nuk po ndodhë, duke pasur për bazë faktin se pikërisht nga Ministria për Ekonomi dhe Financa kemi deklarime të cilat kanë dallime të thella njëra me tjetrën se ekzistojnë apo nuk ekzistojnë këto mjete të cilat i kemi aprovuar në fillim të këtij viti, si kolonë e veçantë e mjeteve të rezervuara për nivelizim. Ju shtroj edhe një pyetje. Edhe pse jeni ministër, kjo ka të bëjë me buxhetin dhe mund të themi lirisht se ju sot e përfaqësoni gjithë Qeverinë, sepse jeni i vetmi këtu.

Si lejon Qeveria e Kosovës që të lidhen marrëveshje për të blerë kohë për të mashtruar popullin dhe ato nuk implementohen, pse Qeveria nuk del me një vendim për t'i shfuqizuar ato marrëveshje siç është Aneks kontrata kolektive, gjë që po vjen si pasojë greva e punëtorëve shëndetësorë, e punëtorëve të arsimit dhe greva e disa shërbyesve civilë, pikërisht në Qeveri. Dhe, pikërisht sot rezulton edhe ndërhyrja e policisë mbi grevistët, të cilët po protestojnë pikërisht për shkak të shkeljeve të ligjit, aq më keq të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ju faleminderit!

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputete. Fjalën e ka Zahrije Jusufi

### **ZAHRIJE JUSUFI**

I nderuar z. kryesues, të nderuar z. Ministra, të nderuar z. Deputetë,

Buxheti për Shëndetësi, i limituar dhe i zvogëluar për vitin 2005, me pjesëmarrjen e shpenzimeve të përgjithshme prej 8.7%, pra 52.29 milionëve dhe i shpenzuar prej 22.15 milionëve për 6 muaj, d.m.th 44% në nivelin qendror dhe 48% në nivelin lokal, shfrytëzohet në mënyrë jo racionale pa u përcaktuar prioritetet, shfrytëzohet për improvizime. Në praktikë shohim një funksionim jo përgjegjës në institucionet shëndetësore publike. Nuk vërehet asnjë hap në ngritjen e cilësisë në punë, të kushteve të punës dhe të pajisjeve. Në spitalet tona shohim një gjendje shumë të rëndë, duke filluar nga mungesa e aparateve më elementare dhe më të thjeshta, si termometri, lukometri etj. Mungojnë pothuajse të gjitha barnat e listës esenciale, mungojnë të gjithë antibiotikët për përdorim peros dhe intravenoz, pothuajse të gjitha antiaritmikët, madje mungojnë edhe tabletat e paracetamolit që kushtojnë disa centë, mungojnë shiringat, gjilpërat, nivolina, mjetet për dezinfektim, dorëzat, mungon materiali kirurgjik, filmat dhe kontrastet për rentgen, mungojnë barnat dhe pajisjet për intervenime emergjente.

Familjarët e pacientëve që i shtrojnë në spital të sëmurët i blejnë pothuajse qind për qind barnat. Qeveria nuk përcakton prioritetet për investime në pajisje dhe resurse humane, të cilat do të zvogëlojnë nevojën e dërgimit të qytetarëve për shërim jashtë Kosovës me shfrytëzim më të mirë të buxhetit.

Mjerisht, çdo ditë neve na vdesin shumë pacientë duke pritur koronorografinë, me qindra udhëzohen jashtë shtetit për diagnostifikim dhe trajtim dhe paguajnë mijëra euro, ndërkaq zvarritet futja në funksion e aparatit të koronografisë, vonohet renovimi i kabinetit të kardiologjisë invazive dhe edukimi i kuadrove. Nuk investohet në Institutin e Radioterapisë, urdhëresat administrative për punën e kujdestarisë nga mjetet e participimit për mjekët specialistë dhe punëtorët e tjerë shëndetësorë shfrytëzohen sipas dëshirave të strukturave menaxhuese pa përgjegjësi institucionale dhe pa kontrollin e duhur, me pagesa fyese për punëtorët shëndetësorë. Ora e punës së natës paguhet dhjetëra centë për mjekun specialist.

Në buxhetin e shpenzuar të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenies sociale prej 59 milionëve, 49.6% të shpenzuar, Qeveria dështoi t'i përmbushë në minimum kërkesat e gjendjes shumë të rëndë të kategorive ma meritore për çlirim tonë. Ato mbeten pa kurrfarë trajtimi të pranueshëm për të drejtat e njeriut. Qeveria nuk shfrytëzoi as mundësitë për shfuqizim financiar të pensionistëve. Për pensionistët nuk mjafton vetëm përkrahja morale. Nuk vërehet asnjë hap konkret për realizimin e kërkesave të tyre, rekomandimet e dala nga Kuvendi akoma nuk e kanë marrë përgjegjësinë për seriozitetin e problemit. Ju faleminderit!

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Unë i paralajmërova deputetët që ishte paraqitja e fundit për fjalë, tash është paraqitur z. Fatmire Mulhaxha Kollçaku.

## **FATMIRE MULHAXHA- KOLLÇAKU**

Po kërkoj falje, sepse për shkaqe objektive kam munguar në momentin kur janë lajmëruar, por ndjeva një nevojë shumë të madhe të paraqitem pasi jam kryetare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe për shkak të situatës aktuale në Kosovë.

Planifikimi i tillë i buxhetit, reperkusionet e një planifikimi të tillë i kemi qysh tani. Pakënaqësinë e madhe në njërën anë të punëtorëve shëndetësorë, e në anën tjetër të vetë pacientëve. Sa i përket punëtorëve shëndetësorë, duke u nisur prej pagesës e deri te mungesa e kushteve për punë, deri te mungesa e mundësisë për trajnim dhe kualifikim adekuat që duhet të zhvillohet në kontinuitet. Për t'u licencuar një



mjek dihet që nevojitet një periudhë kohore dhe prej njërit lecincim deri te tjetri duhet të ketë kryer një sërë trajnimesh. Si janë paraparë ato, si është paraparë trajnimi i mëtutjeshëm i kuadrit në një mungesë totale të buxhetit, nëse e kemi parasysh një buxhet i cili jo vetëm që nuk po planifikohet më i lartë, por po shkon edhe duke u zbritur.

Në anën tjetër e kemi edhe sigurinë në punë. Në qoftë se parafolësit e cekën, unë mund t'ju them se mungojnë mjetet elementare, siç janë dorëzat. Nëpër institucione tona shëndetësore, nëpër reparte siç është ai i hemodializës kemi edhe reperkusionet, ku është i rrezikuar edhe vetë pacienti, po edhe personeli shëndetësor. Ky është një realitet. Çdo njeri që del në terren dhe bën një vizitë të institucioneve tona, sheh mungesën e medikamenteve dhe të pajisjeve elementare për punë.

Ajo çka më shtyri të lajmërohem është pikërisht situata momentale. Ne nuk mund të kërkojmë prej stafit mjekësor përgjegjësi ta kryejnë në nivelin më të lartë të duhur punën, duke pasur parasysh intensitetin, vëllimin dhe përgjegjësinë që e kanë me një pagë me të cilën ata nuk mund ta sigurojnë ekzistencën e thjeshtë. Prandaj, është momenti që së paku për vitin e ardhshëm, kur bëhet planifikimi i buxhetit, nuk e di situatën reale, por të shikojnë që mjetet që i alokojnë dhe derdhen në shumë destinacione, që janë të tepërta, për vetura luksoze, për shumë e shumë gjëra të tjera, të shikohet të alokohen aty ku ka nevojë. Sepse dy shtyllat elementare të shoqërisë janë shëndetësia dhe arsimi. Në qoftë se nuk funksionojnë këto, atëherë mendoj se edhe në të gjitha nivelet e tjera nuk do të kemi funksionim të duhur. Ju falënderoj dhe kërkoj falje edhe një herë që u paraqita me vonesë.

## **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Haki Shatri, e keni fjalën

## **HAKI SHATRI**

Faleminderit z. kryesues.

Unë do të përpiqem të japë përgjigje që kanë të bëjnë me raportin.

Mund të them se Ministria e Ekonomisë dhe e Financave shumë shpejtë mund ta përgatisë raportin e 9 muajve dhe mund t'ua shpërndajë pa problem, por me kusht që mbledhja e Kuvendit të jetë mbas gjysmës së këtij muaji d.m.th. deri më datën 15. Është kjo një kohë minimum që na duhet për ta përgatitur, sepse muaji i nëntë ka përfunduar para 4 ditësh.

Mund të them se edhe në Ministrinë e Financave ka disa angazhime dhe ajo ka marrë edhe disa rekomandime nga disa institucione të tjera që të fillojë ndryshimi i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësive, sepse praktika ka treguar se disa dispozita të këtij ligji dhe disa pjesë praktike me rastin e implementimit dhe të zbatimit në jetën e përditshme janë treguar se po paraqesin një lloj pengese. Duhet filluar procedura, sepse për disa pjesë ka filluar procedura dhe kjo do të arrijë edhe në Kuvend siç është e paraparë për ndryshimin e ligjeve. Dua të them se unë nuk mund të përgjigjem për atë që nuk është pjesë e raportit, në veçanti nuk mund të përgjigjem për atë se çka shkruajnë gazetat.

Në pjesën e dytë të raportit i kemi shumë nga pyetjet të cilat i keni shtruar këtu dhe kam përshtypjen se dikush nuk e ka shfletuar raportin deri në fund, sepse për dinamikën e shpenzimeve sipas organizatave buxhetore shkruan për çdo organizatë buxhetore, për çdo linjë buxhetore, duke përfshirë pagat, mallrat dhe shërbimet, transferet dhe investimet kapitale.

Në qoftë se ndonjë deputeti ose grupi parlamentar, apo vetë Kuvendit i duhen sqarime ose informata shtesë për ndonjë investim kapital, për ndonjë projekt të veçantë, ato nuk mund të jepen në raport si pjesë të veçanta, por me kërkesën tuaj Ministria e Ekonomisë dhe e Financave është në gjendje t'ua sigurojë të dhënat e plota mbi lejimin, dinamikën dhe shpenzimin e tyre.

Dua të them se këtu dëgjova edhe një pjesë lidhur me akuzat mbi shpenzimet e të ardhurave, gjegjësisht realizimin e nivelizimit të të ardhurave, që është aktuale edhe në ditët e sotme, edhe në ditët para sodit, që lidhet me grevën që po e bëjnë punëtorët e arsimit dhe punëtorët e shëndetësisë. Unë ju kisha bërë lutje që të mos biem në disa pozicione, ku pa i analizuar mirë natyrën dhe mundësitë reale të buxhetit, këto akuza marrin konotacion të natyrës politike dhe pastaj e gjithë kjo të shkojë huq edhe pse ata sinqerisht angazhohen për përmirësimin e pozitës materiale të kategorive që përfaqësojnë.

Sa për informim tuajin dua të them se Qeveria e Kosovës i ka ndarë 7.5 milionë euro për nivelizimin e pagave në fillim të vitit për të filluar nivelizimin e pagave me një korrik, pra në gjysmën e dytë të këtij viti. Këto mjete, në qoftë se dikujt i intereson, mund t'i sheh kurdo të dëshirojë, të sheh buxhetin i cili është version zyrtar, qoftë në imel adresën e Kuvendit, qoftë në shkresat që ne i publikojmë. Për paga dhe mëditje në buxhet me ligjin për buxhetin janë ndarë 192.3 milion euro dhe 7.5 milion rezervë që të fillojë reformimi i sistemit të pagave në shërbimin civil. Asnjë cent nga këto mjete nuk është devijuar ose nuk është ridestinuuar për aktivitete dhe qëllime të tjera, por ekskluzivisht për paga dhe mëditje. Për këtë i jam mirënjohjes edhe z. Koci, i cili tha se këtu nuk ka edhe shumë mundësi të ndryshohet, sepse asnjë nga organizatat buxhetore nuk lejojnë që mjetet për paga të shkojnë diku tjetër. Edhe ky është një realitet.

Dua të them se Qeveria e ka filluar angazhimin për ndarjen ose reformimin e sistemit të pagave, pra për nivelizimi e pagave. Me rastin e marrjes së informatave nga organizatat buxhetore dhe me rastin e tentimit që të implementojmë këtë nivelizim të pagave, komisionet të cilat kanë punuar kanë hasur në dy probleme esenciale.

1. Kjo rregullore e re nuk ofron zgjidhje të pranueshme për disa struktura të shërbyesve civilë, pikërisht nuk ofron zgjidhje të mirë për arsimin fillor, sepse kur kemi marrë të dhënat dhe i kemi futur në sistemin e rregullores, ka dalë që mësuesve të shkollës fillore dhe tetëvjeçare do t'ju ngritet paga vetëm për 2 euro, pra 1%,
2. Me rastin e aplikimit të kësaj rregulloreje dhe marrjes së informatave se në çfarë pozicioni do të jenë punëtorët e shëndetësisë kemi hasur në reagimin e vet punëtorëve të shëndetësisë, të cilët përafërsisht para dy javësh kanë bërë një protestë dhe kanë bërë një shkresë zyrtare me të cilën i janë drejtuar Qeverisë me të cilën kërkojnë që të mos aplikohet nivelizimi i pagave sepse ata nuk e shohin si zgjidhje të problemit të tyre material aplikimin e këtij nivelizimi me qenë se mjekët e praktikës së përgjithshme dhe disa të një kategorie aty afër, realizojnë vetëm 4 euro shtesë të të ardhurave personale.

Prandaj, Qeveria e Kosovës, duke parë që përmbajtja e kësaj rregulloreje nuk ofron zgjidhje për të gjithë punëtorët e shërbimit civilë dhe, në anën tjetër rritja e normës së të ardhurave për disa kategori e cila ka rezultuar me tejkalimi për disa milionë të mundësive buxhetore të garantuara me buxhet, Qeveria ka hasur para një vështirësie të cilën po e diskuton dhe në vazhdimësi po kontakton edhe me udhëheqësit e grevës ose me sindikalistët me të cilët jemi në kontakt.

Ne nuk kemi mundësi që t'i shpërthejmë kufijtë e shpenzimeve buxhetore të parapara me buxhet, kemi mundësi që t'u informojmë dhe t'u pasqyrojmë të gjitha problemet që kemi hasur në këtë rast. Nuk kemi hequr dorë në asnjë formë nga reformimi i sistemit të pagave dhe nivelizimi i pagave, por kemi treguar që

me rastin e implementimit të kësaj rregulloreje kemi dy probleme të kësaj natyre, prandaj jemi në vazhdimësi të kërkimit të zgjidhjeve të këtij problemi dhe besoj se së shpejti do të dalim me një propozim të pranueshëm edhe për përfaqësuesit e sindikatave, edhe për Qeverinë dhe për institucionet kosovare. Duhet t'ju informoj, gjithashtu, se për sa i përket nivelit të pagave në shërbimin civil, Kosova nuk qëndron më poshtë sesa vendet përreth. Kam parasysh këtu Shqipërinë, Maqedoninë dhe Serbinë, niveli i pagave është i barabartë në krahasim me ndonjërin prej këtyre vendeve. Nëse merret si mesatare, është më i lartë edhe niveli i pagave në arsim. Dua pra të them se në krahasim me disa vende është pak më i lartë sesa ajo që marrin disa vende këtu përreth.

Po ashtu, dua t'ju them se nga krahasimi i të thënave të numrit të shërbyesve civilë në Kosovë, në krahasim me numrin e popullsisë, del se është shumë herë më i lartë sesa lejohet me kritere edhe të Fondit Monetar, edhe të institucioneve të tjera të cilat na mbështesin dhe na përkrahin. Po ashtu dua t'ju informoj se çdo mos- respektim i natyrës së shpenzimeve publike do të hasë në një reagim shumë të ashpër nga institucionet financiare, e në veçanti nga Komisioni Evropian, i cili ka marrë vendim që Kosovën ta mbështesë edhe në këtë fazë, pra edhe në fazën e paradefinimit të statusit dhe kanë deklaruar që do të gjejnë forma që ta mbështesin Kosovën në aspektin e donacioneve për buxhet dhe në këtë aspekt në fillim të nëntorit planifikohet të mbahet një konferencë me donatorë për mbështetje buxhetore. Kjo konferencë për donatorë për mbështetje buxhetore do të pasohet me një konferencë, po ashtu afër kësaj, e cila do të jetë konferencë për mbështetje për projektet në investimet publike në KEK.

Prandaj ju bëj apel të gjithë personave publikë të cilët paraqiten qoftë në Kuvend, qoftë në mjete të informimit, që të mos i fryjnë zjarrit, i cili ka erë të natyrës politike, por të jenë në nivel i cili do t'i ndihmojë Qeverisë që në këtë fazë, duke respektuar të gjitha rregullat në fuqi, të përmbushë obligimet e veta, në radhë të parë kriterin e një qëndrueshmërie buxhetore si kriter bazë me të cilin mund të depërtojmë edhe në tendencat tjera për të siguruar mbështetjet buxhetore nga institucionet financiare ndërkombëtare, por edhe në vetë procesin e diskutimit të statusit të Kosovës. Ju faleminderit!

#### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit ministër. Gani Koci, replikë dy minuta.

#### **GANI KOCI**

Faleminderit z. Kryesues. Zoti ministër nuk pati kurajo që të përgjigjet ose s'ka njohuri, ose s'ka të dhëna për pyetjen që e kisha shumë drejtpërdrejtë, nën një, nën dy, rreth çështjes së nivelizimit të pagave ka ekzistuar një projekt për të cilin janë dhënë mjete dhe ai projekt ka paraparë edhe pengesat dhe vështirësitë e implementimit, prandaj ka paraparë edhe shumën që do të duhej për implementimin e atij projekti. Edhe Qeveria juaj ka bërë një projekt krejt të ri që një herë ua lë fajin teknikës, tash po na del faji tjetër kund, prandaj është mirë që të sqaroheni para opinionit, sepse përndryshe nuk i fryn askush asaj që të shkaktojë trazira për çështje politike, por mos puna juaj, papërgjegjësia juaj na ka sjellë deri këtu edhe mund të na sjellë edhe nesër ku nuk duhet të shkojë.

#### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit, ministri Haki Shatri.

#### **HAKI SHATRI**

Ju faleminderit shumë, për mos t'ju marrë shumë kohë, unë kalova, përndryshe nuk i kam ikur përgjigjes së z. Gani Koci. Përgjigja është kjo: Në praktikën deri në këtë vit transferin e mjeteve nga një institucion, nga një organizatë buxhetore në një organizatë tjetër e ka miratuar Përfaqësuesi special me kërkesë të Ministrisë dhe me lejin e një ministrie tjetër ose një subjekti tjetër buxhetor. Në këtë vit, transferin e mjeteve nga një institucion, nga një organizatë buxhetore në një organizatë tjetër e ka miratuar Përfaqësuesi special me kërkesë të Ministrisë dhe me lejin e një ministrie tjetër ose të një subjekti tjetër buxhetor.

Në këtë vit, për shkak të një afere që është ngritur pa nevojë në mjetet e informimit, Përfaqësuesi special ka kërkuar që ky transfer të korrigohet dhe të bëhet përmes një rruge tjetër që konsiderohet decidivisht legale dhe kjo është realizuar në vend që të jepen mjetet për një destinim urgjentë. Nga një subjekt buxhetor është kërkuar që këto mjete të zëvendësohen me mjetet nga rezervat e ministrit, e kjo është bërë me procedurë të rregullt dhe është konfirmuar me nënshkrimin e Përfaqësuesit special, i cili është bërë me rastin e rishqyrtimit buxhetor në korrik të këtij viti.

Dokumentacioni përkatës gjendet në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave te zyra fiskale e Përfaqësuesit special, e kështu me radhë. Sa i përket rregullores për të ardhurat personale ose për nivelizimin, më vjen keq se nuk pajtohem, sepse qeveria aktuale nuk ka nxjerrë asnjë lloj rregulloreje të re. E ka marrë komplet rregulloren që e kemi trashëguar me datën 4 dhjetor kur e kemi marrë mandatin dhe nuk e kemi ndërruar bile as vlerësimet për gradat. Ashtu siç ka qenë, komplet kemi dëshiruar dhe kemi vlerësuar se kjo rregullore është nxjerrë në të mirë të qytetarëve dhe kemi filluar ta aplikojmë, por kemi parë në praktikë që kjo nuk mbulohet me mjetet që i kemi rezervuar dhe në këtë formë ka dalë që nuk i zgjidh problemet e një kategorie të shërbyesve civilë. Ky është problemi, nuk është problemi që e kemi ndërruar rregulloren. Ju faleminderit!

#### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Kalojmë në pikën e 15-të të rendit të ditës.

#### **XHEZAIR MURATI**

Imamo na dnevnom redu zahtev Predsedništvu, odnosno Skupštini o nekim izmenama u komisijama koje smo dostavili. Naime, umesto dosadašnjeg člana Komisije za pravosuđe, zakonodavstvo i Ustavni okvir Šprese Murati da novi član Komisije bude poslanik Husnija Bečković. Što se tiče drugog zahteva, grupa je odustala od drugog zahteva sporazumno, naravno, i ja bih molio da se ovo usvoji danas u Skupštini. Hvala vam!

#### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Të votojmë, një votim formal për propozimin e Grupit parlamentar 6 +, që deputeti Hysnia Beqković të emërohet anëtar i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese në vend të deputetës Shpresa Murati. Përgatitemi për votim, votojmë tani. Ju faleminderit, 62 deputetë kanë votuar për, konstatoj se është bërë zëvendësimi që është kërkuar. Për fjalë është lajmëruar shefi i grupit parlamentar të LDK-së, deputeti Alush Gashi.

#### **ALUSH GASHI**

I nderuari kryesues, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së dhe në frymë të vendimit nga njëra prej pikakave të mëparëshme, kur seanca plenare muar vendim që të kërkojë nga komisionet funksionale, si ai për Arsim dhe ky për Shëndetësi, përjekje maksimale për përcjelljen e çështjes aktuale siç është ndërprerja e veprimtarisë së arsimit dhe një pjesë e shëndetësisë, kërkon nga Qeveria e Kosovës që urgjentisht të kërkojë zgjidhje të qëndrueshme në kuadër të mundësive aktuale ligjore, dhe natyrisht pret mirëkuptim nga profesionistët e arsimit dhe të shëndetësisë për vështësitë në të cilën gjendet vendi ynë aktualisht.

Unë e mora fjalën në kuadër të rregullores e cila parasheh inicimin për pika të rendit të ditës për seancën, apo për njëre nga seancat e ardhshme. Grupi parlamentar i LDK-së, zonja dhe zotërinj, për herë të dytë kërkon ligj për zgjedhje. Më lejoni t'ju përkujtoj një histori të shkurtër të institucionalizuar me vendimet e Kuvendit të Kosovës.

Në transkriptin e seancës plenare nr. 2003-13 të 24 prillit 2003 qendron se me iniciativë të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe me mbështetje të Komisionit për Çështje Gjqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese është zhvilluar debat lidhur me iniciativën tonë që në Kuvendin e Kosovës të nxjirret Ligji për zgjedhje. Pas një debati ku kanë marë pjesë mëse 20 deputetë të Kuvendit të Kosovës, është zhvilluar akti i votimit dhe me shumicë votash, me disa abstenime dhe me disa vota kundër, kryetari i Kuvendit të Kosovës konstatoi sa vijon:

Kuvendi i Kosovës miratoi nismën e Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Komisionit Legjislativ për nxjerrjen e Ligjit për zgjedhje. Kuvendi e ngarkoi Qeverinë që në bashkëpunim me grupin e punës së OSBE-së dhe me Komisionin për Çështje Gjqësore Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese të hartojë Projektligjin për zgjedhje në afat prej 3 muajësh dhe t'ia propozojë Kuvendit për miratim.

Z. kryesues, Grupi parlamentar i LDK-së kërkon që në kuadër të kompetencave aktuale të shiqoni mundësinë që Qeveria aktuale pasi është ndërrim i Qeverisë, të përgatitë Ligjin për zgjedhje. Nëse për çfarëdo arsye Kryesia e Kuvendit konstaton që nuk ka forcë të mjaftueshme që vendimin e mëhershëm ta ekzekutojë, Grupi parlamentar i LDK-së kërkon që kjo çështje të radhitet në rend të ditës në njërën prej seancave të ardhshme, mundësisht në seancën e ardhshme.

#### **KRYESUSI, NAIM MALOKU**

Ju faleminderit z. deputet, kërkesa juaj do t'i procedohet në mënyrë të rregullt Kryesisë së Kuvendit.

Nuk është kërkuar fjala, z. deputetë, për rend dite. Ju lutem, shefi i Grupit parlamentar të PDK-së, Jakup Krasniqi.

#### **JAKUP KRASNIQI**

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë.

Partia Demokratike mbështet iniciativën e parë të Grupit parlamentar të LDK-së. Edhe ne mendojmë që edhe Parlamenti me seriozitet të plotë duhet t'i përcjellë zhvillimet rreth grevës së punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të shërbyesve civilë dhe Qeveria duhet të merr përgjegjësitë që i takojnë. Sa i përket ligjit, ne nuk jemi kundër Ligjit për zgjedhje, por konsiderojmë që këtu duhet të bëhet një debat në parlament. Ligjet për zgjedhje janë të rëndësishme jo vetëm për sot, por edhe për të ardhmen. Mendoj që kjo duhet të bëhet me një koncenzues të plotë të subjekteve politike. Kërkesat tona shtesë janë që Kryesia

e Parlamentit të bisedojë dhe të ketë në rend të ditës kërkesën e sotme tonën për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar nën një, e nën dy, ju e dini se kohë më parë kemi kërkuar nga kryeministri që për çështjet e bisedimeve të zhvillohet një debat në Parlamentin e Kosovës. Kryeministri aso kohe pat thënë që nuk janë përgatitur, por ndërkohë do të sjell një dokument dhe sot e asaj dite nuk ka sjell një dokument për ato bisedime. Bisedimet kanë filluar dhe unë mendoj se edhe kjo çështje duhet të hyjë në rend të ditës në seancën e ardhshme. Për këtë kemi biseduar edhe me kryetarin e Grupit parlamentar të LDK-së dhe jemi pajtuar. Unë mendoj se bisedimet e filluara, kështu siç janë, i demtojnë institucionet e Kosovës dhe ne duhet të jemi më përgjegjës për situatën politike që po kalon vendi. Ju faleminderit.

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Shefja e Grupit parlamentar të partisë ORA, Teuta Sahatçiu

### **TEUTA SAHATÇIU**

Ju faleminderit, në emër të Grupit tonë parlamentar ta përshëndesë iniciativën e LDK-së që çështja e grevave të hyjë në rendin e ditës të seancës së ardhshme, edhe pse ishte iniciativë e jona që kjo të hyjë në këtë seancë. Shpresoj që nuk do të jetë vonë deri në seancën e ardhshme që të diskutohet. Ju faleminderit!

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e keni kërkuar fjalën.

### **GJYLNAZE SYLA**

Me qenë se dolën shumë iniciativa, konsiderojmë si grup parlamentar që më së miri është që të gjithë t'i paraqesim me shkrim dhe pastaj Kryesia të vendosë se cilën prej pikave të rendit të ditës të fusë. Ne si grup parlamentarë do të japim kontributin tonë në të gjitha pikat për të cilat Kryesia do të vendosë që të jenë në rendin e ditës.

Sa i përket Ligjit për zgjedhjet, natyrisht që ne kemi nevojë për një ligj për zgjedhjet dhe konstatoj që është çështje e të gjitha grupeve, e sidomos për zgjedhjet në të ardhmen dua t'ia kujtoj Kuvendit vetëm se ekzistojnë iniciativa të ndryshme. Është forumi i cili punon, ku institucionet e Kosovës nuk janë të kyqura aspak. Si grup parlamentar kemi kërkuar që institucionet e Kosovës të kyqen në këtë çështje. Pastaj është edhe Qeveria që gjithashtu mund ta draftojë ligjin. Konsiderojmë se janë tema të rëndësishme, gjithashtu, edhe grevat dhe çështjet tjera. Por, për grupin parlamentar çështje mbi çështjet është çështja e Mitrovicës, prandaj si grup parlamentar kërkojmë që në njërin nga seancat të diskutohet kjo. Prapë qëndrojmë para asaj që le të vendosë Kryesia çka të futet në rendin e ditës dhe ne do të kontribuojmë në të gjitha pikat. Ju faleminderit!

### **KRYESUESI, NAIM MALOKU**

JU përkujtoj që çdo kërkesë duhet t'i nënshtrohet procedurës së regullt për shqyrtim në Kryesi. Me kaq përfundon seanca. Ju faleminderit!